

**ANDREA LLUKANI**

Këtë libër ia kushtoj mikut më të mirë të babait  
**Z. Vangjel Vllaho**

# **FOLKLORI KRISTIAN**

Redaktor: **Dr. Moikom Zeqo**

**Botimet “Trifon Xhagjika”**  
**Tiranë, 2013**

Vangjel Vllaho ka lindur më 5 gusht 1929 në fshatin Peshtan të Tepelenës. Z. Vllaho ka qenë diplomat në disa përfaqësi diplomatike, në Pragë, në Sofie, në Romë si dhe në Misionin Shqiptar pranë OKB-së. Vangjel Vllaho ka botuar pesë libra, si dhe artikuj të shumtë në gazetat Malëshova, Përmeti etj. Vangjel Vllaho fjeti përgjithmonë më Zotin më 25 dhjetor 2012. I përjetshëm qoftë kujtimi i tij.

## PARATHËNIE

Folklori tregon thesarin e traditave të një populli. Termi Folklor e ka origjinën nga anglishtja: **folk** do të thotë popull dhe **lore** ka kuptimin urtësi, dituri. Kjo fjalë u përdor për herë të parë prej arkeologut anglez Toms më 1846. Babai i folkloristikës shqiptare është Frang Bardhi, i cili ka mbledhur 113 fjalë të urta në shqip. Thimi Mitko ka botuar “Bleta Shqiptare” dhe Spiro Dine më 1908 ka botuar “Valët e detit”. Më 1911 në Sarajevë, u botua vëllimi me këngë folklorike i Vinçenc Prenushit me titull “Kangë Popullore Gegnishte”, ndërsa më 1937 u botuan 15 volumet me “Visaret e Kombit”, ku shquhen folkloristët Atë Donat Kurti dhe Atë Bernardin Palaj. Botim me interes në lëmin e folkloristikës është edhe libri “Këngë e britma nga qyteti i djegur” i Mitrush Kutelit, që u botua më 1943 etj. Prej arbëreshëve të Italisë shquen Gavril Dara Plaku me librin “Këngë pleqërishte”, Gavril Dara i Riu me “Kënga e sprapsme e Balës”, Dhimitër Kamarda me shtojcën “Sprovë gramatologjie krahasuese e gjuhës shqipe” dhe Jeronim de Rada me “Rapsodi e një poeme shqiptare”, botuar më 1899 dhe që konsiderohet si vepra e parë e mirëfilltë e mbledhjes së këngëve të folklorit shqiptar. Në kreun e parë të librit do të njiheni me këngë, të cilat kanë motive Biblike. Prej tyre më të përhapurat janë kolendrat dhe llazoret, të cilat këndohen nga grupe fëmijësh duke shkuar shtëpi më shtëpi. Në kreun e dytë krahasoj motivet e baladave shqiptare me pjesë të Biblës, ndërsa në kreun e tretë kam paraqitur disa këngë të vjetra popullore. Kreu i katërt përmban fjalë të urta me tematikë fetare dhe shkrehje nga gjuha dogançe. Kreu i pestë i përket onomastikës

së krishtere, ku do të njiheni me etimologjimë e emrave, toponiminë e krishterë etj. Në kreun e gjashtë do të njiheni me këngë dhe histori të ndryshme me motive të krishtera, të cilat i kam mbledhur kohët e fundit. Kreu i shtatë dhe i fundit përmban jetëshkrimet e mbledhësve të folklorit shqiptar.

Punën për grumbullimin e këtyre këngëve e kam filluar që herët. Në kohën që studioja në Universitetin Kombëtar “Kapodistria” të Athinës një miku im arvanitas më ka thënë një këngë pashke, të cilën e kishte dëgjuar nga gjyshja e tij. Prej Koço Fështit, i cili në vitet e diktaturës bënte pjesë në grupet e të krishterëve të fshehtë kam grumbulluar këngën e kolendrave të Peshtanit. Nga gjyshi im Koço Llukani (Mësues i Merituar) kam dëgjuar këngën e Çausshit, priftit të Hormovës. Prej mikut tim dr. Dion Tushit kam mbledhur këngën “Mbytja e Dhespotit”, ndërsa besimtari i devodshëm Kostandin Bozaxhiu më ka rrëfyer këngën e kolendarëve beratas. Kolegu i punës Jani Steri më solli këngën “Kostandini dhe Dhoqina”, ndërsa Hill Mëhilli më dha shumë fjalë të urta me temaikë të krishterë. Për onomastikën e krishterë jam konsultuar me prof. em. dr. Pavli Haxhillazin, ndërsa Nos Xhuvani më solli Shërbesën e Shenjtë të Shën Joan Vladimirit. Dituraku Moikom Zeqo më këshilloi të shfletoja librat e Thimi Mitkos, ndërsa bashkëfshatari Kristo Kume më siguroi koleksionin e revistës “Jeta Kristiane”, piktori Lekë Tasi më solli një llazore, të cilën e kishte dëgjuar ta këndonte vëllai i tij i ndjerë Napoleon Tasi, ndërsa koleksionisti Shpëtim Sala më siguroi disa libra të vjetër me këngë popullore legjendare. Për këtë libër kam punuar shumë duke pyetur njerëz të ndryshëm, të të gjitha moshave dhe profesioneve. Nuk pretendoj që kam grumbulluar gjithë folklorin kristian, por mar guximin të them se kam bërë diçka. Këtë kurajo ma jep puna selektuese dhe grumbulluese e këngëve të krishtera, të cilat i kanë kultivuar të parët tanë.

## KREU I PARË

### MOTIVET BIBLIKE NË TRADITËN E POPUJVE

**K**isha prej kohësh ka grumbulluar dhe bashkuar njerëzit. Të dielave besimtarët shkonin në kishë për t'u lutur me shprestarin dhe për të marrë pjesë në Liturgjinë Hyjnore, në përfundim të së cilës burrat diskutonin për problemet që preokuponin fshatin. Gjatë të kremteve shkonin për t'i uruar emrin atij që festonte. Këto vizita shpesh shoqëroheshin me qerasje dhe gosti gjatë së cilave psalleshin tropare si dhe këndoheshin këngë tradicionale. Në të kremtet e mëdha dhe sidomos për Pashkë në përfundim të Liturgjisë Hyjnore besimtarët këndonin dhe kërcenin në oborrin e kishës. Gjallëri të madhe kishte gjatë panairëve, sepse grumbulloheshin edhe besimtarë nga trevat e tjera duke shkëmbyer kulturën dhe traditat. Panairi zhvillohej një herë në vit, në ditën që kremtonte shenjtori, emrin e të cilit mbante kisha. Këto panairë priteshin me kënaqësi nga popullsia për arsye të ndryshme. Përveç adhurimit të shenjtorit në Liturgjinë Hyjnore, tek oborri i kishës zhvillohej aktiviteti tregtar dhe më pas vijonte gostia e madhe kolektive gjatë së cilës këndoheshin këngë kishtare dhe popullore. Këngën e fillonte gjithnjë protopsalti i kishës dhe të tjerët mbanin ison.<sup>1</sup>

<sup>1</sup>-Andromaqi Gjergji, Refleksione të krishterimit në kulturën popullore, Tempulli Nr. 4, Korçë 2001, faqe 13.

Ndërmjet muzikës bizantine dhe këngëve popullore ka shumë elementë të përbashkët. Shumica e këngëve popullore shumëzërëshe si dhe muzika bizantine nuk shoqërohen me instrumenta muzikorë, pra në thelb përbëjnë muzikë vokale. Këndimi i himneve bizantine është njëzërësh, i cili shoqërohet me ison, që është elementi bazë në këngët polifonike. Një nga shkaqet e tingëllimit fuqishëm të këngës labe është forca me të cilën këndon grupi që mban ison. Mund të themi se kënga polifonike ka marrë shumë elementë prej muzikës bizantine.<sup>2</sup>

### KOLENDRAT

Kolendrat festohen më 24 dhjetor dhe janë këngë popullore me motive biblike, të cilat këndohen nga grupe fëmijësh. Ata shkojnë shtëpi më shtëpi duke uruar shëndet dhe mbarësi. Kolendarët që shkonin në grup, gostiten nga të zotët e shtëpisë me kuleçë (kolendra), fiq të thatë, arra, portokalle etj.<sup>3</sup>

O kolendra melendra!  
mirëdita, moj kadënë,  
mirë sod, mirë mot,  
ashtu dalç për shumë mot!  
dil, kadënez' e shtëpisë  
hap derën e perëndisë,  
nxir kullakun' e zotërisë.  
dil, moj, dalç e bardhë,  
gjer mot me një djalë.  
dil, moj, dalç e kuqe,  
gjer' mot me një nuse!

<sup>2</sup>-Adrian Ahmedaja, Këngët popullore shqiptare dhe i kënduari bizantin, Ngjallja, tetor 2001, faqe 9.

<sup>3</sup>-Lirika Popullore, Nr. 1, Akademia e Shkencave, Tiranë 1988, faqe 65.

Kjo këngë këndohej në Jug të Shqipërisë në vitin 1878. Zakoni i kësaj feste tradicionale ishte përgatitja e kuleçëve, të cilët sipas krahinave të ndryshme kishin emërtime jo të njejta. Në zonën e Korçës, Kolonjës, Përmetit dhe Myzeqesë quheshin *kolendra*, në Pogradec dhe Berat quheshin *kullakë* dhe në Shkodër *kullana*. Kolendrat festoheshin edhe tek arbëreshët e Italisë. Emërtimi *kolendër* vjen nga fjala latine *calende*, prej së cilës ka ardhur fjala *kalendar*. Kolendrat festohen në gjithë popujt e Evropës. Bullgarët i quajnë *koleda*, rumunët *kolinde*, francezët *kalandë*, rusët *koliadka* etj. Në qytetin e Shkodrës fëmijët kur e shihnin se e zonja e shtëpisë nuk i qeraste, këngës së kolendrës i shtonin vargje të tjera plot humor, të cilat vinin në lojë kopracinë.

Mirëdita për kullana,  
me 'j tubë patrixhana,  
mirë mot e mirë sot,  
na nimo, i lumi zot.  
njitu kenka shej shejmirë:  
del e del zonja e shpisë,  
me kunor-o të zotnisë;  
del e del e dalsh e bardhë,  
sot me barr' e mot me djalë.

A po del, a po shkojmë?  
njitu kenka një pus me rika,  
t'zonjës shpisë i raft' pika,  
njtu kenka një pus me pata,  
t'zonjës shpisë i raft' lëngata.

Kjo këngë është kompozuar prej M. Daiut dhe është kënduar në Shkodër nga Çile Kodheli në vitin 1957. Në vargjet e strofës së dytë duket qartë ironia e fëmijëve atëhere kur nuk shihnin shenja që t'i qeraste e zonja e shtëpisë. Në Përmet një

ditë përpara Krishtlindjeve përgatiteshin kolendrat, të cilat qenë kuleçë me forma të ndryshme. Zakonisht bëheshin aq kolendra sa për nevojat e familjes dhe të fëmijëve të fqinjëve, të cilët mendohej se do të vinin për vizitë. Në vigjile të Krishtlindjeve digjeshin dëllënja dhe fshatarët të grumbulluar rreth vatrës këndonin:

Olek, bolek shëndet e bereqet,  
me para në qeset dhe nuse të djemavet.

Fëmijët këndonin kolendrat duke shkuar shtëpi më shtëpi ku i qerasnin me kuleçë, petulla të saçit, me arra etj:<sup>4</sup>

Mirmëngjes zotërinj,  
ju them sonte një gëzim,  
rreth kujdesit të Shën Mërisë  
për Zotin Krisht.  
Ri, ri Shëndelli,  
bekoje këtë shtëpi  
me kryq dhe me luari.

Sipas kumtimit gojor të besimtarit të devotshëm Koço Fështi, në fshatin Peshtan fëmijët në vigjile të Krishtlindjeve shkonin e këndonin shtëpi më shtëpi për të dhënë lajmin e lindjes së Krishtit.

O Ili Shën Ili  
lyeji Zot këto shtëpi!  
që të lutemi me qiri,  
dhe të themi përsëri,  
Zoti lindi si njeri,  
duke qenë Perëndi.  
dhe e presim përsëri

<sup>4</sup>-Stilian Adhami, Vështrim mbi kulturën popullore të trevës së Përmetit, Tiranë 2001, faqe 149.

për shpëtim në Gjithësi.  
lajm të mirë ju lajmërojmë,  
Perëndinë e bekojmë,  
se fuqinë e gjithësisë,  
me Krishtin e Perëndisë.

Një festë e gëzueshme dhe e mrekullueshme për besimtarët korçarë janë kolendrat, të cilat kremtohen më 23 dhjetor. Fëmijët rendin shtëpi më shtëpi duke shpallur lajmin e lindjes së Shpëtimtarit Krisht.

Kolendra, kolendra sot,  
gëzuar për shumë mot  
neve vijmë t'ju gëzojmë  
si edhe t'ju lajmërojmë  
zotërinj dhe zonja.  
Në qytet të shenjtëruar  
u lind foshnja e bekuar  
zotërinj dhe zonja.  
ai është Krishti vet,  
i dërguar në këtë jetë.

Në qytetin me tradita të Korçës fëmijët trokisnin në çdo derë dhe në çdo zemër me qëllim që të hapen grazhdi dhe të lindte foshnja e Betlehemit.<sup>5</sup> Arbëreshët e Kalabrisë në ditën e Krishtlindjeve këndonin këngën “Kënga e Natalleve”. Kënga është gjetur tek dorëshkrimet e Santorit:

Dita e ninulëz lapëshon,  
shëjti e i biri Përëndis,  
anamesa njerëzisë

<sup>5</sup>-Vangjel Qazimllari, Një traditë që vazhdon edhe sot, Ngjallja, janar 2004, faqe 5.

si një ganjun i dashur arvon.  
O mos qaj, qëllo, qëllo!  
Fier, ti bir, e mos u zgjo!  
gjella ime, kur do sisë,  
Mirrë ndë zëmër e kërdhire,  
shëjtullore, qelle me tij.  
Ti digj, ti gris, ndërro  
sa kam ndë zëmër të lig u,  
ea e m'e shëro.  
Tundëni ninulën se u  
kopullëzën e një mburlet  
kam të ja qepi u këtu,  
të ja stolisi lulevet.  
Ngrehu, bir, se gjindë arrun  
me rrije e kan për mall  
sat të shohin tij të gjall,  
shëjti e i bukuri ganjun.  
Bora, breshëri, e bumbullima,  
mos m'e ngrini kët Kërthi;  
ju qatrolli, era e brima  
mos m'e stohëni kët Fëmij.  
O mos fjër sqëllo, sqëllo,  
gjith këta gjind mirr e beko,  
gjella ime ndë këtë jetë,  
shprish hare, mall e shëndet.

Këtë këngë ia ka kënduar të birit Zef Kanreva, psalti i kishës së Shën Japkut. Karmel Kanreva tregon se kënga shoqërohej nga kori i katundit.<sup>6</sup> Aleks Pjetri në Krishtlindjet e vitit 1928 kompozoi këngën “Mirmëngjes zonja, zotërinj”, e

<sup>6</sup>-C.Candrea-C. Stamile, Sperimentazione didattica in un ambiente bilingue arbëresh, Università degli studi Calabria, Calabria 1980, pagina 172.

cila këndohet sipas melodisë bizantine (Gjineqes akotisthite).  
Kjo këngë pati jehonë të madhe dhe u përhap me shpejtësi në qerthullin ortodoks.

Mirë mëngjes, zonja, zotërinj,  
lutemi na pranoni;  
në këtë çast me qetësi  
një lajm gazmor dëgjoni:

Mbi Vithleemin hebraik  
yjet shkëlqejnë për çudi,  
sepse u bë zbulim mistik  
dhe gjithësia u përtëri.

Se sot Fjala e Perëndisë  
gjith botën për me shpëtu,  
lind Njeri prej Virgjen-Marisë  
me emrin Zoti Jisu.

Lavdi më Ty që na dhuron,  
drit' dhe paqe çdo mirësi,  
ëngjëjt, barinjt' k'to fjal' këndojnë  
në qiell, në tokë e gjithësi.

Prej Persie tre mbretër shok  
nga një dhuratë po i sillnin,  
por një yll i bukur dritplotë,  
prin udhën që s'e dijsin.

K'ta pyetën në Jeruzalem,  
ku lindi Shpëtimtari,  
por yll i bukur paraprin,  
me driot'si rreze ari.

Irodhi që ishte mbret n'at vend,  
për Jisu Krishtin sa mor'vesh,  
u tund dhe u bë kuvend,  
pastaj u thërret me buz tuj qesh.

U thot' magve me mirësi,  
Jisuin e kërkonin,  
dhe si t'a gjeni faljunu,  
por vendin ma treoni.

Iu falën me pëkulësi,  
se ishin tepër dijetar,  
një ëngjëll u dha porosi,  
kur t'ikin tjetër udh' me marr.

Ushtrin Irodhi urdhëroj,  
preu katërmëdhjetëmij' fëmijë,  
por Zoti Krishti vet shpëtoj,  
dhe ç'kishte thën' e plotësoj.

Për shumë vjet, zonja, zotërinj  
kët dit të shenjtë kremtoni,  
me plot shëndet e lumturi,  
Zoti ju dhëntë ç'të doni.

Kjo këngë është kënduar për herë të parë në Krishtlindjet e vitit 1928 në qytetin e Durrësit. Sipas kumtimit gojor të besimtarit Kostandin Bozaxhiu, në Berat përgatitjet për Krishtlindjet fillonin që një javë më parë. Fëmijët sajnin një yll prej dërrase, e mbështillnin me letër të kuqe dhe në mes të tij vendosnin një qiri. Në mbrëmjen e Krishtlindjeve shkonin shtëpi më shtëpi me qiriun e ndezur duke kënduar:

Zonja dhe zotërinj  
erdhëm t'ju tregojmë  
se në Betlehem  
lindi një Mbret sot  
ai është Krishti  
biri i Perëndisë  
që ka për të prurë  
shpëtimin njerëzisë  
Magët që nga lindja  
me të parë yjet  
u trembën, u verdhën  
u bënë porsidyllë  
Irodhi i pabesë  
deshi t'i humbasë  
dha urdhër t'i vrasë  
Ne vijmë t'ju gëzojmë  
dhe t'ju lajmërojmë  
Zotërinj e zonja  
Në qytet të shenjtëruar  
lindi foshnja e bekuar  
Zotërinj e zonja.

Çdo fëmijë përgatiste çomangën, e cila në dy skajet kishte gozhdë. Sapo gdhinte mëngjesi i Krishtlindjeve, fëmijët trokisnin me anën e çomangës dyert e shtëpive. Kur hapej dera fillonin të këndonin:

Hëndra Kollëndra,  
hape derën të hyj brenda,  
se na lindi Zoti Krisht  
nga barku i Shën Mërisë.

Të zotët e shtëpisë i qerasnin me kullaka, arra, bajame, të cilat i futnin në çantat e vogla që fëmijët i mbanin në krahë. Në zonën minoritare të Liqenasit, banorët i këndojnë kolendrat në gjuhën maqedonase. Kolendrat maqedonase janë këngë të shkurtra lirike, të cilat këndohen nga grupe djemsh. Ata venë e trokasin në dyert e shtëpive duke iu uruar të moshuarve lumturi dhe jetëgjatësi:

O berejtese bre kolendari, koleda, koleda  
O koledari bre ko gojdari, koleda, koleda,  
O da si ojme bre so koleda, koleda, koleda.

O mblidhni bre kolendarë, kolendra, kolendra,  
O kolendarë bre si lopçarë, kolendra, kolendra,  
O të shkojmë bre me kolendra, kolendra, kolendra.

Të zotët e shtëpive u jepnin djemve koleçë dhe fruta. Gjithashtu këndonin:

Berisa oro golemo  
nautro da se soberish  
naveçer da se razdelish  
aj so zdravje Bozhik den,  
da si go pushtish Vodici.

Mblidhu valle e madhe  
mëngjesit të mblidhesh  
në mbrëmje të shpërndahesh  
me shëndet Krishtlindje  
na dërigo Ujin e bekuar.

Mbledhësi i këtyre këngëve të zonës së Prespës është Pando Thanasi, i cili ka grumbulluar rreth 67 lirika popullore.<sup>7</sup>

<sup>7</sup>-Foto Nikolla, Tradita dhe këngë patriotike të pakicës maqedonase në Shqipëri, Tempulli Nr. 1, Korçë 2000, faqe 103-104.

## PERËNDIA NË KRIJIMTARINË LETRARE

Lasgush Poradeci në vjershën e tij “Dita e Njëzetetës” shfaq nderimin dhe përkushtimin e tij ndaj Perëndisë. Kjo duket në vargun “Do t’i falem papushuar”. Dita e 28 nëntorit 1912 është një ditë e shenjtëruar nga vetë Zoti.

Ardhi dit’ e shenjtëruar,  
dita e njëzetetës  
me flamur të kuq në duar.  
se kështu pat urdhëruar  
goj’ e artë-e Zotit-vetës:  
do t’i falem papushuar.

Poeti Naim Frashëri në vjershën “Perëndija” thekson se çdo gjë që njeriu shikon dhe dëgjon është vepër e krijuesit Perëndi. Madje edhe vetë njeriu është i krijuar nga Perëndia dhe e ka Perëndinë brenda vetes së tij.<sup>8</sup>

Ç’sheh, është Zot’ i vërtetë,  
ç’ dëgjon, është zër i tija,  
gjithë ç’ka e s’ka në jetë,  
është vetë Perëndia.

Kërkonja gjetkë ta gjeje  
Zotn’ e math e të vërtetë,  
ajy qënkej ndaj meje,  
e paskështa unë vetë!

---

<sup>8</sup>-Anton Nikë Berisha, Hyu dhe mbretëria hyjnore në poezinë shqipe, Simpoziumi ndërkombëtar “Krishtërimi ndër Shqiptarë”, 16-19 nëntor 1999, faqe 422-423.

Andon Zako Çajupi ka shkruar një vjershë ku flitet për krijimin dhe në vijim, vjershëtori i ankohet Perëndisë, që ta shpëtojë popullin e tij nga zgjedha turke.

Zot’i Math e i vërtetë,  
ç’do pun e ke bërë vetë:  
bëre qiejtë dhe dhenë,  
bëre yjetë dhe denë,  
bëre diellin me dritë,  
bëre nat’e bëre dritë,  
bëre erënë dhe retë,  
bëre pemëtë me fletë,  
bëre hënëzën me yje,  
bëre fusha, male, pyje,  
bëre zogjtë që këndojnë,  
dhe lulet që lulëzojnë.

Gjerasim Qiriazhi ka shkruar një vjershë didaktike në formë dialogu ndërmjet nënës dhe fëmijëve të saj. Nëna i ankohet Zotit Perëndi, se bijtë dhe bijat nuk kujdesen më për të. Këtu në mënyrë metaforike nënkuptohet Nëna Shqipëri dhe shqiptarët e mbetur në errësirë nga sundimi i të huajve.

O Zoti im, o Perëndi,  
shtjer sytë e tu, shikomë ti!  
përse më lë të shkretë sot?  
e mjera vdes edhe s’rroj dot.  
se bijtë e mij dhe bijat,  
s’më duan as më kanë mall.  
gjithkush kërkon të tijat,  
më lanë të vdes në këtë hall.



Kjo sjellje e bijve ndaj nënës së tyre konsiderohet mëkat në sytë e Perëndisë, prandaj ata duhet të pendohen.<sup>9</sup> Në vjershën “Perëndia”, Asdreni flet për krijimin e botës.

O Zot i math i vërtetë  
dhe bërës i gjithësisë,  
që jep dritë që jep jetë  
natyrës dhe njerëzisë.

Ti ke tërë fuqinë  
se ti botën e urdhëron,  
sa lëvizin dhe sa rinë  
ti i këmben dhe ti i ndron!

Ti bën delet të valijnë  
errat të fryjnë me nxitim,  
edhe rehtë të gjëmojnë  
botën ta tundin pa pushim.

Ti bëre diell edhe hënë  
yjtë dhe hapësirë  
që të gjitha i ke vënë  
me mjështëri dhe me hirë.

Ja njeriu sa i çquar!  
gjithë ç’ke bërë si i sheh,  
tynë duke të lëvduar  
për Zot të vërtetë të njeh.

---

<sup>9</sup>-Mirosh Markaj, Si mund ta gjejë bota jonë rrugën e Zotit, Tempulli Nr. 2, Korçë 2000, faqe 70.

Arvanitasit e Greqisë këndojnë këngën “D’emër Zotit d’emër Birit”:

D’emër Zotit, d’emër Birit,  
edhe pelister të mirit!  
i lidhur, i pazgjidhur,  
i lidhur, i pamundur.  
ik nga këtu, do të mund,  
shko dhe male, njor në fund!  
atje gjelit thirma s’ndihet,  
e donjë me njatrën s’njihet.  
atje ç’ishtë nat’ e vapë  
e kush vete, s’pritet prapë.

Kjo këngë është kënduar në Elefsinë në vitin 1980, ku arvanitasit në emër të Zotit dhe të Birit largonin magjinë. Pjetër Bogdani në librin “Çeta e profetëve”, ka shkruar vjershën “Krijimi i rruzullimit”.

Parëse Qiellja, Dheu, Deti ne Zjarmi  
Ishte: kje Zjarmi, Dheu, Qiellja e Deti.  
Ma shëmpton Qiellja Dhenë e Detinë Zjarmi;  
Se ku ish Qiellja, Dheu, Zjarmi e Deti.  
Aty ish Dheu, Qiellja, Deti e Zjarmi;  
Dheu Qiellnë mbëlon, e Zjarminë Deti;  
Qiellja, Deti ende Zjaemi ishte ndë dhet,  
Dheu, Zjaemi ene Qiellja ishte ndë Det.

Mbë qiellit nuk ishte as yll, as dielli,  
Qi me dritë të vet xbardhënë dritë të re,  
As hana delte me dy të rgjanta bri,  
As prej qiellshit vinte ndonji rreze përdhe,  
As dheu si shqype nalt qëndron e rrij,  
As niegullë me shi, as breshën’as rrëfe.  
As deti me valë epte të madhe gjamë,  
As lymenatë me breg ishinë zanë.

Pjetër Budi në vjershën “Laudans inuocabo Dominum” që përkthehet “Duke lëvduar do ta thërres Tënëzonë” tregon shprestarinë e tij ndaj krijuesit.

I madhi Zot qofsh lëvduom; për gjithë kaqë të mirë,  
Qi s’e kam u merituum; me ndonjë shërbëtyrë  
Këtë kafshë me mbaruom; që paçë si detyrë.  
Natë e ditë tue shkruom; zemëra më gjet të lirë,  
Shokëve me ua dërguom; sikur një pasëqyrë,  
Ndë të cit tu’ shukuom; të nkthenjënë ma mirë,  
Fenë me lulëzoum; kishënë me shërbëtyrë,  
Popullinë me ndimuom; për gjithë ditë të mirë,  
Qi të jenë shëlbuom; n teje me gjet të lirë  
O zoti im i ngushëlluom; mbë qjellt aq i mirë.

Këtë vjershë Pjetër Budi e ka shkruar në vitet 1618-1621. Kjo është një vjershë antologjike e letërsisë së moçme shqipe. Poeti arbëresh Matrënga ka shkruar një poezi shumë të bukur, e cila titullohet “Kënga e përshpirtshme” dhe konsiderohet si vjersha e parë e shkruar në gjuhën shqipe.

Gjithëve u thërres, kush do ndëlesë  
Të mirë e të krështe, bura e gra  
Mbë fjalët të tinëzot të shihni meshë  
Se s’ishtë njeri nesh që mkatë s’ka  
E lum kush e kujton se ka të vdesë  
E mentë bashkë mbë tënëzonë i ka  
Se Krishti ndë parrajsit i bën pjesë  
E bën për bir të ti e për vëlla.

Kjo këngë përmbledh gjithë doktrinën e autorit duke na dhënë një trajtë të përsosur letrare dhe poetike. “Kënga e përshpirtshme” e Lekë Matrëngës gjendet në librin “E mbsuame e krështerë” të shkruar në vitin 1592.

## JISU KRISHTI NË LETËRSINË SHQIPTARE

Zoti dhe Shpëtimtari ynë Jisu Krishti ka zënë një vend të rëndësishëm në letërsinë shqiptare. Shumë shkrimtarë janë frymëzuar nga ngjarjet Biblike dhe kanë krijuar poezi të fuqishme në letërsinë shqiptare. Poetin Naim Frashëri nuk e ka penguar aspak besimi i tij fetar bektashian për të shkruar vjershën “Përpara Krishtit”. Naimi përulet me vënerim përpara ikonës së Krishtit. Në këtë vjershë ai tregon mendjen e ndritur dhe shpirtin e madh prej mendimtari:<sup>10</sup>

Djalëth njeriu i Perëndisë  
Fytyra jote mua më tregon,  
Ah! Të këqiat e njerëzisë,  
Ë ka punuar edhe po punon.  
Se kjo fytyrë është pasqyrë,  
Dhe na rrëfen, e s’na gënjen;  
Gjithë ç’ka hequr njeriu i mjerë,  
Nga veht e tinë; a nga i vëllaj,  
Që kanë vrarë edhe kanë prerë  
Pa gjyq pa fjalë, pa pasurë faj:  
Zot ti ke vuar edhe s’ke pshuar,  
Nga njeriu hoqe, për të u përpoqe.  
Ti u përpoqe për njerëzinë,  
Dhe dashurinë e bëre besë,  
Neriut i vure nom miqësinë,  
Që kur të lindet e të vdesë.  
Për këtë fjalë të qofsha falë,  
Se njerëzija e Perëndia.

<sup>10</sup>-Vangjush Ziko, Naimi përpara ikonës së Krishtit, Tempulli Nr. 2, Korçë 2000, faqe 5-7.

Këtë vjershë Naim Frashëri e botoi në vitin 1890 në vëllimin “Luletë e Verës”. Thimi Mitko në librin “Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar” Vol II, faqe 53 ka botuar këngën “Velikoja zbriste malit”.

Velikoja zbriste malit,  
Tuke dredhurë fill arit.  
Po dredh ar, e po punon,  
Kësukë Krishtit i ndërton.  
Velikoja xbriste malit,  
Tuke dredhurë fill arit,  
Po dredh, po qëndis me dorë,  
I bën Krishtit një kurorë.  
Velikoja ndëpër mal,  
Tuke dredhur’ mëndafsh all,  
Ndëpër mal e ndëpër çukë,  
Zotit Krisht i bën këpucë.

Çajupi në vjershën “I krishteri dhe çifuti” flet për lindjen e Krishtit.

Krishti është Perëndia.  
E polli zonja Maria.  
Me frumë e shëntëruar.  
Me Josifnë qe martuar.  
Është djal’ i Perëndisë.  
I biri i zonjës Marisë.  
Punëratë që punoi,  
Ujëtë q’ e bëri verë,  
Të sëmurët që shëroi,  
Lazar’ e shumë të tjerë,  
Që ka ngjallur përsëri,  
S’e rrëfenjë Perëndi?

Me gjithë këto çudi  
Që bëri Krishti në jëtë,  
Si e patë dhe ju vetë,  
O millet i mallëkuar  
Nukë qe për të besuar?<sup>11</sup>

Imzot Theofan Noli ka krijuar vjershën “Marshi i Kryqësimit”.<sup>12</sup>

Do t’ të vrasim, Jesu, se të kemi Baba,  
do t’ të varrim, Mesi, se të kemi Usta,  
se s’ ke dashur as jet’ as martes’ as para:  
kryqësoje, Pilat, në kalvar, Golgotha!

Dy kusarë të vegjël i zunë në lak  
kryqësoji këta, se na vothnë fort pak,  
kryqësoje këtë, se s’ na vodhi aspak:  
kryqësoje, Pilat, në kalvar, Golgotha!

Vrajeni, se përunj dhe përmbys pasurinë,  
pasuron, dhe forcon varfërinë,  
se lëngatën shëron, se ndriçon verbërinë:  
kryqësoje, Pilat, në kalvar, Golgotha!

Varreni, se me botën, me ne s’ shëmbëllen,  
se na ndreq shtrëmbëritë, dhe kurrë s’ na rren.  
se e do vegjelin’ e tiran’ e urren:  
kryqësoje, Pilat, në kalvar, Golgotha!

<sup>11</sup>-Andon Zako Çajupi, Baba Tomorri, Dituria, Tiranë 1997, faqe 23.

<sup>12</sup>-Anton Papeka, Poetë shqiptarë, Mësonjtorja, Tiranë 1999, faqe 317-318.

Vrajani, se për vete s' kujdeset, s' lëfton,  
dhe të mjerët, të humburit nuk i sfruton,  
dhe për sherr, për vllavrasje, për luftë s' punon:  
kryqësoje, Pilat, në kalvar, Golgotha!

Varreni, posa s' do as të vras' as të vrasë,  
as të bënjë të keqen as gjakun ta marrë,  
dhe katilët me nam na i qanë si të marrë:  
kryqësoje, Pilat, në kalvar, Golgotha!

Vrajani kryengritësin e shenjtëruar  
si katil të mallkuar, atë ka kërkuar,  
se kujtoi që pa armë na ka për të zgjuar:  
kryqësoje, Pilat, në kalvar, Golgotha!

Pjetër Bogdani në një kapitull të veprës së tij “Çeta e profetëve” paraqet këngën e dhjetë sibilave.<sup>13</sup> Kjo vjershë ka motive biblike. Autori në këtë rast është frymëzuar nga paravolia e dhjetë virgjëreshave, të cilat prisnin dhëndërin. Vjersha titullohet “Saibila libica”.

Si njeri po vjen ndër nierëz' dvidekëtar,  
Me dvekunë e me mort (t)ë vet me shelbuem  
Shekullin; e mëngji lëngimevet pa bar,  
Dritë syvet e veshëvet të ndëguem,  
T'shkejpunet t' ecunë dërejti pa pag as ar;  
Idhujt e mortnë nesh jashtë me dvue.  
Nji bir të vetëmë qi Ama pat për mall:  
Së vdekuni ia kthei e n' dorë ia (dha) a fjall:  
Me Dielli veshun' e mbathunë me Hanë,  
Më yj kryetë rreth ngjeshunë kunorë

<sup>13</sup>-Nga mitologjia dimë se Sibilat qenë vajza virgjëresha, të cilat parashikonin të ardhmen.

Vajza Mri, e bukura ma fort se Zanë,  
Djalinë Jezu kërthi mbai n' grykë e n' dorë,  
Për cmir ani jevrejtë me të pëganë,  
T' u kujtuem keq me kuvend për gjith herë,  
Zunë fill Djalinë Jezu fort me përzanë,  
As vend ndër dhjet e pushim me mos i lanë.

Shërbesa e Dhëndërit celebrhet gjatë tre ditëve të para të Javës së Madhe. Të Martën e Madhe kremtojmë paravolinë e dhjetë virgjëreshave, të cilat prisnin Zotin. Tropari kryesor i kësaj shërbese është: “Ja ku vjen dhëndëri në mes të natës dhe lum shërbëtori që do ta gjejë zgjuar”.

## SHËN MËRIA

Figura e Shën Mërisë ka një përdorim shumë të gjerë në traditën popullore. Në krijimet e popullit, këngët dhe legjendat që i referohen figurës së Shën Mërisë shprehet devocioni dhe shprestaria e besimtarëve. Kemi shumë lutje prekëse drejtuar Shën Mërisë, gjithashtu besimtarët betoheshin për Shën Mërinë etj. Më 15 gusht në ditën e lindjes së Shën Mërisë besimtarët këndonin:<sup>14</sup>

Rri, moj zonj Shën Mëri,  
ndë atë fron me flori,  
mba orë, mba korë,  
mba zotnë Krisht në dorë.

<sup>14</sup>-Jorgo Panajoti, Figura e Shën Mërisë në folklorin e Shqipërisë së Jugut, Ngjallja, qershor 2001, faqe 9.

Gjergj Fishta ka krijuar vjershën “Të grishunit”.

Ajo po nder halle t’ona  
Tash na njet doren ndimtare,  
Pse, si heret si ne e vona,  
Asht diftue njimend Shqyptare,  
Vetë perherë ka’i ba hije  
Ksajë së hijshmes tokë Shqypnije.  
Pra ksajë Virgjen fatmire,  
Qi a’ e kulluet si rrezja e diellit,  
Të tanë gaz e të tanë hire,  
Nanë e Hy’it e nanë e kshillit,  
Ti kushtohet p’rherë Shqypnija  
Si ndër t’mira ashtu nder t’kqija.

Poeti arbëresh Jul Variboba në vitin 1762 ka krijuar vjershën “Gjella e Shën Mërisë virgjër”.

Oj jet’ e ëmbël, o Shën Mëri,  
vjershin e ri ea na mbiso;  
si do shurbier, si ti t’pëlkier,  
ti bashk’ me ne nga e këndo.

Na ning ti të vandonjim,  
ti të nderonjim si meriton;  
se je fanmirë se na do mirë,  
këta si thomi, këjo baston.

Cili njeri sa i lart’je,  
sa gracje ke, mund nimëronjë?  
vet’ Zoti inë ti di vandinë,  
jatër gjuhë s’di ti këndonjë.

Nd’atë direkt çu fjet karta,  
vetëm sa lart ti qeve vënë;  
neve të tjerët të bjerrt’, të mjerët,  
gjarpri mëkatat na pat ngrënë.

E bër’ aposta për Tënëzonë,  
shkele Dimonë, i re pir mort;  
ti vetëm qeve porsa u leve,  
ndi trut’ ia ngjoke, ia ngjoke fort.

Jot ëm’ Shin Ana me Shin Xhakinë,  
fimilë s’kinë e, pjot me lot,  
e shertëruan, e argjëruan,  
ashtu ti bjetin ka Inzot.

Me vute e meshë e raciuna,  
me divuciuna e me hjidhi,  
të kunçipirti, të parturi,  
Shin Ana e mirë ndi pjakëri.

Kur ti u leve, e qiell e dhe,  
bëri hare ndir gjith’ kundat;  
haret’ i solle kur ti dolle,  
dolle si dielli e pamëkat.

Tri vjet u mbille ndi një kuvend  
bëre kutiend ti Tënëzon’;  
i dhe një lule, një trëndafille,  
i dhe të virgjit çu lulëzon.

Andaj Zotinë tij t'u prejar,  
t'u namuruar e mir' të dish:  
e të bekoi, të shënjtëroi,  
e shpirti kurim t'e bëri kish'.

Nj'ëmgjell aposta të suall mbashatën,  
të suall uratën ndi kit modh';  
-O e lumja grua, Ti si e thua?  
Ti Zoti im'për em' të zgjodh.

Ti rispëndove:-U'jam e virgjër,  
Si nji e virgjër mund jetë emë?  
Këjo mbashatë ning është'uratë;  
pir nji të virgjër është' më se nëmë.

Ëngjëlli foli:-Jo, se Zotin'  
tek vete hin, ning e danon,  
virgjitatet e puritatet;  
tek më e nget, më e ngjaron.

Si pasiki tek dielli hin,  
ai ning e nxin, e dritësin.  
mos kij pahur, mos kij timur:  
vet'Shpirti shëjt' vjen e të mbjon.

Për Shën Mërinë virgjëreshë Zef Skiro ka krijuar këngën  
“Këndojem, këndojem”, e cila e paraqet Hyjlindësen si  
perëndeshë të jetës.

O virgjërë e fjeshtë, më e bardhë se dëbora,  
o vashë e dëlir, si një pëllumbeshë,  
rreth ballit të bukur të shkrepën kurora,  
se e jetës e e qiellit ti je perëndeshë.

Thimi Mitko në librin “Mbledhës të hershëm të folklorit  
shqiptar” Vol II, faqe 54 ka botuar këngën “Atie lart nd'ato  
syri”.

Atie lart nd'ato syri,  
Zënëke zonj' e shën Mëri.  
Shkoi zoti Krisht i gjallë,  
Tyke kuvënduarë,  
Tyke mpsalltëruarë:  
-Ç'bën, shën Mëri këtu?  
-Po bënj dhe, po bënj kodhe.  
O thumba-thumbuari!  
O gozhdë-gozhduari!  
Kush të të kujtojë ndë natë,  
Gjë të keqe ay mos patë,  
As për farë, as për fis.  
As për motër' e për vëlla,  
As për nën' e për baba,  
Se jam shpatë perëndie,  
I vinj rreth asaj shtëpie,  
Jam mbi krye asaj fëmije.

Kjo këngë është kënduar më 1878. Pjetër Budi në librin  
“Doktrina e Kërshtenë” ka shkruar vjershën “In honorem beatae  
mariae Virginis”, e cila përkthehet “Për nder të së bekuarës  
Virgjëreshës Mari”.

O n qiellshit ndima jonë,  
Zotnja e shënë Mëri,  
nktheu mbë nevojë tonë  
ke dergjemi ndë të zi.

E lutunë për mkatet tonë  
mos biemë ndë mëni,  
të gjindemi ndë e vonë  
duam faqeje cë ti.

Qi sdripi për mpmatet tonë'  
n qiellshit atje ke rri,  
me ndritm zemëratë tonë  
t'erratë me madhështi.

E në me na lëshuom,  
senxhirit ke qemë ram,  
burgu c'errë e n' cë helmuom  
shintënë dritë me pam.

Ndaj shintënit (t)ë ti  
ndaj engjit (t)ë levduom,  
të mëmëdha Regjëni  
për jetët me zotënuom.

Thimi Mitko tek këngët e mbledhura nga arbëreshët  
flet për "Ra kamban' e Shënmërisë".<sup>15</sup>

Ra kamban' e Shënmërisë,  
ngreu, vajëz-o, të veç në kishë,  
ra kambana dy, tri herë,  
ngreu, vajëz-o, të rrish ndë derë.  
Prifti me priftëreshënë,  
van' të vielën vreshtënë.  
Erdhën torrë-torrë dhrisë,  
u kukullojnë të dyzë.

Arbëreshët e Kalabrisë këndojnë këngën "Shën Mëria  
u vesh me ar". Autori i kësaj kënge ka mbetur anonim.

Shën Mëria u vesh me ar  
Vate ndë kopësht të mblidhë di lule  
Ju përgjegj Zoti Krisht:  
-Ato lule mos m'i ngjit!  
Shkuan tre të mallëdhirm  
Me qakëz ndë dorë  
Shkuan tre me dhjetë kumborë  
Ç'bien ndë pashkë e ndë natalle.  
Kush i gjegjën e nëng i mëson  
Dhjetë vambë zjarr shkon.

Në San Giacomo të Italisë këndohet kënga "La piu bella  
creatura":

Më e bukura kopile  
Çë shkërqen si trondofile,  
Je ti Zonja Shën Mëri,  
Si je ti neng është njeri,  
Ë paraisi faqja jote  
Kush e ruan bëhet dhivote,  
Gjith belicët e t'in Zoti,  
Ndato faqe i mbiodhe sod.  
Jan di yjzë e lipisi;  
Çë do ruan namurarn  
Çë do sheh e rikriarn.  
Pjot me ar janë ato duar  
Tën Zot kan për tërzuar,  
Lipisiar sa jo më  
Ndë Parais nëng le gjë  
Rregjëron ti qiell e dhe  
Gjith ndë kemb suxhiet i ke,

<sup>15</sup>-Mbledhës të hershëm të folklorit, II, Tiranë 1961, faqe 247.

Puru ti më gjithë zëmër  
I do si bij, puru se jan të nëmu  
Kët shpirt nxirja armikut,  
Bëja këtë shkat të ligut;  
Gjithë vit e gjith mot  
Bëj të rri me t'in Zot.  
Kur i ndëndi këta sy  
Sa të shom, oj Shën Mëri?

Zef Serembre (1843-1901) ka krijuar vjershën “Shën Mërisë Virgjër”.

I grisa gjunjët edhe gjuhën thajta,  
për ljetërat që shtura sitë u thanë,  
më thertin shpirtin, zëmërën ma vranë,  
edhe kekj e më kekj nga dita vajta.

E besa së më ndihu çë të mbajta:  
mose dita të zeza ngraha më ranë;  
endrrat dhe shpresat posi ljetje vanë,  
gjindja më kjielli dhunë përse t'u kjiajtja.

Nani çë bënj, o mëmë, u te kjo gjellë?  
dita më heljmon, nata më vret,  
soti më vrenë e nesëri më nxinë.

Zëmëra te ti vjen me mall të thellë,  
po ti rri larhu e nëmuria më pret,  
e te një det heljmeçë njo më mbinë.

Gjergj Fishta në poezinë “Të lemt e Zonjës” flet për lindjen e Shën Mërisë.

Po thonë Anës e Joakimit  
se i hyll vajze u paske le,  
si ajo drita prej agimit,  
si ajo voesa e nadjes s're:  
syni i sajë, një rreze di'llit,  
shtati i sajë gjeth drandofillit:  
sji Pranverë n'blerim të vet!  
sur po qeshka syni e ftyra  
nëpër rreze të bindueshme  
thue po u ndeka atë herë pasqyra,  
m't cillen pirun mendja e amshueshme,  
t'natyrës s'vet sheh t'kthellat jije,  
edhe gjallë t'hyjnueshmen Dije  
m'nja si vedin e perfton.

Mitrush Kuteli në poezinë “Kartë nga Shëndaumi” ndër të tjera shkruan:

Kjo zonjë e rëndë Shërmëri,  
Kjo nënë e vuar Shërmëri,  
Veshur me 'rgjënd e me flori,  
Në dorë një qiri.

I bie më gju, bëj metani,  
Një herë, dy, dyzet e tri,  
“E madhe je, moj Shërmëri,  
Ti dorëlarë me flori.



Aleks Tarketa në shekullin e XV ka krijuar këngën “O Virgjëreshë e Shenjtë”.

O virgjëreshë e shenjtë, burim i gjallë mëshire  
Me devocionin të gjithëlutemi e të nderojmë  
Për mirësinë tënde e përdëllesën e pafund.  
Ndërhy për ne të lutem, për mëkatin e Adamit,  
Kur unë mëkatoj më shenjtëro te kryqi i shenjtë,  
Për atë që çdo njeri i vetëm është në botë  
Me mosbesim e shpresë thërret me zë të lartë.  
Këtë altar e ka bërë Aleksi i Tarketës  
Në Shqipëri i lindur, kapedan i oborrit të Baregas  
Më 13 të gushtit në vitin 1480.  
Sa më tepër që i mendoj shtohen të mirat  
Që më ke bërë mua, o Virgjëreshë e kulluar  
Në madhësinë, nderimet të gjithë të dashurve.  
Shumë m’u lartësua figura jote e bukur  
Në moshë të vogël u largova nga Shqipëria e erdha  
Te imzot i lartë, duka Francesca Sforca  
Tek ai unë i shkreti u rrita e u lartësova,  
Duke i nderuar me përfitim të madh  
Përmbi meritat e mia e të gjindjes sime  
Për këto urdhëra unë me kurajo, o Virgjëreshë  
Të lutem përsëri e kur të iki nga kjo jetë  
Për shpëtimin tim mos më moho asgjë,  
Prandaj stolisa altarin me figurën tëndë,  
Ku unë do lexohem si Aleksi debitor  
Megjithqë kjo është shumë pak për Ty!

Këtë këngë e ka përkthyer nga italishtja dituraku Moikom Zeqo dhe është botuar në librin “Poetë Shqiptarë” të Anton Paplekës.

## ADAMI DHE EVA

Pjetër Budi në vjershën “Adami dhe Eva” shpreh dhimbjen shpirtërore të protoplastëve, të cilët u mashtruan nga djalli dhe u dëbuan prej parajsës.

Kish të djeg’ me ligjëruom  
se jam gjithë ndë të zi  
ditë e natë t’u kujtuom  
të lumtë qi pat njeri.

Aij Adami i lëvduom,  
me Evënë dy të ri,  
mbasi qenë krijuom  
pak qenë ndë njerëzi.

Përse s’deshnë me ndëgjuom  
urdhëninë që qe dhanë  
e sinëzot urdhënuom  
njaj pene me mos ngratnë;

Se mb’atë horë qi ta zini  
n dore n coje me ngjënuom  
me ndekunë mortjet kini,  
kënci shekulli me shkuom.

Me ata tue qenë  
dy të Sinëzot ishnë dhanë  
si sinëzot ishnë dhanë  
pa mkat pa majshtri,

Nd' atë paq të ngushëlluom  
tri horë e gjymzë mbi,  
ndë vonë, si a shkruom,  
erdh djalli me majshtri.

Me ta tue ligjëruom,  
si një gjarpënë i zi,  
ndjer i bani me ngjënuom,  
ej shtiu ndë mëni.

Këtë vjershë Pjetër Budi e ka botuar në librin “Doktrina e Krishterë” në vitin 1618. Çajupi tek “Baba Tomorri” ka shkruar vjershën “Eva dhe shejtani”.

Gjith' e dinë ç' kemi qënë  
Dhe pastaj qysh kemi rënë:  
Që të prishet njerëzia,  
Të ndahet nga Perëndia,  
Shejtani dolli nga dheu  
Dhe Evën vate gënjeu.  
Edhe Eva më pastaj,  
Gënjeu burrën e saj...  
Dhe e kandisi, fatzinë,  
Të harrojë Perëndinë.

Pjetër Budi në poemën e IV thekson faktin kur Adami pasi mëkatoi me Evën, dëgjoji zërin e Zotit që i thotë “Adam ubi es”?

O Adami i helmuom,  
me Evënë dy të ri.  
m se ini me larguom  
pa deli t'u shof me sy!

I cili tue ndëgjuom  
ma qish me thanë s'dij,  
as kish kaha me shpëtuom,  
as faqe përpara ti.

Frike tue cokëlluom  
gjithë zemëra ju ngri,  
ke hini me responduom,  
fjala mbarë nuk i vij,

Tue thanë se u m zi,  
o zoti im i ngushëlluom,  
zanë ta gjegjem ty,  
e s'kuxonj me t'u kallëzuom,

Se dvdeshunë jam e s'di  
ku të mshihem me shpëtuom,  
turpnë e mbarenë veti,  
Zoti im, tue shukuom.

## SHËN LLAZARI

Këngët popullore kushtuar Shën Llazarit ose siç quhen në gjuhën e fëmijëve “llazoret” kanë qenë shumë të përhapura. Fëmijët i mësonin me kënaqësi këto këngë dhe prisnin me padurim ditën kur do të dilnin shtëpi më shtëpi duke kënduar dhe shijuar dhuratat që u ofronin njerëzit.

Llazëro, Llazëro,  
ku më ke lazëruar-o  
në udhë të mërguar-o  
“Pa thuana edhe ne,

të dimë se ç'ish atje?"  
Shën Llazëri u ngre,  
e tha: "Mos më piesni më!".

Ngjallja e Llazarit në Kishën Ortodokse kremtohet të shtunën përpara së Dielës së Dafinave. Fëmijët e fshatrave zakonisht këndonin këtë këngë popullore.<sup>16</sup>

Vete sot në Vithania  
Zoti Krisht dhe Perëndia  
Zonja e zotërinj dëgjoni  
Se ç'u bë atje, mësoni

Në qytetin Vithania  
Qante Martha dhe Maria  
Qanin e s'pushonin kurrë  
Tri ditë e tri net thërrisnin

Të vëllanë dhe ulërisnin  
Në të katërtën u nis vetë  
Zoti Krisht i vërtetë  
Edhe, doli Maria

Përjashta nga Vithania  
I ra Zotit ndër këmbë  
Dhe i tha me shumë dhembje  
"Po të jesh o Zot këtëunë

Nuk vdiste vëllai ynë  
Gjene jetën edhe vdekjen  
Ti i ke në dorë vetë  
Po të duash me një fjalë

<sup>16</sup>-Petro Papandile, Festimi popullor i Shën Llazarit, Ngjallja, prill 1993, faqe 6.

Sakaq herësh e ngre nga varri  
Thotë Zoti me një fjalë  
Ejani më tregoni varrë  
Të dy motrat për vëllanë

Shumë gjndje kishin pranë  
Jisui porosit së pari  
Të heqin gurin nga varri  
Por Martha, foli e tha:

"I vdekuri qelbet, bie erë  
Se ka katër dit i nderë  
Jisui i tha të kesh besim  
Sot do ngjallet miku im

Dhe ngriti sytë përpjetë  
Falenderon Atin e vetë  
Edhe duke bërtitur tha:  
"Llazar dil jashtë nga varri"

Zgjidhni këmbët e duart e tij  
Dhe lëshojeni të baresë  
T'i përsëritet fuqia  
Krishti kur ngjalli Llazarë  
Na dhuroj pashkën e parë

"O skëterrë erdhi prishja"  
Kjo e sotmja është nisja!

Në krahinë e Odries një javë përpara Pashkës djemtë e fshatit shkonin shtëpi më shtëpi duke kënduar!<sup>17</sup>

<sup>17</sup>-Pilo Thanasi, Ringjallje e traditës orthodhokse në krahinë e Odries, Ngjallja, maj 2001, faqe 10.

Shën Llazari kishte dy motra,  
Të helmuara rrinin tek porta,  
Prisnin Zotin Krisht t'u shëroj vëllanë,  
Po Ai vonoi e ato zunë e qanë,  
U erdhi haberi, Zoti Krisht erdhi,  
Pse rrini tek porta, pse s'vini tek varri,  
Mbi varr kish një shpellë, si kishin aden,  
“Ngrehu Llazar nga ajo jetë,  
Zoti me gjithë mathitenjtë”,  
Edhe Llazari u ngre, me savan sikundër qe.

Në Himarë këngëve popullore kushtuar Shën Llazarit  
u jepet karakter dramatik.

Mir'se u gjejmë o zotëri,  
Pa dëgjoni di a tri,  
Se ç'u bë në Vithani  
Erdhi Krishti me fuqi,  
Të haset me miknë e tij,  
Qe dhe Lazëri ati,  
Katër ditë i vdekuri,  
S,e besuan në Perëndi:  
“Ngrehu o mik, ç,bën ati!”  
Edhe Llazëri u ngre,  
Lidhurë sikundër qe.  
Populli që ish atje,  
Ranë mbë gjunjë e mbë dhe,  
“Lavdi” bëjnë të gjithë,  
Edhe Llazarin e pëjrisnë:  
Thuajna, ç'qe atje!”  
“Pashe kriqe, pashë dridhmë,  
Pashë shumë ulërimë,  
Nëmëni një pikë ujë,

Të lag gjuhën edhe unë,  
Edhe mos më pëjini,  
Se të gjithë atje do vini”.

Shën Llazari kremtohet edhe në Kalabri ku shërbesat  
kryhen sipas ritit Liturgjik Lindor. Në traditën popullore të  
arbëreshëve këndohet kënga “Kalimera e Shenjtit Llazar”.

Marta shkruajti e Mathallena  
Zotit ç'ish në Betani  
E ju lusin po se atena  
Të mund pretej ndë Judhi:  
Krishti nisi, moj tri ditë  
Vu t'arëj ku in ato  
Marta, cila më nge prit  
Vej mbë varr të qaj ajo.  
Se mjeshtri ju përpoq  
Ra për dheu, ndë këmbë ju poq.  
Van, e qajti, e thirri fort  
Krishti, e deqes kumandoi:  
“Perdhen e marr lireje mort!  
Llazar dil!” E një krazoj  
Llazari si një lethezë kashtë,  
Bardh i veshur, varrit jasht!

Këtë këngë të shkruajtur me shkurtime e kemi marë  
nga koleksioni i A. Santorit.<sup>18</sup>

---

<sup>18</sup>-C. Candreva, C. Stamile. Sperimentazione didattica in un ambiente  
bilingue arbëresh, Università degli studi Calabria, Calabria 1980, pagina  
192-194.

Tek arbëreshët e Sicilisë, folkloristi Zef Kripsi në librin “Memorie storiche” flet për një të ri, i cili i veshur me rroba të bardha kryeson grupin e llazoreve.

O mirë mbrëma!  
O mir, menatë!  
Erdha t’ju thoshia  
Një fjalë t’ mirë.  
Një punë t’ madhe  
Bë perëndia,  
Përpara gjithëve  
Te Betania...  
O Lazër, Lazër,  
Eja t’ rrëfyesh,  
Si u farmëkose  
Te dheu i zi!  
Lazëri u ngre,  
Nga varri krisi,  
U fal tyn zoti,  
E jerdh e nisi,  
O zot, o zot,  
Farmëk i madh  
isht’ ajo botë.

Kjo këngë është kënduar në Piana në vitin 1923. Gavril Dara Plaku (1765-1832) ka shkruar këngën “Krishti para varrit të Lazrit”.

Të mjera t’ motra  
U vuun ndë lip,  
Tue rrahur gjirin,  
Tue shkukur krip.

Praan e varrzuan  
Ndë varr të rii;  
Me një dërrasë  
Varri u mbëllii.

E prap u nisën,  
Me siit ndër lotë,  
Të gjejën Krishtin,  
E i thanë: -O Zot!

S’ mënt t’ e kish mbjedhur  
Më kishë klënë  
Vdekëja e shkretë  
Vëllauthin t’ ënë.

E Krishti u tha:  
-fshini ato’ lotë.  
E kini besë  
Se jam u Zot.

Të keni besë  
Na përgjith-monë:  
Jee i biri i Zotit,  
Si t’ shkruarat thonë.

Dritë nga drita  
Ti jee ndë jetë:  
Jee e larta Fjalë,  
Gjella e vërtetë.

E Krishti u tha:  
-Mos kini dree  
se nd'atë varr  
Lazri fle.

E me Apostojit  
Te varri u kjas;  
Bëri të ngrinjën  
Atë dërrasë.

Llazoret e Korçës qenë grupe grash, të cilat shkonin nëpër dyert e shtëpive të qytetit duke kënduar:

Se me Kriston zere desemno,  
Se me Kriston na puno,  
Fli trendafiliko, jare margarito,  
Pashkët ju gjeçin gëzuar,  
Djem dhe çupa martuar.

Të zotët e shtëpisë iu përgjigjeshin me këngë, e cila shoqërohej me iso. Shpesh këndonin këngë, të cilat llazoret i kishin krijuar vetë nga ndonjë ndodhi që u kishte lënë mbresa në komunitet.<sup>19</sup> Në revistën “Jeta Kristiane”, Kostandin Trako ka botuar artikullin “Folklori muzikor i Pashkës” ku na jep këngën “E shtuna e Shën Llazarit”, sipas tregimit të Niko Takos nga fshati Novoselë i Përmetit. Të njëjtën llazore piktori Lekë Tasi e kishte dëgjuar ta këndonte vëllai i tij i ndjerë Napoleon Tasi, i cili pas një jete të trazuar mes vuajtjesh dhe persekutimesh tani prehet i qetë pranë atit qiellor.

---

<sup>19</sup>-Dhimitër Taqi Fundo, Disa shënime dhe kujtime mbi muzikën në Korçë, Tempulli Nr. 1, Korçë 2000, faqe 52.

Kasaba e Vithania  
Qante Martha e Maria  
Qante e s'pushonin kurrë  
Tri ditë e tri net thërrisnin  
Të vëllanë ulërisnin  
Në të katërt u nis vetë  
Zoti Krisht i vërtetë  
Të vëllanë dhe ulërisnin  
Në të katërtën u nis vetë  
Zoti Krisht i vërtetë  
E i doli Martha e Maria  
Përjashta nga Vithania  
I ra Zotit ndër këmbë  
E i thotë me shumë dhembje  
“Po të jeshë o Zot këtunë,  
Nuk na vdiste vëllai ynë  
Ti i ke në dorë vetë  
Kur të duash me një fjalë  
Sakaq' erë e ngre të gjallë  
Se e kishe mik të dashur  
Kaqë kohë e kishe pasur  
Thotë Krishti me të qarë.  
Ajde më tregoni varrë.  
Si e shpunë atje në varri,  
Mjerë ti i thotë xhenemit  
O xhenem të ardhi prishja,  
Kjo e sotmja është nisja.  
Me të thënë këtë fjalë  
Llazari u ngrit i gjallë,  
Mathitinjtë e Apostonjtë,  
Që të tërë me një gojë,  
Shyqyr Perëndisë thërresin,  
Edhe Llazarin e pyesin,

Në xhenem që vajte thona,  
Se ç' mundim hoqe, tregona!  
Edhe Llazari ju thotë  
Me gojë nuk u tregoj dot.  
Kartat i kini mësuar  
Tjetër fjalë mos më thoni  
Përveç të më dëgjoni.  
Thamën e Zotit e thamë,  
Edhe borxhin e lamë.  
Llazi Shën Llazri  
Nga këtej tërthuarë  
Nga lëm'i farkuarë  
Peksime moj peksime  
Pa na jep dy koqe ve.

Thimi Mitko tek libri *Mbledhës të hershëm të Folklorit Shqiptar, Vol. II, Instituti i Folklorit, Tiranë 1962, faqe 50-51* na sjell disa variante të llazoreve.

Llazëri, shën Llazëri,  
Mos patë llazuarë?  
Nde kroj'i farkuarë,  
Të fërkonte shpatënë,  
Shpatënë të zotitë.  
As na ep tri koqe ve,  
Ashtu paç tri pendë qe.  
Sa qepra edhe drasa,  
Aqe nuse, aqe vasha,  
Sa lesh mbi treqind desh;  
Aqe bereqet të kesh.  
Sa lesh mbi treqind buaj,  
Aqe pare mbë një muaj.

Në këtë libër gjendet edhe një llazore tjetër:

O pëllumth, o pëllumtho,  
Mos më pe Llazuarë?  
Këtu drejt shkuanë,  
Ndë derë të zotitë.  
Ay zot seqysh punon!  
Kill' e ashpër numuron.  
Darovit Llazuarë.  
Ashtu dalç gëzuarë.  
Me djathë ndë napëzë,  
Me nuse për qafëzë,  
Sa lule ndë Tomor,  
Aqe nuse ndë hobor.  
Sa lule ndë qershi,  
Aqe diem' ndëpër shtëpi.

Gjithashtu po në këtë libër Mitko na sjell një këngë të vitit 1878, që këndohej nga arvanitasit e Greqisë.

Erdhi Lazëri mbë derë,  
Bjer' i pulësë të pjellë.  
Jepi Lazërit një ve.  
Se u err, e do të ve.  
Do të vejë ndë More.  
Janë turqit e krishte.  
Hanë gjalp, e mono ve,  
Ng' atje para vjen andara,  
Shën Mëria ty e klara,  
Tye klar' e tyre thirrë,  
Se i vranë monobirrë.  
Mbëlithni lule, lule malit,  
Të i a vëmë torrë varrit.

Në qytetin e Kavajës këndohej kjo llazore, e mbledhur nga V.P.

O Llazore, Llazore  
Mushka palla xufate  
Ke limani të Zoti te,  
Ej Zot jarabi.

Jepi o Zot kësaj shtëpij  
Me somun'e me qaji  
Më këlqere lahurid  
Toj moni, toj kroni  
Poleriska, peleshana.

Në Përmet grupe fëmijësh shkonin portë më portë duke kënduar llazoret:

Llazëri, Shën Llazëri,  
As na ep tri koqe ve,  
Ashtu paç tri pendë qe,  
Sa qepra edhe drrasa,  
Aqë nuse, aqë vasha,  
Sa lesh mbi treqind desh,  
Aq bereqet të kesh.

Në fshatin Brezhdan të Përmetit në vitin 1959 grupi i vajzave këndonte këngën:

Lazë shënlazëri,  
Foli dhi or dhisë,  
Të zonjës së shtëpisë,  
Të na dal në shkallë,  
Se i kemi një fjalë,  
Të na nxjerrë venë,  
Se s'i kemi ngenë.

Zonjat e shtëpisë i qerasnin me vezë. Kjo këngë është mbledhur nga një ekspeditë shqiptaro-rumune.<sup>20</sup> Në Peshtan "llazoret" kanë qenë shumë të përhapura. Fëmijët e fshatit i mësonin me kënaqësi këto këngë dhe prisnin me padurim ditën kur do të dilnin shtëpi më shtëpi duke kënduar. Të zotët e shtëpisë i gostisnin me arra, mollë, vezë, sheqerka etj.

Dhe në prag të Pashkës së Madhe,  
Në fillimet e beharit,  
Niste fshati këngë e valle,  
Bëhej festë e Shën Llazarit.

Bëheshin llazarët flutur,  
Nga një gaz u vlonte gjiri;  
Ç'ndihej një muzikë e bukur,  
Me këmborë e fyej briri!

Pastaj venim ndër shtëpira,  
Shpinim festën derë më derë,  
Na gostisnin me të mira,  
Mbushnim shportat plot me vezë.

Derdhte Zoti plot bekime,  
Aty në ballë të beharit,  
Oh, ç'na jepte ngazëllime,  
Ditë e mirë e Shën Llazarit!

Poeti Llukan Stavro, me anën e kësaj vjershe tregon si festohej e Shtuna e Llazarit në fshatin e tij të lindjes. Në fshatrat e Zagorisë llazoreve u jepej karakter humoristik. Fëmijët këndonin:

<sup>20</sup>-Stilian Adhami, Vështrim mbi kulturën popullore të trevës së Përmetit, Tiranë 2002, faqe 152-154.



O zonjë e shtëpisë  
Nëmna koqevenë  
Se s'ta kemi ngenë.

Pasi merrnin vezën, e zonja e shtëpisë i gostiste me karamela, arra, lajthi dhe ndonjë lek. Vezën e merrte çobani, i cili e vendoste në një shportë. Më tej kënga vijonte:

Ti kako plakë që na dhe venë  
Të dhentë Zoti shëndenë!

Qëllonte që për arrësye të ndryshme e zonja e shtëpisë ua mbyllte derën. Në këtë rast fëmijët i këndonin:

Ti kako që s'na dhe venë  
Të bëftë bufi folenë  
Mbiftë ferra mbi shtëpi  
Me një dhi, me një bri  
Me një gomar të çalë  
Me një plakë kurrisdalë.

Fëmijët e i këndonin llazoret për tu argëtuar dhe venin edhe në fshatrat përreth.<sup>21</sup> Kjo këngë këndohej në fshatin Karjan të Gjirokastrës.

Plakë, plakë, venë,  
Se s'ta kemi ngenë,  
Ngenë e llazorëve,  
Trima kanakarëve.  
Ti që na dhe venë,  
Zoti të dhentë shëndenë.  
Ti që s'na dhe venë,  
Kukua të bëft'folenë!

<sup>21</sup>-Evien Peri, Zagoria, zakone dhe tradita, Tiranë 2001, faqe 174-175.

Kënga është kënduar prej grupit të burrave në vitin 1962. Tek arvanitasit e Greqisë në Mesogji në vitin 1978 është inçizuar kënga e kënduar prej fëmijëve kur dilnin në ditën e llazoreve.

Ti, moj nuse e re,  
Jepi Lazarit një ve,  
Pse ka dhrom e do të ve  
Ade batanë  
Të skalisnjë bozdanë,  
T,e skalisnjë me grep t'ergjëndë,  
T'e potisnjë me ver' t' emblë,  
Erdha Lazari për ve,  
Ngru, ti nusezë e re,  
Të qëndismë nga një ve,  
T'e tregojmë ndë More,  
Çë jan' tërë të kështe,  
Hanë gjalpë edhe ve.

Thimi Mitko na sjell një llazore të kënduar nga arvanitasit e Greqisë në vitin 1878.

Erdhi Lazëri mbë derë,  
Bjeri pulësë të pjellë,  
Jepi Lazërit një ve,  
Se u err e do të ve.  
Do të vejë ndë More  
Janë turqit e krishte,  
Hanë gjalp e monove.  
Ng' atje para vjen andara,  
Shën mëria tye klara,  
Tye klar' e tye thirrë,  
Se i vranë monobirrë,  
Mbëlethni lule, lule malit,  
Të ia vëmë torrë varit.

Në librin e G. Mayer, *Albanesische Studien VI, Vienë 1897, faqe 293-294*, kemi disa lloj llazoresh, të cilat po i paraqesim:

Lazare, o Lazare!  
Ngrehu, ngrehu, se u err.  
Erdhëm të kërkoim një ve,  
Të na bojë nuseja nder.  
Ti, moi lule kumbulaise,  
Nderomë, moi bukuraise,  
Nganjëherë mot për mot,  
Zonj e shtëpis për shumë mot!  
Nemë, ti, një koqe ve,  
Ashtu qofsh, gjithmon' e re,  
Zoti t'boft më mir se je,  
N'daç në qiell një koqe fik,  
Ashtu u gdhifsh sa një çalik,  
Në më dhanç një dor barot,  
Çuni jyt u boft dhëspot.  
Në më dhanç një koqe ballë,  
Çuni jyt u boft dhaskal.  
Sa lesh mbi ata desh,  
Kaqe të mira të kesh.  
Sa furka mb'ato kacolle,  
Kaqe nuse punëtore.  
Sa gjethe ka ay ulli,  
Aqe qypa me flori.  
Për shumë mot, për shumë viet,  
Burri jyt u boft një mbret.

Me interes është një llazore e kënduar nga arvanitasit e Greqisë.

Erdhi lazëri për ve,  
Jepja Lazërit një ve.  
Se u err e s'kemi nge,  
Se u err e do të ve,  
Të qëndisim nga një ve,  
Ta dërgonjëm në More,  
Ku jan tuti të kështer;  
Ku, janë Turq e të prerë,  
Anei gjarpëri le të vejë.  
Foli dria, drisë  
Zonjësë shtëpisë.  
Të na japë ven,  
Se s'ia kemi ngen,  
Anei po na vien një'andarë,  
Shëmëria tuke qarë,  
Pse karfosën monobirë.  
Ne, dy motëra po tirrim,  
Një vëlla edh ay vdekur!  
Si të bëjim të marrë jetën?  
Se s'duroimë, s'jemi hekur?  
A vështoni angonatë,  
Thikat e peronatë.  
Ato luletë të malit,  
Të m'ia vini torrë kreut.  
Aqe fletë sa ka dardha,  
Aqe zëmëra të bardha,  
Aqe flet sa ka ulliri,  
Aqe zëmra nikoqiri.

Nga materialet që ndodhen në Arkivin e Institutit të Kulturës Popullore llazoret janë kënduar në këto qytete e

fshatra: Berat, Durrës, Kavajë, Shënavlash, Elbasan, Fikas, Fier, Seman, Gjirokastër, Labovë, Kolonjë, Gostivisht, Leskovik, Postenan, Korçë, Bradvicë, Dardhë, Poloskë, Lushnje, Divjakë, Mat, Përmet, Këlcyrë, Potkozhan, Sarandë, Mursi, Xarë, Tiranë, Vaqar, Vlorë, Mifol, Poro, Qeparo, etj.<sup>22</sup>

### VAJTIMET PËR KRISHTIN

Të premtën madhe ose siç i thonë në gjuhën popullore të premtën e zezë, në qytetin e Korçës, fëmijët grumbulloheshin në oborrin e kishës. Në fytyrat e tyre shfaqej pikëllimi dhe dhimbja për Zotin Krisht. Prifti i famullisë i ndante në dy grupe: disa prej fëmijëve venin për të mbledhur lule të pranverës si për shembull manushaqe, lule-shqera, me të cilat zbukuronin epitafin, ndërsa grupi tjetër i fëmijëve shkonte shtëpi më shtëpi duke kënduar këngët e përvajshme të Krishtit.

Poshtë ndë Jerusalem  
Në Manastir të madh  
Atje pemë nuku kishte,  
Por pemë na u çfaqnë  
Pemë qenë Apostujtë  
Rrënjë qenë profitëtë  
Që dhanë shaitllëke  
Shaitllëk dhan' e thoshinë  
Për të hequrat e Zotit  
Tërë mbesojm më ty o Zot  
Për të këqijat që hoqe  
Sot është dita e zezë  
Sot tërë qielli nxihet

<sup>22</sup>-Lirika Popullore, Nr. 1, Akademia e Shkencave, Tiranë 1988, faqe 124.

Sot malet gjithë mbajnë zi  
Sot të gjithë vënë ngulmin  
Të ndyrit e çifutrit  
Të ndyrit' e të ligjtë  
Edhe të katharisurit'  
Që të mbërthenin Krishrin  
Mbretin' e gjithë dynjasë.

Këtë këngë, Ikonom Qirjako nga Korça ia ka rrëfyer Prof. Kostandin Trakos dhe ky i fundit e ka botuar në revistën “Jeta Kristjane” në okelion “Folklori Muzikor i Pashkës”. Në poezinë “Sibila delfica”, Pjetër Bogdani përshkruan vajtimin e Shën Marisë në momentin e kryqëzimit të Krishtit.

Vajtonj un' e mjera një të madhe gjamë,  
Se Krishnë mbë Kryjt rrafunë e keq shëmtuem  
Shëplaka, grushta, helm' e ufullë dhanë,  
Përgjegjunë shtatnë plagësh e irënuem  
Isr (a) eli mbë dhet keq nukë la pa i banë,  
Patërshanë ende mbë kryjt depërtuem,  
Dvekunës' amëse mbë prehënë ia dhanë,  
Zemërënë tu' i shituem anë e pranë.

Në kodikun e Kostandin Beratit gjendet vjersha “Zonja Shën Mëri përpara Kryqësë”.

Zonj' e Shën Mëri ardhurë,  
E mbretësh' e engjëjet,  
E kur e pa mbërthyerë,  
E qante ngashëryerë,  
Judha i mallëkuarë,  
E erdhë e të rrëmbyenë,  
Të shpunë të të gjykonjënë,

Qiturë shahit jallanxhi,  
 Të ndyninë e të pshtyninë,  
 Me të math zë thërrisninë,  
 Vallë ç' u pate bër' o bir,  
 Që mbë kryq të mbërthyenë,  
 O biri im i dashuri,  
 Qysh i duron mundimetë,  
 E ndenj përpara kryqsë,  
 Zonjë e gjithë dynjasë,  
 Shpëtimn' e njerëzisë,  
 Me mallëngjim thërriste:  
 Që kallëzoi çifutë,  
 Si uqër të pandieshm,  
 Ndë avlli të Pillatit,  
 Që të turpërojnë,  
 E të rrah e të shanë,  
 Atij Pillatit: vra-e!  
 A ç' të lig u punove,  
 E vdekë që të dhanë,  
 E djali im i ëmbli  
 Rrahur' e përçmuarë.

Në vjershtë përshkruhet tmerri që ndiente Zonja Shën Mëri në momentin që pa të birin të mbërthyer në kryq. Vjersha është përkthyer nga greqishtja. Autori i saj është Akakios Diakusis nga Qefalonia, i cili e ka botuar në vitin 1730. Në krijimin “Vajtimi i Marisë”, poeti arbëresh Jul Variboba përcjell emocionet e Marisë Hyjlindëse në momentin e kryqëzimit të Krishtit.

Qent Judhë, e çë ju bëra  
 E vëra vëra m' e bët kështu?  
 Ah, qenëri, pa lipisu!  
 Ju mua m' e vrat si dishët jy.

Thuajm tu, kuror, ti si e shpove?  
 Ti si rrëvove e njera ndër tru?  
 Këto këmb' e duar kush' i ka shpuar?  
 Gozdha mixore, ju qet', ju.

E kam me tij, llënx farmëkore,  
 Gjakun ja nxore tek ja dhe u.  
 Xemërën time ti, thika ime,  
 Ti si s' m' e there puru kështu?

Ma u ku vajta? Jeta m' u err,  
 Jam si e bjerr', me kë fjas u?  
 Ahi, ki dhullur thien edhe gur!  
 Më s' mund rronj, e djegur a u!

Kjo vjershtë gjendet në veprën “Gjella e Shën Marisë së Virgjër” të Jul Varibobës. Arbëreshët e Italisë këndojnë këngën “Dhulluret e Shën Mëris”.<sup>23</sup>

E penxoni sa për ne Zoti Krisht duroi;  
 Sa e jëma për të birin dhullure shkoi;  
 Sod çë janë dhulluret e Shën Mërisë  
 Ju mirnie vesh ju të zonjat e shpisë;  
 Pasjona e Zotit Krisht i qe ajo shpat  
 Sa zëmërën ja shpuan pa mbëkat;  
 E muartin qentë judhe Zotin Krisht, e zun  
 E lidhëtin me trikuzë ndë truall e shtun;  
 Ja ndëntin fort ndë krje me një gur  
 Sa i shpuan ashtin e syut e i vate ndë tru;  
 Zoti Krisht me kriqe ngrah tuke rënuar

<sup>23</sup>-C. Candreva–C. Stamile, Sperimentazione didattica in un ambiente bilingue arbëresh, Università degli studi Calabria, Calabria 1980, pagina 176.

Judhetë me shqeibe, hunjë tuke mallkuar.  
 E shaitin llatër i lig edhe magar  
 Menatet sa u di e prëmtja e madhe  
 E qelltin te Pillati me një thirmë të madhe.  
 Pillati lajti duart e tha: “U nëng e ngas  
 Se ki është Shëitë e u nëng mund e vras?”  
 E pra m’e qelltin tej ajo Anë  
 Atje përpara ju be ajo kundane.  
 U ndodhë e jëma me atë gojë t’ëmbëj  
 -O bir si të dhan këtë mortë  
 -Oi qetu, qetu ti mëmëza ime,  
 u mos njeriu, njeriu m’i bëra keqë,  
 u gjithëve, gjithëve m’i mbajta besë,  
 Atë e dhuristin e me atë thikë e shpuan,  
 Ja shtun ndë sisë e e dhullirtin shumë.  
 Gjaku i Zotit Krisht vej si lum,  
 E pra m’e qelltin tek ai pasi  
 Atje ju shkurtua ora edhe pasi.  
 -E oj bir, e u si mund rronj,  
 u këtë thikë si ka të e duronj?  
 E oj bir, e u si mund shihem,  
 u ndë këtë varr me tij dua të mbullihem.  
 Ngrëhij gjithë me lotë e me hjidhi,  
 Bëni kësaj rrexhin kumbanji. Amen.

Kjo këngë është marrë nga koleksioni i Antonio Santorit.  
 Poeti arbëresh Jul Variboba në librin “Gjella e Shën Mërisë  
 Virgjër” ka shkruar vjershën “Vajtimi i djalit”.

Bir, si të vranith?  
 Mua ku më lanith?  
 Si s’të pan’lipisi?  
 Si stë ndihu mosnjeri?

Bir, si të furnuanith!  
 Ku të vate ajo belic’?  
 Çë më jip aq llegric’?  
 Ruaj si të nxijtin, shih si të pështijtin;  
 Si të bën, bir o  
 Gjith qag’, mjera u, o!  
 Ka t’erth kjo kuror,  
 Kush’ t’ e their atë dor?  
 Këto këmb’ të ngriqësua  
 Cila gozdh t’i la të shpuara?  
 Edhe zemërën t’e shpuan,  
 Me një llën x t’e zbuluan!  
 Oj bir, sa pen’!  
 Mirrëm mua me vet-hen.  
 Pa bir u si të rronj,  
 Këtë thik u si t’e duronj?  
 Me tij, bir, dua të shihem,  
 Ndë këtë varr dua të mbëllihem.

Në krahinën e Cavallerizzos arbëreshët këndojnë këngën  
 “Farizena”.

Ma Farizet mblidhje i pan  
 e si e than krishtin e bën  
 Judha e tradhirti, qentë e ngjudhirtin  
 e një trikuzë ndë qaf ja vun  
 I dhan trumende sa s’pa njeri  
 E lipsi fare si s’pan  
 E tradhirtin ee fraxhellartin  
 Me shqejbe e me hunjë pasjon i dhan  
 Oi Zoti Krisht thua j m sa durove  
 Kur ti ngapove ndën këta qen  
 Dhimoni shtij, ai frij.

Si të furnuan turmend e pen  
 Të qofsha truar, për sa sufrite!  
 Për sa patirte, mua më salvon  
 Kur çë des u të sërres  
 Gjakun çë prishe, mos e harronj  
 Me kriqe ngrah Krishtin e shtunë,  
 Katinën i vun, e trashinartin.  
 U dhebullir e u avillir  
 rra edhe praptë, ndë mal Kallvari  
 Ahjera qe çë e jëma e ndiejti  
 E rra ndë truall për pen të forta  
 Syt perndoi, me lot i mbjoi  
 Sërriti: o bir, e rra për mortë.  
 Ju ëngjij çë bëni, ju kerubini  
 Ju serafini, vrao e rrëmbeni,  
 Kjo Zonjë juve ju qofsha truar  
 Ajo u valis, mos e lëreni.  
 Me kriqe ngrah, Krishti atje rra  
 Kur të jëmën pa, tha: Oi çë dhistin!  
 Mbëkatet e tona, Krisht kuito,  
 Çë qen kauzat e kësaj rruin;  
 Si desh Zotin, Krishti avroi,  
 Sa mundë rëkoi njera ndë kallvar  
 Ti Shëmëri me ata sy,  
 Ngrëji e tët bir kondemllar!  
 Oi ditë të tharta, ma ç'është kjo ditë  
 S'mund i fit e jëma një fialë  
 Kur armiqtë ja vun ndë kriqe  
 Shpirti i saj i pat mall  
 E jëma, "ku jini, eni e thoni,  
 Sa mir e doni një bir çë kini!  
 Me sa amur, me sa dhullur  
 Ju për një bir veni e vritij".

Ajo afër kriqes, ajo rrij e qaj  
 Bëri a një vaj sa guret thien  
 Ruaj a të bir çë dej mir,  
 E me gjiak lotë u përzien.

Kjo këngë është regjistruar me kasetofon më 25-03-1977 dhe këndohej nga: Melicchio Giorgina, Corbelli Giorgina, Madotdo Ilia, Muraglia Silvia, Rizzo Giuseppina, Melicchio Caterina.<sup>24</sup> Vajtimet e Krishtit që këndohen në shërbesën e epitafit janë përkthyer nga Fan Noli dhe janë botuar në librin *Shërbësat e Javës së Madhe*.

### Stanza e parë

Ti o Krisht o jetë, Ti u vure në varr,  
 edhe forcat engjëllore çuditeshin  
 dhe lavdi këndonin për denjimin tënd.  
 Si po vdes o jetë, si rri brenda në varr,  
 kur fuqinë e armikut e shtype krejt  
 dhe prej ferrit të varrosurit i ngjall.  
 Ty të madhështojmë, o Jisu Shpëtimtar,  
 dhe nderojmë që të gjithë varrimin tënd,  
 se prej vdekjes na shpëtove lavdërisht.  
 Ti o drit'e ëmbël, o Jisu Shpëtimtar,  
 si në varr e n'errësirë u fshehe sot?  
 o durim dhe o çudi që s'ka tregim.  
 Mbreti i vërtetë përmbi qiell dhe mbi dhe,  
 je megjithëqë u vure në varr o Krisht,  
 dhe fitove lavdërimë përmbi dhe.

<sup>24</sup>-C.Candrea-C. Stamile, Sperimentazione didattica in un ambiente bilingue arbëresh, Università degli studi Calabria, Calabria 1980, pagina 178-182.

### Stanza e dytë

Ty të meriton, madhërimi yu o jetëdhënës,  
se mbi kryq për ne i ndeve duart,  
dhe armikun e dërmovë plotësisht.  
Të spërkat me lot, nëna jote dhe vajton me kujë,  
kur u vure trupërisht në varr të zi:  
ngrehu Bir siç e parathe po të thërret.  
Mjera un' Bir, virgjëresha të vajton r thotë,  
kryezotin edhe mbretin e qiellit  
të dënuar përmbi kryëin e shikoj.  
Dielli u drodh, kur pa dritën e paperënduar,  
t'errësuar dhe në varr jetëdhënësin,  
fshehu dritën i tmerruar dhe u err.  
Jetëlindëse, virgjëreshë, nën' e pacënuar,  
eja dhe pushoi sherret e kishave,  
edhe paqen e paprerë na trego.

### Stanza e tretë

Gjithë gjeneratat, vaje të blatojnë  
o Krishti im mbi varrin.  
Arimantheani, të zbërthen prej kryqit  
dhe të varros me vaje.  
Myrrëprurëset erdhën, ta spërkatnë varrin,  
me lotë dhe me myra.  
Ngrehu jetëdhënës, nëna që të lindi,  
të thoshte e përlotur.

### PASHKA

Të Premten e Madhe fëmijët dilnin nëpër fshat e  
mblidhnin dru, me të cilat bënin një stivë të madhe. Në krye të  
stivës vendosnin një kafkë kafshe që simbolizonte vdekjen. Këtë  
stivë e ndiznin natën e Pashkës së Madhe pikërisht në momentin  
kur thuhej përlëshorja e Pashkës “Krishti u Ngjall”.<sup>25</sup>

Mbledhim dru për stivën  
Për stivën e madhe,  
Se po na vjen Pashka  
Pashka jonë e madhe,  
Pashka me ve të kuqe,  
Të gjithë çukanin  
Edhe thërrasim:  
Krishti ynë u ngjall  
Pashkët gëzuar.

Në krahinën e Odries besimtarët pasi kishin marrë pjesë  
në Liturgjinë e Ngjalljes vazhdonin të kërcenin dhe këndonin.  
Në sheshin përpara kishës vajzat dhe gratë e fshatit hidhnin  
vallen duke kënduar:<sup>26</sup>

As këndoni moj të mjera,  
Pashkë e madhe s'vjen nga hera,  
Po në mot, mot një herë,  
Na zëntë gëzuar  
Dhe duke kënduar,  
Na zëntë mirë e më mirë  
Ngado kemi kurbetllinjte

<sup>25</sup>-Traditë Popullore, Ngjallja, prill 1993, faqe 5.

<sup>26</sup>-Pilo Thanasi, Ringjallje e traditës orthodhokse në krahinën e Odries,  
Ngjallja, maj 2001, faqe 10.

Në Stamboll e Amerikë.  
O trandafili me vesë,  
Lumthi në për këtë besë  
Lumthi ne për Zonë tënë  
Që ra e ndriçoi vend,  
E na erdhi kryq t'argjend  
Kryq t'argjend e të florinjhtë  
Të falemi natë e ditë,  
Zoti Krisht, Zot i vërtetë,  
Me perona u mbërtheve  
Gjakun në kryq e derdhe  
Me gjak tënd se ç'na kungove  
Me ajazëm na bekove.

Në krahinën e Lunxhërisë në ditën e Pashkës, besimtarët  
orthodhoksë, të mbledhur në oborrin e kishës, këndojnë dhe  
kërcejnë këtë këngë të bukur popullore.

Ditën e Pashkës së Madhe  
Moj Zogo-zogo, me moj mes-hollo,  
Që luan kauri valle  
Moj Zogo-zogo, me moj mes-hollo,  
Luan e bija e kaurit  
Moj Zogo-zogo, me moj mes-hollo,  
Si thëllëza maje grurit  
Moj Zogo-zogo, me moj mes-hollo.

Moj Pashk' e madhe si nuri  
Gëzimet që bën kauri  
Gëzimet po do t'i ketë  
Sa të rrojë e sa të jetë.

Zoti Krisht, Zoti vërtet  
Për ne u mbërtheve vet,  
Me perona u mbërtheve  
Gjakun t'ënd seç na kungove  
Me ajazëm na bekove.

Kjo këngë është mbledhur nga Spiro Veli, me profesion  
mësues në Durrës. Prej tij e mori Prof. Kostandin Trako dhe e  
botoi në revistën "Jeta Kristjane". Në Peleponez arvanitasit  
këndojnë këtë këngë popullore, të cilën ma ka thënë një  
bashkëstudent gjatë kohës që studioja në Universitetin  
Kombëtar "Kapodistria" të Athinës.

Erdhën Pashkët e Mëdha  
Prifti i fshatit kësulë nuk ka  
U mblodhën gjithë ato gra  
Vunë të gjitha nga një pulë  
Ti blenë priftit një kësulë.

Në Perahora të Korinthit arbëreshët këndojnë:

Nani dë të lidhura,  
Ishtë puna sigura  
Ande la nga pilura  
Vinjënë të lidhura.  
Ndë të lidhura, ndë Pashkë,  
Do kërcejmë tërë bashkë.  
Ndë të lidhura, ndë Pashkë,  
Si të bëhemi të lidhimë bashkë.

Kjo këngë është regjistruar në vitin 1978. Të lidhurat e  
Pashkës janë kreshmët e mëdha. Jeronim De Rada në librin



“Këngët e Milosaos”, në këngën e dhjetë ka shkruar “Valle Pashkës”.

Zëgjou, trim, i agëzuam,  
In zot ljëreu var,  
Perëndonjën ikjëzit,  
Shuhen zjarret, derdhet ujt,  
Jeta veshet ndër të rea.  
Ashtu, zëmër ljpisjare  
Të të priresh e garepsur.  
Si nj’an inkarkuar me trima,  
Çë te mesi dejtit  
Pan katundit e dishëruar,  
Erdhe i hjieshim, pjot gare.  
Kush të mori sishit?

Në koleksionin e revistës “Jeta Kristjane” në okelion “Kangë Pashke” gjendet kjo këngë e Zef Skiroit.

O trandafili me vesë,  
Lumthi ne për këtë besë,  
Lumthi ne për Zonë tënë  
Që na e ndritoi vënë,  
Na hodhi një kryq t’ergjëndë  
Kryq t’ergjëndë e të floritë,  
T’a kemi për këto ditë  
Për këto dit’e mira  
Për Pashk e për Shën Thoma.

Gjithashtu poeti arbëresh Zef Skiro, në librin “Canti tradizionali delle albanese”, ka thurrur vargje për Ngjalljen e Krishtit.

Krishti u ngjall! Ai, tue vdekur  
ndrydhi vdekjen e shkretë  
e të vdekurvet te varret  
i dha gjellën e vërtetë  
Si një trim ç’u sgjua nga gjumi  
krisi e jiku nga martumi.

Fjala e t’lartit u mbarua:  
se të shuar ajo ngë ka  
Gjona duall nga barku i peshkut  
dritën Lazri prap e pa  
Rrasën nj’ëngjell e shpërvollit  
e nga varri jeta dolli.

Dolli dielli e shkrepit dheu  
shkeli krykji armikjt e fes  
Nzirni lypin, o të besmë,  
mvishni rrobat e harres!  
Krishti u ngjall vërtetë e rron  
përgjithmonë e mbretëron.

Vajzat arbëreshe kur gdhihej e diela e Pashkës këndonin këngën “Gjegjini vashaz somenatë”, me anën e së cilës ftonin shoqet për të festuar.

Gjegjini, vashaz, somenatë,  
Ju mos rrini më mbë shtrat,  
Diellja e Pashkëvet na u di,  
Ju mos rrini më ndë shpi.  
Kush e tuar e kush shtuall,  
Kush e ka nd’at argali,  
Le t’thinjë mbrënda ndë se duall  
E u mbëlliftë mbrënda ndë shpi!

Le t' rrirë pështjellë me një llunxuall,  
Kush e ka nd' ata mitarë!  
Ndë se prana hëngër derkun  
E ni, më nëng ka çë t' harë,  
Le t' zërë bashk' me xerkun.

Kjo këngë është kënduar në Frasnitë të Kozencës më 1894. Vajzat e veshura me rrobat më të mira, ftojnë njera-tjetrën duke kënduar dhe kërcyer. Në poezinë “Kur vinte Pashka e Madhe”, poeti peshtanak Llukan Stavro shpreh besimin dhe shprestarinë e tij për këtë ditë të shënuar.

Eh, kur vinte Pashkë e Madhe,  
Rridhte gëzimi si ujit!  
Shkonte gjithë Java në falje,  
Prisnim Ngjalljen e Jisuit.

Mbushej kisha me aroma,  
Me dafina dhe zambakë,  
Hidhnin lule duart tona,  
Mbi Jisunë në Epitaf.

Pastaj vinte ditë e diel,  
Pastaj gdhihej Ditë e Madhe,  
Dilte Zoti Krisht si diell,  
E prisnim me këngë e valle.

Pasi përfundonte ceremonia në kishë, të krishterët shkonin me lambadha të ndezura nëpër shtëpitë e tyre ku hanin darkën e Pashkës. Tryeza e kësaj dite të shenjtë përbëhej kryesisht nga qengji i pjekur, petaniku, qumështor, lakror, kalimare etj. Paradite të krishterët bënin vizita tek njeri-tjetri. Në këtë ditë të shenjtë ata vizitoheshin edhe nga myslimanët e

fshatit duke i qerasur me vezët e kuqe të Pashkës. Këto vizita ua kthenin myslimanëve në festën e tyre të Bajramit. Më të lumturit e kësaj dite qenë fëmijët, të cilët çukisnin vezët e kuqe. Ai që ia thyente vezën shokut duhet që t'ia merrte.

## SHËN GJERGJI

Në krahinën e Cavallerizzos, Kalabri në ditën e kremtimit të Shën Gjergjit arbëreshët këndojnë këtë këngë:

Mirë se ju gjëim bular,  
Ertim na Mbuzat të par,  
Shën Giergjin për hare  
Të këndoimë ndë këtë dhe.  
Zëm një valle e një kangjel  
Pa krapriole e pa rrotielë,  
Ma një kënkë për devocjon  
Sat mos lëm zakon.  
Shën Giergji kavallieri,  
Zëri i tij s'ka të rrëfier  
Leu bular e i bëgatë,  
Të krështet prindët i pat.  
Su djalë nd' ushtëri,  
Ritur qe ndër bulari  
Gjithë me llënzë e shpatë i theri  
Shën Gjergji kavallieri.

Kjo këngë është inçizuar më 15-04-1977 dhe këndohet nga: Melicchio Giorgina, Corbelli Giorgina, Madotto Ilia, Muraglia Silvia, Rizzo Giuseppina, Melicchio Caterina.<sup>28</sup>

<sup>28</sup>-C.Candrea-C. Stamile, Sperimentazione didattica in un ambiente bilingue arbëresh, Università degli studi Calabria, Calabria 1980, pagina 184.

Në Siçeli arbëreshët këndojnë “Të falemi i Shën Gjergj”.

Të falemi, i Shën Gjergj,  
O nder i math i jetës,  
Dëshmor i të vërtetës,  
I gjarpërit armik.  
Të falemi përdita,  
Të lutemi tue thënë:  
“O ndihm’ e horës tënë,  
mos lerna në rrezik!”  
Klyshedhra aq’ e tmeruarë,  
Çë ti lavose e preve,  
La farën, ç’edhe neve,  
Të zërë po kërkon...  
O shëjti thavmasor,  
Ti ndihma të guxojmë  
E vendin të shpëtojmë  
Nga ajo klëshedhr’ e shkretë.  
Të jet’ nga gjindja e lirë,  
I falur me haidhi,  
I larti perëndi,  
Nani e për mot’ e jetë!

Ditën e Shën Gjergjit nuset dhe vajzat në Picallë të Tiranës dilnin herët në mëngjes duke kënduar këngën “O Shën Gjergj i bardhë”.

O Shën Gjergj i bardhë,  
Njishti motmot m’gjeç me djalë!  
O shën Gjergj i mushtullu,  
Njishti motmot m’gjeç martu!  
Sa ky li,  
Të bahen flokt e mi.

Kjo këngë është kënduar në Picallë më 1953. Natën e Shën Gjergjit fshatarët zbukuronin shtëpitë dhe kasollet e bagëtive me degë të gjelbra dhe me lule. Në mëngjes fshatarët ngriheshin herët, bënin kurora dhe i vendosnin në kokë. Në ditën e Shën Gjergjit therrej një qingj. Në këtë ditë ndaheshin shqerrat nga delet dhe fillonte mjelja.<sup>29</sup> Në Greshicë të Kërçovës në ditën e Shën Gjergjit lyenin shtëpitë me gëlqere.

Shpija jon’ me tulla, me tulla,  
Na ka ardh’ shën gjergji me lula, me lula,  
Shpija jon’ e lyme me qireç,  
Ani e kemi lye për shën Gjergj.  
Shpija jon’ me cinglla, me cinglla  
E pritëm shën Gjergjin me çika, me çika.  
Shpija jon’ e lyme me horasan,  
Na po luhatemi në tok’ e n’tavan.  
Hul-hulaja, shkojmë ke daja,  
Rrijmë dy net, vijnë apet.

Në fshatin Shtikë të Kolonjës në të kremten e Shën Gjergjit gratë e vajzat kërcenin e këndonin përreth kishës që mbante emrin e shenjtit.

I Shën Gjergj, ta kemi mallë,  
More i Shën Gjergj,  
Për një lugëzë me dhallë.  
Dolla ditën e Shën Gjergjit,  
Humba sumbullat e jelekut,  
M’i gjetke i biri mbretit,  
M’i tretke plumba dyfekut.

<sup>29</sup>-Lirika Popullore, Nr. 1, Tiranë 1988, faqe 138-139.

Kjo këngë këndohej edhe në Bradvicë të Korçës. Poeti arbëresh Jul Variboba ka krijuar këtë vjershë për Shën Gjergjin.

A ke parë ti një furtunë,  
Kur gushti është në mest?  
Dheu erret, bëhet një pus,  
Qielli nxin si kadife.  
Gjëmimë, rrufë, shk reptima,  
Vetëtima e bubullima;  
Kokr' e breshërit më e lehtë,  
Sa një kokër vezë rose;  
Qele thyen e qeramidhe,  
Vret thëllëza e kafshë,  
Fiq, nërënza, dardha, mollë,  
Vreshta, ulinj i rreh si shtupë..  
Përmbytja vjen posi det,  
Mbyt mullarë dhe qe,  
Qan fshatari: "i mjeri unë"!  
Sivjet vajti vera me vaj!  
Shkarrim më të madh na solli  
Mbret' i egër kryeneç!

Në Elefsinë të Greqisë arvanitasit në ditën e Shën Gjergjit këndonin këngën:

Re Shin Gjergji, zoti im,  
Ti me kalë kavallar,  
Shum' të dua pse je trim,  
E të trembënë ga parë.  
Re shin Gjergji, je arvanit,  
Kapetan na ti të kemi,  
Falemi nat' edhe ditë,  
Si ti trima tër' të jemi.

Ti Shin Gjergj, na besove,  
Të luftojmë bashk, me kalë;  
Ga to pam' kondar' çë çove  
Edhe neve e bëm' pallë.

Kjo këngë e regjistruar në Elefsinë në vitin 1980 tregon që arvanitasit e nderonin Shën Gjergjin duke e quajtuar shenjtin e etnosit të tyre.

### RRUSHAJET

Në Hoçisht të Korçës në ditën e Rrushajeve grupe të rejash shkonin derë më derë duke kënduar dhe e zonja e shtëpisë u jepte miell, vaj e vezë për të gatuar një petanik:

Rusica, me Rusica  
Na dërgoi zoti Ristoz  
Për një doçkë miell  
Për një kupkë vaj!  
Rustica, me Rustica,  
Të bëj petanik, të ftonj,  
Të më vish për shënë Koll!  
Rusica, me Rusica!

Kjo këngë është kënduar në vitin 1962 nga Ollga Zakara. Kompozitori i kësaj kënge është M. Daiu. Këtë këngë e ka evidentuar dhe inçizuar E. Dheri. Në fshatrat e Prespës këndohej kjo këngë popullore:

Rusica, Rusica,  
na dërgoi daica,  
për një lugë gjalpë,  
që të bëjmë kulaçe,

të hanë fëmija,  
mos i zërë lija.

Kjo këngë është botuar në librin e Demush Shalës “Këngë popullore lirike”. Në zonën e Korçës këndohej edhe një këngë tjetër e ngjashme.

Rusica, Rusica  
Na dërgoi rusica  
Për një doçkë miell,  
Ta bëjmë kulaçe,  
Ta bëjmë pogaçe,  
Të ftojme Ristoze,  
Ristozi na ndihtë!  
Qirie eleison!

Në ditën e Rrushajëve në zonën e Korçës, gratë përgatisnin lakrorë, pogaçe, naforë dhe misra të zjerë. Gjatë kësaj dite organizonin piknikë në natyrë. Kjo e kremte quhet ndryshe edhe Pendikosti, sepse festohet 50 ditë pas Pashkës.

## SHËN PETRO

Në Dardhë të Korçës në ditën që kremtohej Shën Petro më 29 qershor, fshatarët dilnin për shëtitje tek “Kodra e Vogël” ku mblidhnin lulet shënpjetër.

Triko, triko, i shën Gjini,  
i shën Gjini shkoi e vate,  
po na vjen zoti shën Pjetër  
-I shën Pjetër, o biri im,  
kalle dorën e më qit,

-as të qit, as të kllas,  
po të shtie ndë kollas.

Nga krijimtaria e shumtë e Nolit po marrim poezinë “Shën Pjetri mbi mangall”, e cila pasqyron ngjarje reale të cilat i ndodhën Nolit pas kundërrevolucionit të dhjetorit të vitit 1924. Noli mbeti i braktisur nga miqtë, prandaj përdor simbolet biblike të mohimit të Shën Pjetrit, i cili e mohoi Zotin Krisht tre herë.

Mohimi i parë:  
Dhe një shërbëtore i tha:  
-”Je dhe ti një nga ata!”  
Po Shën Pjetri proteston,  
E mohon.

Mohimi i dytë:  
-”Nga ata je: -thot ajo.  
E mohon Shën Pjetri: “Jo!  
“As e njoh, as e kam parë,  
moj e marrë.”

Mohimi i tretë:  
Thot ajo: “Je, mos gënje!”  
Pjetri e mohon me be:  
“Jo, për Zotin, moj e marrë,  
s’jam e s’jam.

Kënga e këndezi simbolizon mohimin dhe tradhëtinë.

Kuspull mbi mangallin mblidhet,  
Po djeg dorën dhe përdridhet,  
Se ç’këndon bandill këndezi  
Nga qymezi.

-Simon Pjetri, Bar Jona,  
kështu ndahet kjo dynja:  
Kryqi andej, këndej buxhaku  
Dhe allçaku.

Se ç' vajton Shën Pjetri hidhur,  
Leshlëshuar, duarlidhur  
Tri her' e mohoj pagdhirë,  
Faqenxirë.

### PROFETI ILIA

Profeti Ilia ka qenë shumë i respektuar nga besimtarët, sepse ai është shenjti mbrojtës kundra thatësisë. Sipas një tradite sa herë bënte thatësi e madhe fëmijët me ikonën e Shën Ilias ndër duar silleshin nëpër rrugët e fshatit duke kënduar:<sup>30</sup>

O i Shenjtë Shëndelli  
as na jep një pikë shi  
të na bëhet gruri i ri  
ju shenjtorë, piamberë  
që ju lutemi përherë  
lutju Zonjës Shën Mari  
me kryq e me luvari.

Në Kolonjë në vitin 1878 këndohej kënga “Rri, rri, Shëndëlli”.

Rri, rri, Shëndëlli,  
Rri, moj zonjë, shë Mëri,  
Më një fron të art' e t'akullt,

<sup>30</sup>-Dhimitër Beduli, Profeti Ilia – Përfaqësues i denjë i Perëndisë, Ngjallja, korrik 1995, faqe 7.

Mba orë, mba korë,  
Mba zonë mbë dorë.  
Moj zonjë, zonj' e shtëpisë,  
Nxerrna rrogjen e rakisë,  
T'ua ndajmë djelmurisë.

Kjo këngë këndohej në ditën e Shën Ilisë më 20 korrik. Fëmijët shkonin shtëpi më shtëpi duke kënduar dhe amvisat i qerasnin.<sup>31</sup> Në Zagorie të Gjirokastrës në vitin 1958, fshatarët këndonin këtë këngë popullore:

Bjerë shi, o Shën Dëlli,  
të na bëhet misëri,  
misëri e gruri,  
të hajë kauri;  
kauri i varfër,  
gjashtë muaj z bathur,  
z bathur edhe zhveshur,  
me llërë përveshur.

Thimi Mitko tek “Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar”, Vol II, faqe 51 na sjell një këngë, e cila këndohej për të ndjellur shiun.

O Ilia, Ilia!  
Perperuga rrugëzaj,  
Bjerë shi, e perëndi,  
Se qajnë ca varfëri,  
Me lot' e me logori.  
Thekëri gjer' mbë çati,  
Gruri gjer' mbë perëndi.  
Kyrie eleison. (Tri herë)...

<sup>31</sup>-Lirika Popullore, Akademia e Shkencave, Tiranë 1988, faqe 194.

Në Berat këndohej kjo këngë.

Dordolec bjerë shi.  
O i zoti shënd Illi!  
As na ep një pikë shi;  
Të na bëhet grur' i ri;  
Një karroqe një kalli.  
Ju shenjtorë, piamberë,  
Që ju lutemi përherë,  
Lutij zonjës shën Mëri,  
Me kryq, e me luvari.

Gjithashtu edhe kënga “Rona, rona, peperona” bën fjalë për rënien e shiut.

Rona, roba peperona,  
Bjerë shi mbi arrat' tona.  
Të bënetë grurëtë,  
Të hanë kahurëtë.  
Të bënetë misëria,  
Që të hanë turqëria.

Në Peshtan të Tepelenës në të kremten e profetit Ilia, besimtarët mblidheshin në kishën e Shën Kollit dhe luteshin që të binte shiu i dëshiruar për prodhimet bujqësore.

Në Shën Koll, te kishë e lashtë,  
te një vend i shenjtëruar,  
tri krahina shkonin bashkë,  
prisnin shiun e vonuar.

Mblidheshin e kishën ndiznin,  
bëhej meshë e liturgji,  
dhe ashtu, në lutje, prisnin,  
Zoti i madh t' u hidhte shi.

Gjithë festimet si mbaronin,  
Ktheheshin prapë të gëzuar,  
Dhe, pranë fshatit kur afronin,  
Niste shiu i dëshiruar.

Llukan Stavro me anën e kësaj vjershe, motivet e së cilës i mban mend që nga fëmijëria e tij, rrëfen se në kishën e Shën Kollit, besimtarët e tri krahinave luteshin tek kisha e vjetër që Perëndia t' u dërgonte shiun.<sup>32</sup>

## SHËN E DIELA

Në fshatin Daullas të Fierit më 7 korrik kremtohet Shën e Diela. Të rinjtë e fshatit ngjiten në kodrën e Shën e Dielës duke kënduar.

O vajzë e bukur ëngjëllore  
E Diela jonë madhështore,  
O vajzë virgjëreshë nuse e Krishtit,  
Këtë fjalë dëshiroj thellësia e shpirtit.  
Me kërcënime, lajka e lutje,  
Ti Krishtin se hodhe tutje.  
O virgjëreshë që besimin na solle,  
Pësove, por kurrë nuk u dorëzove.  
Ty po të lavdërojmë o dëshmorja jonë,  
Besnike qëndrove për shpëtimin tonë.

<sup>32</sup>-Llukan Stavro, Peshtani, parajsë e bukur, Gjirokastër 2003, faqe 25.

Dhe ne përjetë do të kujtojmë  
Me plot të mira do të nderojmë.

Pas çdo vargu kori thotë: “E Diela jonë, shenjtorja jonë”.<sup>33</sup>

### SHËN MITRI

Në Drenicë këndohet kënga “Dita e Shën Mitrit erdhi prru’ në prrue”:

Dita e Shën Mitrit erdhi prru’ në prrue,  
Me shum’sende t’ mira ne na ka gëzue.  
Na kallxon për kohën, dimni si do t’ jetë,  
I vërenja delet qysh jan’ ra me fjetë.  
Nëse delja shtrihet me dy kamt e para,  
Dimni asht i butë, veç rueju për mrapa,  
Nëse delja shtrihet katër kambët tubë,  
Pregatit për dimën ushqim, dru e bukë.  
Dimni asht i vshtirë, pregatitu mirë,  
Mjeri ai i mjeri, qi rrin me duer lidhë,  
Dita e Shën Mitrit, ti qofsh e bekueme,  
Saher’ qi na vjen, ti na vjen e lume.

Arbëreshët e Italisë këndojnë këngën “E jëma e Shën Mitrit”:

E jëma e Shën Mitrit,  
E mbëjidh e bën kuxile,  
E mbëjidh diellin,  
E të m’e mbëllini n’ filaqi,  
E përpara stisur me botë,

E mos t’i hini fare dritë  
E të më sill bononatë,  
E vjen vera e bën vapë,  
E dimëri, mot’ i mirë  
E të më bëni grurë shumë,  
E të martojmë ata ganjunë,  
E të më marrësh ato kopile,  
Çë më rrin’ helmuarith.

Kjo këngë është gjetur në Shën Kostandin Albaneze, në vitin 1972. Kënga këndohet në muajin tetor për të mbjellat ku arbëreshët i luten të jëmës së Shën Mitrit. Shën Mitrin dhe Shën Gjergjin arbëreshët i quajnë si mbrojtësit e Skënderbeut. Ata këndojnë këngën “Të falemi Shën Mitër”:

Të falemi, i shën Mitër,  
o trim i Shqipërisë!  
Dëshmor i Perëndisë,  
luftëtar i shenjtes besë.

Te jeta e trubulluarë  
një zjarr thellonjës kleve;  
ndër t’errëti shkëlqeve,  
si drita në mëngjes.

Si drita e dëshiruarë  
çë mund me rreze natën,  
ti munde ashtu mëkatën,  
e t’egërin armik.

<sup>33</sup>-Florika Prifti, Festë në kodrën e Shën e Dielës, Ngjallja, gusht 1997, faqe 7.



Me shpatë edhe me fjalë,  
ng' u lodhe tue luftuar,  
më këmbë dhe kaluar  
u njohe i s' drejtës mik.

I but me ata të butit,  
i binde e i krështerove,  
të keqit i pushtove  
e i prishe me rrëmbim.

Sa u duk më një herë,  
pëllumb edhe sqyfterë,  
edhe po pate nder  
në luftë e në pushim.

Po kë më të lëvdoshëm,  
se Tyj ka pasur dheu?  
po kur po kur na leu  
n' do një m' i fort se Ti?

Shumë yjezë të bukurë  
shëndrisin lart në qiell,  
po i vetëm një diell  
si i vetëm je dhe Ti.

O gjak i gjakut t'ënë:  
i trimave i pari  
të truhet tyj shqiptari,  
ku ndodhet e jeton.

Si Nestorin shënjoje,  
me shëngun e t'yn Zoti,  
të shkelnjë, si që moti,  
të huajin ç'e mundon.

Jipi fuqin e besës,  
çë Ti me gjakun mprve,  
tue vdekur, posi rrove  
për Zotin e vërtet.

Për Zotin çë rri krenoshëm  
me flamurin në dorë,  
vështro me mall ktë Horë  
çë bë polemi yt.

O trim çë rri krenushëm,  
me flamurin në dorë,  
vështro me mall ktë horë,  
çë bë polemi i jit.

Polemi shumë i dashur,  
ç'u shporr në vënt të huaj  
lirin' e fen' të ruaj,  
nga i nëmuri isllamit.

Kjo këngë e shkruar nga Zef Skiro në librin “Canti tradizionale delle Colonie Albanesi di Sicilia”. Ajo është kënduar në Sicili në vitin 1923. Të kremtet e Shën Mitrit dhe Shën Gjergjit janë më të shënuarat në kalendarin liturgjik arbëresh.<sup>34</sup>

---

<sup>34</sup>-Lirika Popullore, Akademia e Shkencave, Tiranë 1988, faqe 198-199.

Shën Mitri festohej në mëyrë të veçantë në Peshtan. Fshtatarët në këtë ditë të shënuar këndonin:

Festë e bukur e Shën Mitrit,  
na i gjente shtëpitë plot;  
mblidhte prodhimet e vitit,  
festë e bukur e Shën Mitrit.

Na buronin këngë prej shpirtit,  
për një Shenjt dhe për një Zot;  
festë e bukur e Shën Mitrit,  
na i gjente shtëpitë plot.

Shën Dhimitri kremtohej më 26 tetor dhe ikona e shenjtit zbukurohej me lule, të cilat quhen “Lulet e Shëmitrit”.<sup>35</sup>

### SHËN THANASI

Në Kalabri kur dikush kishte nxjerrë krahun mjeku popullor në kohën që i përgatiste jakinë i këndonte “Racjona e Shën Thanasit”.<sup>36</sup>

Shën Thanasi tukë qarë  
Ju përpoq Shën Mëria:  
-Ti tanas çë ke çë qanë?  
Kam mëmem sëmure.  
Çë ka e çë nëng ka?  
Ka krahët e këputur.

<sup>35</sup>-Llukan Stavro, Peshtani, parajsë e bukur, Gjirokastër 2003, faqe 108.

<sup>36</sup>-C.Candreva-C. Stamile, Sperimentazione didattica in un ambiente bilingue arbëresh, Università' degli studi Calabria, Calabria 1980, pagina 78-79.

Ti nëng di të ja shëroshtë  
E u nëng di të ja shëronj.  
Ec te jardini im  
E më këput tri fjeta rrutë  
E i bën tri herë sputë  
Oj ti Kozmë e Damian,  
U fërkonj e ti shëron.

Sipas traditës, Shën Kozmai dhe Damjani qenë mjekë popullorë, të cilët i ofronin shërimet e tyre falas, prandaj populli i ka quajtur anargjendë.

### SHËN KOSTANDINI

Miku im Dhjakon Kostandin Tuda më ka thënë një vjershë, e cila tregon për zemërgjerësinë e Kostandinit të Madh.

Gjatë një kryengritje popullore,  
rebelët qëlluan me gurë,  
mbi statujën e Kostandinit.  
Gurët ranë si breshër mbi shtatore,  
duke ia dërmuar fytyrën trimit.  
Më pas oborrtarët  
zunë shumë nga ata  
dhe i shpunë  
tek Kostandini të irrituar.  
-Madhëri ç' dënim jepni për këta  
që qëlluan mbi statujën  
tuaj të shenjtëruar?  
Ç'janë këto që më thoni,  
ju drejtua atyre Kostandini  
duke kaluar gishtërinjtë

nëpër fytyrë.  
-E pra unë nuk kam asnjë  
plagë siç e shihni  
prandaj ata që keni zënë  
lërinë të lirë.

## **TË KRISHTERËVE TË SHQIPËRISË**

Vjersha e titulluar “Për ndimë të gjithë krështenimit  
Arbënit” u kushtohet të gjithë të krishterëve të Shqipërisë.  
Autori Pjetër Budi me anën e kësaj vjershe gërsheton dashurinë  
për fenë dhe atdhenë.

Të kërshterë, o ju qi jini,  
Nd’ Arbënë të pagëzuom,  
Qi fenë mirë e dini  
Se u ashtë për të shëlbuom,

Këtë letërë e përzini  
Qi juve kam dërguom,  
Gja kafshë n co të xini  
Këtë jetë tue shkuom.

N’ dorë e merri, ekëndoni,  
Ju qi dini me kënduom,  
Vini veshët e ndëgjoni,  
Ju qi dini me ndëgjuom.

Këto fjalë i ligjëroni,  
Si kankë tue kënduom,  
E ma za t’i vjershoni  
Fort t’amblë e të ngushlluom.

Vetëhenë ta qërtoni,  
Lotë tue i lëshuom,  
Atë jetë ta kujtoni  
Ndë shpirt tu’lulëzuom.

N cë mirashit mos mëngoni,  
M cë keq tue u larguom,  
Tënëzotë e ta lëvdoni,  
Mirë tue vepëruom.

Qi motnë të mos e shkoni  
Ndë mkat pçtjellë e ngatëruom,  
Po jetënë ta kujtoni,  
Qi u ashtë për të shëlbuom.

Asgja mos lakëmoni  
Mbë dhet me zotënuom,  
Po qielltë dëshëroni,  
Qi u janë përmetuom.

## **ORTODOKSIA**

Mitrush Kuteli në poezinë “Të falem ty” tregon  
shprestarinë e tij ndaj ortodoksisë.

Të falem ty, fe e lashtë e vendit  
Tim e mburuar drejtpërdrejt nga  
Fjala dhe e njesuar me Fjalën.  
Të falem ty, fe e qëndrimit dhe e  
Durimit, fe e martirëve dhe e  
Dëshmorëve, fe e paqes dhe e drejtësisë.

Të falem ty, fe e gjyshëve  
zemërbardhë e shpirtmëdhenj, që të  
përqaftuan sapo u linde e si u linde,  
që të mbajtën të përgjakur e të  
përlotur një kohë me gjuhën e kombit.

Ti i dhe kombit tim dritën e Ungjillit  
dhe kombi im të fali Shën Konstandinin  
dhe mijëra martirë, që me gjakun e tyre  
I bënë të përjetshme themelet tona.  
Ti frymëzove Joanin e Vojsavën,  
Në qëndrimin e tyre të përlotur e  
të përgjakur për mbrojtjen e kësaj toke.  
Tia na dhe zemërgurin Gjergj Kastriotin.

Që i vuri gjoksin rebeshit të Azisë.  
Ndaj teje, fe e shën Jonit dhe e Shën Marenës,  
thyer gjuri im si u pat thyer gjuri i atit,  
I gjyshit dhe i stërgjyshit gjer në njëzet breza.  
Ndaj teje fe e manastireve të gurtë,  
E ajazmave të shenjta, e altarëve të rënuar,  
Kodër më kodër të përhapura në gjithë vendin tim  
Ne shtojmë shpirtrat tona të përvojtura dhe mbështesim  
Shpresat tona, gjithmonë të gjalla e të patundura.  
Të jam falur e do të falen ty,  
fe e shenjtë e Papa Kristos nga Negovani,  
e Papa Dhimitrit nga Ballkameni  
dhe e të gjithë martirëve të ungjillit shqiptar.  
Ti i mbajte kombit tonë  
legjendat e Kostandinëve e të Garentinave,  
këngët e stërlashta, zakonet e mburura,  
nga vetë fryma e kësaj toke dhe e këtij kombi.  
Mbulesë e shenjtë kundrejt breshit e kohës.

## KREU I DYTË

### FLIJIMET NË BALADAT E POPUJVE

**G**jatë rrjedhës së historisë tradita popullore është frymëzuar nga motivet Biblike. Është shumë interesant fakti se duke marrë shkas nga i njëjti motiv Biblik, popuj të ndryshëm kanë krijuar balada të ndryshme. Baladat janë krijime folklorike epiko-lirike në vargje dhe kanë natyrë tregimtare. Në tematikën e baladave shqiptare vendin kryesor e zë një dukuri e mbinatyrshme për shembull sakrifikimin e njeriut në ndërtimin e kështjellës, urës, kishës etj. Poeti popull i ka transmetuar baladat brez pas brezi duke mishëruar vlerat shpirtërore. Baladat kanë efekt të fortë dramatik, si për shembull lidhja e besës ndërmjet vëllezërve dhe thyerja e saj, murimi i një gruaje me foshnjën e saj, dashuria për fëmijën etj. Më interesantja është balada e murimit, në thelb të së cilës është sakrifikimi i njeriut.<sup>1</sup>

Flijimet bëheshin që në kohët e lashta dhe shumë prej tyre nuk qenë vetëm fljime kafshësh, por edhe njerëzish. Me anën e fljimeve njerëzit besonin se zbusnin zemërimin e Perëndive. Në Dhiatën e Vjetër tregohet se si kryheshin flijimet. Me anën e fljimeve njerëzit i shprehnin falenderimin e tyre Perëndisë. Por edhe Perëndia vinte në provë besimin e njerëzve. Rasti më tipik është ai i Abrahamit: “*Mbas këtyre gjërave*

<sup>1</sup>-Mark Tirta, Etnologjia e Shqiptarëve, Tiranë 2003, faqe 481-482.

*Perëndia e vuri në prvë Abrahamin dhe i tha: -Abraham! Tani merr birin tënd të vetëm Isakun dhe sakrifikoje në vendin që do të tregoj. Kështu Abrahami u ngrit herët në mëngjes, morri birin, preu dru për të bërë sakrificën dhe u nis drejt vendit ku i kishte thënë Perëndia” (Zanafilla 22, 1-3).*

Gjithashtu edhe krishterimi ka flijimet e veta, të cila janë të papërgjakshme. Një ishte i përgjakshëm, flijimi i Birit të Perëndisë në Golgotha. Ky sakrifikim i Krishtit, anulloi të gjitha flijimet e përgjakshme dhe përsëritet pa gjakderdhje sa herë që celebrimet Liturgjia Hyjnore. Flijimi i Krishtit në Kryq me vetëdashje, duke u sakrifikuar për shpëtimin e botës ka ndikuar dukshëm në legjendën e murimit. Nëpër popuj të ndryshëm balada e murimit ka patur një efekt të madh, për vetë faktin sepse nusja e re që do të flijohet duke u murosur, bekon veprën që do të ngrihet. Studiuesit kanë evidentuar rreth 800 variante të “nuses së murosur”, ndër të cilat mund të përmendim atë: shqiptare, greke, serbe, maqedonase, hungareze, armene, bullgare etj.<sup>2</sup>

Tek baladat rumune, në ndërtimin e manastirit të Argjeshit, flijohet gruaja e kryemjeshtrit Manol, ndërsa ato të Transilvanisë bëjnë fjalë për flijimin e gruas së kryemjeshtrit Klemen. Në një baladë greke tregohet se qenë tre motra: më e madhja u flijua në ndërtimin e Urës së Danubit, e mesmja në themelet e Kalasë së Kaninës dhe e vogla në Urën e Artës. Në të gjitha baladat që përmendëm bëhet fjalë për tre vëllezër muratorë, të cilët ndërtojnë një kishë, një urë ose një kështjellë. Ç’farë ndërtojnë gjatë ditës u shembet gjatë natës. Për të kuptuar më mirë prezencën e motivit Biblik në baladën e murimit po analizojmë disa shembuj: atë të ndërtimit të kështjellës së Shkodrës, të urës së Artës në Greqi, urës së Kordhocës mbi lumin Drino në Gjrokastër etj.

<sup>2</sup>-Shaban Sinani, Paralele motivesh biblike ne epikën popullore shqiptare, Kultura popullore, Nr 1,2, 1996.

-Sipas baladës së lashtë tre vëllezër vendosën të ndërtojnë kalanë e Shkodrës. Ata punonin gjithë ditën, por muri u shkatërrohej natën dhe i gjithë mundimi u shkonte kot. Atëhere vendosën që t’ia tregojnë këtë një plaku të urtë, i cili ju tha se duhet të flijojnë dikë në muret e kështjellës. Pasi diskutuan me njeri-tjetrin vëllezërit vendosën të flijonin njerën prej grave të tyre, që do të sillte ushqimin e drekës të nesërmen. Dy vëllezërit më të rritur u thanë grave të tyre që të mos shkonin, ndërsa vëllai më i vogël nuk i tregoi, kështu fati i ra që të murosej gruaja e tij. Këtu është edhe pika më kulmore e legjendës, pra besnikëria e vëllait të vogël dhe flijimi me dashje i gruas së tij. Veçse ajo u kërkoi që kur ta flijonin t’i lihej pa u murosur, gjiri i djathtë për të ushqyer foshnjën e saj të mitur, dora e djathtë, për ta përkëdhelur si dhe këmba e djathtë, që të përkundte djepin. Madhështia e këtij momenti sublim qëndron në vargjet e fundit të legjendës, ku duket qartë flijimi i saj me dashje.<sup>3</sup>

Amanet o po ju la  
Kur në mur-o t’ më muroni,  
Syn e djathtë t’ ma lini jashtë,  
Dorn’e djathtë t’ ma lini jashtë,  
Këmbn’e djathtë t’ ma lini jashtë,  
Se kam lanë djalin e vogël,  
E kur t’ nisin djali gjamën,  
Me njan sy ta shikoj,  
Me njan dorë ta nërgoj,  
Me njan kambë ta lurtoj,  
Gjini em u nguroftë,  
E kalaja u forcoftë,  
Djali em e gëzoftë.

<sup>3</sup>-Mithat Dibra, Kështjella Rozafa, Shkodër 2001, faqe 6.

Pra ajo që sakrifkohet është nusja e djalit të vogël. Themelet e kalasë ngrihen vetëm pas murimit të saj me dashje. Nëna flijohet, por djali do ta gëzojë kalanë. Gratë që nuk kanë gji shkojnë nëpër kala ku ka ndonjë lagështirë a pikon ujë dhe njomen me të për tu ardhur qumështi. Në kalanë e Drishtit gjendet një vend që pikon ujë dhe populli e quan *Gruecica*, në kujtim të gjirit të gruas së murosur.<sup>4</sup> Në librin e G. Meyer “Albanesische Studien”, botuar në Vienë më 1897, gjendet balada “Murimi në kështjellë”, e cila është shkruar nga një autor anonim.

Kishin qan tre vllazën bashk,  
Kishin marrun tredhet ostallar,  
Dun me banun një kala,  
Ne kalaja s’po qënron,  
Nuk qërnon, as nuk po ban,  
Për pa i shti një sen kurban.  
Të tre vllazën bisedonin,  
Gravet e veta mos m’u kallcue,  
Nja çë të vijë me pru bukë,  
Ta banin kurban; të shtain në mur.  
Amanet kunati i par,  
Tha, po ç’ka burri em si qan,  
Na i ka tret mëhyri i gishtit,  
Ti mo qaj. More burr,  
Se me hejë për gjithë dugai,  
Amanet, more lal!  
Ti me pushkë nuk je tu m’vra.  
Ti me shpat nuk je tu m’pre,  
Por m’qet n’themel të kalas;  
Cicën e diatht ma lini jasht,  
Kur të bahet e treta dit,

<sup>4</sup>-Këngë popullore legjendare, zgjedhur e pajisur me shënime nga Q. Haxhihasani, Instituti i Shkencave, Tiranë 1955, faqe 5, 10.

Bni dialin të m’pain zit,  
Por zin tem zoti mos e shterpoft,  
Ket kala zoti e forcoft,  
Diali em e gëzoft,  
E kral u baft e mren luftoft.

Një histori e ngjashme ndodh me ndërtimin e urës së Artës në Greqi. Këtë na e sjell deri në ditët tona një këngë popullore e shekullit XVII.

Dyzet e pesë ustallarë dhe gjashtëdhjetë çirakë,  
Një urë themelonin në të Artës lumë.  
Tërë ditën e ndërtonin dhe u shembej në darkë,  
Vajtojnë ustallarët dhe çirakët qajnë:  
Tërë ditën e ndërtonin dhe u shembej në darkë.

Shkoi një zog e u ul përballë tek lumi,  
Si zog nuk cicëronte, por si dallandyshe,  
Vetëm thoshte me të folur njerëzore,  
Njeri po s’u muros, urë nuk qëndron.  
Jetim mos murosni, as të huaj, as kalimtar,  
Vetëm gruan e bukur të kryeustait,  
Që vjen vonë pas agimit ose ndanë muzgut.

Balada greke e thekson që të mos murosjet jetim ose kalimtar, por gruan e bukur të kryeustait, ndërsa në baladat shqiptare vërrejmë që murosjet herë një budalla, herë një kalimtar kureshtar dhe herë një njeri me ngjyrë. Sipas traditës gojore, tre vëllezër ustallarë po ndërtoni urën e Bogdanit, e cila bashkon brigjet e lumit të Vlorës pranë Shushicës. Mirëpo përpara se të arrinte gruaja që do të flijohej, kalon andej rastësisht një budalla. I shtyrë nga kureshtja, ai i afrohet aq shumë gropës, sa që mjaftoi

vetëm një e shtyrë e lehtë dhe ai ra brenda në themel dhe e murosën.

Bënet një urë në lumë,  
Hoj, hoj, e mjera unë!  
Punojnë tre ustallarë:  
U nis nusja për në urë,  
Po pa sosur kjo në urë,  
Shkon te ura një i lënë  
Po ustallarët ç'bënë?  
Njëri-tjetërin dhanë shënjë:  
“ta hedhëm këtë të lënë,  
të shpëtojmë njerinë tënë!”

Sipas rapsodit që ka krijuar baladën, njeriu i marrë duke u flijuar u bën një shërbim njerëzve, u mban urën. Gjithashtu u shërben edhe ustallarëve duke i lehtësuar nga pabesia. Sipas mbledhësit të folklorit Niko Tyto në urën e Këlcyrës u flijua një jabanxhi nga Përmeti, i cili kishte ardhur për të bujtur tek një miku i tij. Të nesërmen ishte e dielë dhe shumë njerëz qenë mbledhur tek këmbët e urës. Dikush nga paria e Këlcyrës nxori nga xhepi një kuletë të mbushur më para dhe pasi ua tregoi të pranishmëve e hodhi tek këmbët e urës. Dikush u hodh për ta kapur dhe turma e njerëzve menjëherë e mbuloi me gurë. Pyetën se cili ishte dhe miku i tij u përgjigj: -Ishte Muco Hysos nga Përmeti, e kërkoi dhe e gjeti! Që nga ajo kohë u quajt ura e Muco Hysos.<sup>5</sup> Një histori shumë interesante ka ndërtimi i urës së Bratit, mbi Lumin e Vlorës. Ustallarët kishin vendosur që flijimin t'ia linin rastësisë. Në këmbët e urës do të flijojë ai burrë që do të lëshonte hijen mbi gurin e themelit. Sipas baladës, për ndërtimin e urës së Tepelenës, u flijua një “evgjit” nga Përmeti, i cili quhej Mehmet.

<sup>5</sup>-Niko Tyto, Ura e Muco Hysos, Maleshova, Dhjetor 2009, faqe 6.

Tepelenë kur u bë ura,  
Shoqeni, motrani,  
Seç punonin njëzet burra,  
Po ura nuk u qëndronte,  
Vinte nata ua rrëzonte,  
Një njeri kurban kërkonte.

Dërgon pashai në Përmet,  
Me gjongul kush na do vetë.  
U ngrit një evgjit e erdh,  
Emërin ja thoshnë Mehmet.  
Erdh Mehmeti dhe e shpunë,  
Në themel t'urës, në lumë,  
Në gropë të thellë shumë.

Në Zagorie të Gjirokastrës “Balada e murimit” bën fjalë për ndërtimin e urës, jo prej ustallarëve, por prej djemve të një nëne, e cila i këshillon që të flijojnë njerën prej grave të tyre:

Puna e mbarë, o djemt e mi!  
Mirëse erdhe, moj nëna jonë,  
Kemi tre vjet që punojmë,  
Dhe dot urën s'e mbarojmë.  
U mësoj unë, o djemt e mi:  
Këtu lipset një njeri,  
Ta vini besa besë,  
Kush t'ju sjellë nesër drekë...

Është meritë e Agron Ficos, i cili gjatë një ekspedite në fshatrat e Zagories në vitin 1959 evidentoi “Baladën e murimit”. Balada e ndërtimit të urës së Mbretit mbi lumin e Kalasës, ndërmjet Delvinës dhe Sarandës është kënduar dhe kërcyer nga grupi i grave.

Çish s' u bë një urë në lumë,  
 Korba unë e qiqja unë,  
 Të shkojnë turq e kaurë  
 Musi Ura e Glinës,  
 Matanë Delvinës!  
 Dhe tre ustallarë ç' u ngrënë,  
 Të tre vëllezër qenë  
 Vanë e hapënë themelë,  
 Të bënin të shkretën urë.  
 Sa bitisnin një rën këmbë,  
 Kur zinin tjetërën t' e bëjnë,  
 Këmba që qe ngritur,  
 Në saba vithisur!  
 Si t' ia bëjmë e tek t' ia bëjmë?  
 Thotë i madhi, "s' kemi ç' bëjmë,  
 Një na gratë kurban do bëjmë.

Legjenda e ndërtimit të urës së Kordhocës në Gjirokastrë tregon për pabesinë që i bënë dy vëllezërit më të rritur, vëllait të tyre të vogël.

Atje poshtë bëhej një urë,  
 Hoj, hoj e mjera unë.  
 Tre vëllezër që punonin,  
 Dot urën nuk e mbaronin.  
 Sa ndërtonin një rën këmbë,  
 Të ditën kur doj t' e bëjnë,  
 Këmbë e parë u kish rënë.  
 Ditë për ditë punojnë kot,  
 Ur' e shkretë s' qëndron dot.

Ç' ke o burrë, që qan me lotë?  
 Më ra çekiçi në gropë!  
 Çekiçin o ta marr unë,  
 Po mos u s' këllidis shumë,  
 Se s' qan burri për një grua,  
 E mer më të mirë nga mua!  
 Moj e shkretë, çfarë më thua,  
 Unë s' qaj se mbeçë pa grua,  
 Po qaj për vëllezërinë,  
 Që më bënë pabesinë.

Në vargjet e fundit nusja i drejtohet me dhembshuri dhe humanizëm të shoqit, ndërsa ky i fundit duke dalë nga rrethi i ngushtë i lotit tregon vizionin më të gjerë të dhimbjes duke qarë për pabesinë që i bënë vëllezërit. Kjo legjendë bën fjalë për urën e Kordhocës mbi lumin Drino, në jug të Gjirokastrës.<sup>6</sup> Në Lin të Pogradecit është gjetur një variant, i cili tregon se murimi bëhet në kishë.

Qënkëshin tre vëllezër,  
 Zënkëshin të ndërtojnë një kishë,  
 Ditën nis, natën prish.  
 -Puna mbarë, o djemt e mi!  
 Mirëserdhe, o baba ynë!  
 Ku u gjend e mbara jonë?  
 Ditën nis e natën prish.

Ky është i vetmi variant shqiptar ku tregohet se murimi bëhet për ndërtimin e kishës.<sup>7</sup>

<sup>6</sup>-Fatos Mero Rrapaj, Këngë popullore të Labërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Akademia e Shkencave, Tiranë 1991.

<sup>7</sup>-Vladimir Zoto, Balada shqiptare, Dasara, Tiranë 2006, faqe 51-52.



## NË DITËN E PASHKËS SË MADHE

Balada e ngjalljes ka gjithnjë në qendër një person, i cili ngrihet prej varrit për të përmbushur premtimin që ka dhënë dikur. Në vargun e parë, kjo këngë paraqet atmosferën e gëzuar të Pashkës. Heroi i baladës Kostandini ka cilësi hyjnore. Ai ngjallet dhe shëmbëllen me Mesinë. Fenomeni i ngjalljes gjithnjë shoqërohet me ngritjen në qiell. Në Dhiatën e Vjetër kemi rastin e profetit Ilia, i cili u ngrit në qiell me një karrocë të artë.<sup>8</sup>

Në Dhiatën e Re, Krishti u ngjall dhe pasi u ngjit në qiell, rri më të djathtë të Atit. Fenomenin e ngjalljes e hasim në baladën e Kostandinit dhe Dhoqinës, e cila ka në qendër të saj, dëshirën e njeriut për të riardhur në jetë. Kemi rreth 300 variante të kësaj balade, ndonëse në popuj të ndryshëm emrat e heronjve ndryshojnë ideja është e njejte. Aretia dhe Kostandini në greqisht, Dhoqina dhe Kostandini në shqip, Jelica dhe Jovani në serbisht, Pektana dhe Llazari në bullgarisht, Vojka dhe Kostandini në rumanisht etj.<sup>9</sup> Balada e vëllait të vdekur ka një shtrirje të gjerë në popujt e Ballkanit. Janë rreth dyzetë e tre variante greke, gjashtë shqiptare, katër kuçovllahe, pesë rumune, njëmbëdhjetë serbe dhe shtatëdhjetë e tetë bullgare.<sup>10</sup>

Në folklorin shqiptar kjo baladë paraqitet në disa variante: 1) Varianti i Zagories, i njohur me emrin Kostandini dhe Dhoqina, 2) Varianti i Malësisë së Veriut, i njohur si “Besa e Hallil Garrisë”, 3) Varianti arbëresh, i cili në Kalabri quhet “Kostandini dhe Gerantina”, ndërsa në Sicili “Kostandini dhe

<sup>8</sup>-Jovan Joco, Të dhëna mbi mbretin e shenjtorëve dhe disa shenjtorë, faqe 14.

<sup>9</sup>-Dhurata Hamzai, Arratia e Konstandinit nëpër gjuhët e Ballkanit, Tema, 24 prill 2009, faqe 14.

<sup>10</sup>-Stavro Skëndi, Poezia epije gojore e shqiptarëve dhe e sllavëve të jugut, Bota shqiptare, Filadelfia 1954, faqe 75.

Doruntina” etj. Varianti më i vjetër i baladës “Kostandini dhe Dhoqina” është gjetur në Ndërnan të Zagories në vitin 1924 prej Sokrat Dervishit. Ky i fundit e kishte dëgjuar nga nëna e tij Eftalia.<sup>11</sup> Prej kësaj balade është frymëzuar shkrimtari Ismail Kadare kur shkroi veprën “Kush e solli Doruntinën”. Përmbajtja e baladës është: Jetonin dikur nëntë vëllëzër, të cilët kishin një motër të vetme. Dikush që vjen nga larg ua kërkon mortën për nuse. Tetë vëllëzërit janë të mendimit që të mos ia japin motrën, ndërsa vëllai i vogël, Kostandini ngul këmbë që motra të martohej me burrin që e kërkoi. Gjithashtu edhe nëna e tyre nuk dëshiron që ta martojë vajzën aq larg. Kjo duket në vargjet:

Lanet paç, o Kostandin,  
që më dhe Dhoqinën larg,  
larg e larg mërguar,  
tre male kaptuar.

Motra ankohet që po e martojnë kaq larg, por vëllai i vogël i premtonte me besë, se herë pas here do ta sjelli atë në familje. Martesa bëhet dhe pas saj vdesin vëllëzërit duke e lënë nënën kërcure në vatër. Nëna shkon tek varri i Kostandinit dhe i thotë: “Ku e ke besën që më pate dhënë?”. Heroi i baladës Kostandini, paraqitet me dhunti hyjnore. Ai ngrihet nga varri për të kthyer motrën në familje, duke na kujtuar shenjtërinë e fjalës së dhënë. Pllaka e varrit i bëhet kalë dhe balta shalë.

Kostandini u ngrit nga varri,  
gur’ i varrit ju bë kalë,  
dheu i varrit ju bë shalë.  
mirë kalin e shaloi,  
mori udhën edhe shkoi,  
tre malet i kapëtoi.

<sup>11</sup>-Evien Peri, Zagoria, zakone dhe tradita, Albin, Tiranë 2001, faqe 320.

Balada vijon duke përshkruar atmosferën e ditës së Pashkës. Në këtë ditë të shënuar populli këndonte dhe kërcente në oborrin e kishës, sepse Pashka është ditë ngjallje, hareje dhe gëzimi. Kostandini duke shëmbëllyer me Mesinë, mundi vdekjen. Ai edhe i vdekur, arrin të shpjerë në vend fjalën e dhënë.<sup>12</sup>

Na ish ditë e Pashkës së Madhe  
Dhoqina luante valle.  
rrobat qëndisur me ar,  
njihej që ish derë e parë,  
preu vallen nusëria  
Dhoqina njohu të vëllanë,  
e njohu e dolli mënjanë.

Mirëseerdhe, Kostë vëllai,  
për të keq a për të mirë?  
në më erdhe për të mirë,  
të vishem si gjeraqinë,  
në ke ardhë për të keq,  
të vishem si kallogre,  
jo motër sikundër je.

Në vijim është edhe pika më kulmore e baladës, ku vdekuri udhëton bashkë me të gjallin. Kostandini po shpinte motrën tek e ëma, për të plotësuar premtimin e dhënë.

U nis kali e po shkonte,  
kalin Kosta e nxitonte,  
si në erë fluturonte  
kali udhës turfullonte.  
udhës tek po shkonin,

<sup>12</sup>-Andrea Llukani, Në ditën e Pashkës së Madhe, Drita, 23 prill 2006, faqe 16.

e pemët dëgjonin,  
zogjt cicëronin:  
kini parë a s'kini parë,  
di veta hipur mi kalë  
shkon i vdekuri me të gjallë.

Balada zagorite e përshkruan bukur ndarjen e të vdekurit me të gjallin. Kostandini kthehet në ajodhimë se kish harruar shaminë. Në këtë moment shpirti i Kostandinit ngrihet në qiell, sepse e plotësoi premtimin.

Afër mureve te kisha  
ikë moj Dhoqinë tinë,  
se do kthehem n' Ajodhimë,  
pse kam harruar shaminë.

Dhoqina troket në derën e shtëpisë. Nënës i duket diçka e pamundur prandaj nguron t'i hapi portën. Më pas e pyet?

-Me kë erdhe, moj Dhoqinë?  
-kam ardhë me Kostandinë!  
-ç' Kostandin, të ardhë gjëma!  
Kostandini ka vdekur,  
ç'bën tre vjet pa tretur?

Vetvetiu na lind pyetja: -Kush e solli Dhoqinën? Atë e solli fjala e dhënë, besa shqiptare, e cila ngjalli Kostandinin për të plotësuar premtimin. Mbajtja e fjalës së dhënë tek shqiptarët është konkretizuar me shprehjen "Amanetin nuk e tret as dheu". Kjo ngjarje ka ndodhur Në ditën e Pashkës së Madhe.<sup>13</sup>

<sup>13</sup>-Shaban Sinani, Paralele motivesh biblike ne epikën popullore shqiptare, Kultura popullore, Nr 1,2, 1996, faqe 61-64.

## SHËN GJERGJI DHE PËRBINDËSHI

Sipas traditës së lashtë dikur në Libohovë dhe nëpër fushën e Dropullit kalonte një gjarpër i madh me dy krerë. Përbindëshi rrinte pranë burimeve dhe përpinte njerëz të gjallë. Vendi i preferuar i përbindëshit ishte burimi i Zërës më malin e Muzinës, ku dilte Uji i Shenjtë. Heroi i legjendës, Petriti, i cili jetonte larg vendlindjes, kur mësoi këtë gjë u nis menjëherë për në Libohovë. Sapo mbëriti, morri heshtën, ngjeshi shpatën dhe i hypur në një kalë të fuqishëm, vajti në shpellën e përbindëshit. Qeni, që e shoqëronte sapo pa përbindëshin që dremiste iu hodh për ta kafshuar, por u gëlltiti si një kafshatë buke. Atëherë Petriti e qëllloi përbindëshin me heshtë dhe në vijim ia preu të dy kokat me shpatë. Këtë rrëfenjë e thonë vargjet e këngës:

Libohova një qitet,  
të zezënë seç e gjet,  
hata e madhe, kiamet,  
një lubi, një ezhdërha,  
çdo ditë një njeri ha,  
si në djem dhe vashëza.

Gjith' qiteti në zi ra',  
dasëm do, e nuse s'ka.  
mëmatë i zuri gjëma,  
s'qe mëmë, po gjeraqinë,  
që bëri djalë Petritnë,  
vrau ezhdërha lubinë  
dhe shpëtoi njerëzinë!

Gjatë udhës së kthimit, kali sapo mbëriti në lagjen Loçan, plasi, ndërsa Petriti vdiq pas gjashtë muajsh.<sup>14</sup> Kjo këngë popullore ka marrë motive nga jeta e Shën Gjergjit, i cili u ndesh me përbindëshin dhe doli fitimtar. Shën Gjergji ka lindur rreth vitit 275 pas Krishtit, prej prindërish të krishterë. Kur u bë 18-vjeç u mobilizua ushtar dhe e shpunë në Nikomendi. Në luftën e Dioklecianit kundra persëve, Shën Gjergji u shqua për trimëri. Kisha jonë ka thurur himne shumë të bukura për jetën dhe veprën e tij. Ja se ç'na thotë përleshorja e shenjtit:

Si çlirimtar i robërve  
dhe mbrojtës i të vobektëve,  
mjeku i të sëmurëve  
dhe përluftar i mbretërve,  
Dëshmor i Madh  
Shën Gjergj Tropeprurës,  
ndërmjeto përpara  
Krishtit Perëndi,  
të shpëtohen shpirtet tona.

Në ikonë, Shën Gjergji paraqitet i hipur mbi kalë duke luftuar me përbindëshin dhe duke e mundur atë. Për të realizuar këtë skenë, ikonografi është frymëzuar nga një mrekulli e Shën Gjergjit. Sinaksari përmend se pranë një liqeni të Atalisë në Azinë e Vogël, kishte follenë një dragua, të cilin banorët idhujtarë të zonës e adhuronin si Perëndi. Banorët për të qetësuar përbindëshin i ofronin për t'u ushqyer fëmijët e tyre. Kjo realizohej me anën e një shorti. Në kohën kur shorti ra që të flijohej e bija e mbretit, në skenë u shfaq Shën Gjergji i hipur mbi një kalë të bardhë. Shenjti e shpoi tejprtej përbindëshin me shtizën e tij. Dragoi ngordhi duke u përdredhur nëpër këmbët

<sup>14</sup>-Fatos Mero Rrapaj, Këngë popullore të Labërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Akademia e Shkencave, Tiranë 1991.

e kalit. Kjo është mrekullia e Shën Gjergjit.<sup>15</sup> Shën Gjergji është një nga heronjtë që nderohet me respekt nga popuj të ndryshëm. Arbëreshët e kanë shenjtin e etnosit të tyre, Shën Gjergjin e festojnë romët, që janë të një besimi tjetër, në Angli është shpallur shenjtor kombëtar, madje lëvizja Skautiste si simbol të saj ka Shën Gjergjin. Në Suedi Shën Gjergjit i thonë Sankt Goran, i cili ka popullaritet të veçantë. Në kishën e madhe të Stokholmit gjendet një skulpturë e madhe, e cila paraqet Sankt Goranin, princeshën dhe dragoin. Piktori gjerman Bernt Notke, i cili e ka realizuar me shumë mjeshtëri këtë skulpturë, ka marrë motive nga ikona e Shën Gjergjit. Skulptura është krijuar midis viteve 1484-1488 dhe ka një simbolikë mjaft kuptimplotë: Princesha është Suedia, e cila ka shpëtuar nga kthetrat e dragoit (Danimarka) në sajë të trimërisë së kalorësit Sankt Goran. Realizimi i kësaj skulpture u bë nga fakti që suedezët kishin fituar pavarësinë nga danezët me anën e një beteje të përgjakshme.

### MREKULLIA E HEROIT

Në epikën historike kemi këngë, të cilat u japin heronjve atributet e një shenjtiti. Kënga e Luftës së Kosovës është mbledhur nga studiuesi elbasanas Lef Nosi, i cili e botoi për herë të parë në revistën “Kopështi Letrar”, 1918, Nr.2. Kjo këngë bën fjalë për luftën e Fushë-Kosovës, e cila u zhvillua më 15 qershor të vitit 1389. Gjatë kësaj beteje të përgjakshme heroi shqiptar Millosh Kobiliqi arriti të vriste Sulltan Muratin e I. Milloshi<sup>16</sup> vete tek Sulltani dhe ky i fundit për ta poshëruar në vend që t’i jepte dorën, i zgjati këmbën. Puthja e këmbës së Sulltanit ishte shenjë nënshtrimi, por Milloshi nuk u përlul.

<sup>15</sup>-Ἁγίου Γεωργίου Ἁ. Ἄνωθεν, Ἰ ἰσοπέδου εὐοιῖδὸς οὐί ἀοαίδήςπí áéεὐíuí, ἈδῖόδῖέέεP ἈέάειίέU, ἈέçíU 1995, faqe 123-124.

<sup>16</sup>-Në krahinën e Drenicës, ndërmjet Pejës dhe Mitrovicës gjendet një fshat që quhet Kobiliq, prej të cilit ka marrë Milloshi mbiemrin.

E Milloshi te mbreti ka shkue;  
 çojke komën mbreti me ia dhanë.  
 ky Milloshi n’ dorë hanxharin e kish pasë,  
 me hanxhare mbretit i kish ra;  
 dekë mbretin e kish lonë.

Milloshi largohet me vrap, por asqerët e Sulltanit e kapin dhe i prenë kokën. Heroi shqiptar Milosh Kobiliqi i hipën kalit dhe udhëton me kokën e prerë nën sjetull. Kali i Milloshit është i mbinatyrshëm dhe i paprekshëm.

Meiherë kryet Milloshit ia kanë pre!  
 qyr ça bani Millosh Kobiliqi,  
 kryet nën sjetull e kish pasë marrë,  
 ajd e ajd tue shkue,  
 në Sallabanjë kur ka shkue,  
 nji grue e nji çikë ishin kanë  
 qaty Milloshin e kanë pa.

Një nënë me të bijën po lanin teshat në lumin e Sallabanjës. Ato panë trupin e Milloshit që ecte pa kokë dhe u çuditën. Atje ku u ndal Milloshi, vite më vonë u ndërtua një kishë dhe pranë saj shpërtheu një burim me ujë shërues.

N’at vend tuk o mbetë Milloshi,  
 aty uj Zoti kish falë  
 ajy uj shum ilaç qi osht.

Këtë këngë na e sjell Fatos Arapi në librin “Kënga popullore shqiptare mbi luftën e Kosovës, 1389”. Meqenëse në vendin ku vdiq Milloshi u ndërtua një kishë, ky fakt na bën të besojmë se ai vend ka fituar një farë shenjtërie. Gjithashtu uji i shenjtë që doli nga burimi ka veti shëruese. Heroi shqiptar

Millosh Kobiliq duke udhëtuar me kokën e prerë nën sqetull, për afrohet me Shën Joan Vladimirin. Kjo këngë popullore e ka marrë motivin nga jeta e Shën Joan Vladimirit. Millosh Kobiliqi ndonëse nuk ishte shenjt, paraqitet me fuqi të mbinatyrshme. Por le ta krahasojmë këtë këngë popullore me një tropar që këndohet në Shërbesën kushtuar Shën Joan Vladimirit.

#### TING. T. II “OLIN APOTHEMENI”

Popuj çuditëshin, duke parë çudi të frikëshme,  
Që rinje i vdekur, o Vlladimir i Famshëm,  
Përmbi mushkën; dhe mbanje në duartë,  
Kryet tëndë të ndershmë të prerë,  
Të cillin e prure në Kishën e Zotit...

Ky tropar kishtar gjendet në Pasvargjet e Shërbesës së Shenjtë të Shën Joan Vladimirit. Kjo shërbesë është përkthyer dhe botuar prej Kryepiskopit të gjithë Shqipërisë, Kryehirësisë së Tij, Imzot Visarionit. Joan Vladislavi e ftoi Vladimirin për t’i bërë një vizitë në oborrin e tij dhe pas një kurthi i preu kokën me shpatë. Shenjti mori kokën e vet midis dy duarve, i hipi kalit dhe u drejtua nga kisha. Kjo ka ndodhur më 22 maj të vitit 1015.<sup>17</sup>

#### DASHURIA PËR ARMIKUN

Sipas traditës së lashtë, Skënderbeu dhe Milo Shini qenë shtruar për të ngrënë dhe kuvendonin për punët e Arbrit. Papritur Milo Shinit i ngriu dollia në buzë, sepse iu kujtua vëllai i tij, i cili kishte tradhëtuar duke luftuar për turqit. Milo Shini betohet përpara Skënderbeut se do ta vriste, të vëllanë.

<sup>17</sup>-Visarion Xhuvani, Shërbesa e Shenjtë e Sh’Jon Vladimirit, Gutenberg, Tiranë 1934, faqe 7.

Skënderbeu me urtësi e këshillon: “Shpata me vend, fjala me vend”. Gjatë një beteje Milo Shini vuri re një armik të plagosur rëndë dhe të verbuar prej gjakut. Milo Shini iu afrua, por kundërshtari tendosi harkun dhe i lëshoi shigjetën duke i shpuar shpatullën. Ai me guxim i afrohet dhe e pyet se kush ishte. I plagosuri iu përgjigj: -Unë jam arbër, e më thonë Gjin Bardhela. Ndërsa unë jam Milo Shini, yt vëlla dhe tani do ta paguash tradhëtinë tënde.

Një i verbër nka gjaku i tij,  
sa ngreru një jatullëz  
e i çaiti një shpatullëz.  
Po si trimi i vate sipër:  
-Thuam ma kush je ti trim?  
-Jam arbresh u, Gjin Bardhela.  
-Gjin Bardhelë, vëllau im,  
mba tutie mos u t’vras,  
se jam gjaku i deiturith,  
të gjakut të qenit turk.

Milo Shini e mori robin e luftës dhe e shpuri tek Skënderbeu, i cili e fali. –Shko o Gjin Bardhelë në shtëpinë tënde dhe mjeko plagët, të keqen që i bërë dheut tënd ta shlyesh me pendesë dhe me shpatë duke luftuar turqit.<sup>18</sup>

E rrëmpeu pra mirë për dorie,  
e qelli te Skandërbeku.  
-Zot, mos u mërinjë me mua;  
nd’u s’u prora, u gjith t’i vrava.  
Se ndë mos më ke bes,  
dil kuntrela Okridës.  
Em edhe falimë, se u bë

<sup>18</sup>-Mitrush Kuteli, Vepra letrare, faqe 216-223.

ghera e t'prëiturit.  
Hitur dielli, erdhëtin mbë shpi.  
-Agëzuashë, zonja mëmë,  
Gjin Bardhelën, tët birë,  
Gjin Bardhelën, tim vëlla,  
t'e solla. Ni mua uratën,  
uratën e tinë zoti,  
ëm e të gjithë engjëlvet.

Këtë baladë e ka shkruar Jeronim de Rada, në vitin 1866 tek libri "Rapsodi e një poeme shqiptare". Ungjilli i Shenjtë na mëson: "*Doni armiqtë t'uaj, bekonit ata që u mallëkojnë juve, bëni mirë a'yre që u kanë mëri uve, edhe fali për ata që u bëjnë keq e u djekënë juve*" (Matheu 6, 44). Le t'i komentojmë këto pasazhe Biblike:

**1-Doni armiqtë tuaj.** A është e lehtë që të duash armiqtë? Natyrisht që jo. Por "*Të pamundurat për njerëzit janë të mundura për Perëndinë*" (Lluk.18, 27). Le të kujtojmë Krishtin në momentin e kryqëzimit dhe do të shohim se dashurinë që predikoi, e zbatoi vetë i pari. Mbi Kryqin e martirizimit shtriu duart duke përqafuar gjithë njerëzit, madje edhe armiqtë e Tij. Ai nuk u mjaftua vetëm me kaq, por u lut për ata që e kryqëzuan dukë thënë: "*O Atë, fali se nuk dinë se ç'bëjnë*" (Lluka 23, 34).

**2- Bekoni ata që u mallkojnë.** Krishtërimi na mëson se të gjithë njerëzit janë vëllezër dhe të barabartë përpara Perëndisë. Në nëntë Porositë e para, Perëndia na ndalon që të mos kryejmë veprime të liga, ndërsa në Porosinë e fundit, nuk na lejon edhe ta mendojmë dhe ta dëshirojmë të keqen. Kjo gjë na urdhërohet për faktin, sepse njeriu në fillim e mendon dhe e dëshiron të ligën, e më pas kryen veprimin. Gjithsesi ai që kujdeset për mendimet, dëshirat dhe zemrën e tij që të jenë

përherë të pastra dhe larg së ligës, kurrë nuk do të dëshiroj të kryej një veprim mëkatar.

**3- Falini ata që u bëjnë keq.** Vetëm duke falur fajtorët tanë, ne mund t'i largohemi veprimit të padëshiruar të mëkatit dhe të së keqes, duke jetuar një jetë të qetë dhe të pastër, pa dëmtuar askënd, pa pasur zili dhe pa u rrëmbyer nga veprimet e liga. Në këtë mënyrë, ne do të jetojmë të gëzuar dhe të lumtur brenda shoqërisë. Do ta kemi ndërgjegjen e pastër, sepse nuk kemi bërë ligësi kundrejt të afërmit tonë. Falja është dhurata më e mirë për Perëndinë, sepse edhe vetë Krishti, përpara se të sakrifikohej në kryq, i fali të gjithë armiqtë e tij. Njeriu që fal është i paqtuar me të gjithë dhe mund t'i shohi të gjithë në sy.

### KROI SKENDERBEG

Sipas disa gojëdhanave Skënderbeu, për të shuar etjen e ushtarëve godet shkëmbin me shpatë duke imituar Moisiun e Biblës. Letë analizojmë së pari legjendën për burimin e Shkretës, në Kurbin. Për të qenë sa më korrekt me lexuesin po jap tekstin sipas origjinalit: "*Tu ba rrug Skendërbegu me ushtri t'vet, i ra shteku me kaluë rraz kti mali. T'përvapun prej s'ecmes, i pat ardh etje si Skendërbegut, si ushtrisë. U suëllën për me gjetë do i kruë atypari, por s'kje gja. Skënderbegu atbotë e xuër shpatën prej millit e i ra një gurit, qi i ra përsyshë ma i pari, e qiti ujët, ashtu piu Skendërbegu edhe ushtria marë mje n't'ngimë. Porse a'at hov qi duël ujët prej gurit i tha Skendërbegu: -Ktu dalsh e ktu humatsh. – E vërte aj ujët edhe sod rrjedhë si atherë, porse uji pash prej gurrës ke del, humat e nuk shifet përmi dhe*".<sup>19</sup> Tani le të krahasojmë këtë legjendë me pasazhet Biblike ku Moisiu siguron ujin për popullin e

<sup>19</sup>-Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, Vol. III, Tiranë 1962, faqe 476-497.

zgjedhur të Perëndisë. Legjenda rreth Kroit të Skënderbeut ka marrë motive nga këto pasazhe Biblike. “Atëherë populli u grind me Moisiun dhe i tha: “Na jep ujë për të pirë”. Moisiu u përgjigj: “Pse grindeni me mua? Pse tundoni Zotin?”. Atje populli pati etje për ujë dhe murmuriti kundër Moisiut, duke thënë: “Pse na bërë të ikim nga Egjipti që të vdesim nga etja ne, bijtë tanë dhe bagëtia jonë?”. Kështu Moisiu i thirri Zotit, duke i thënë: “Çfarë të bëj për këtë popull? Edhe pak dhe ata do të më vrasin me gurë”. Zoti i tha Moisiut: “Kalo para popullit dhe merr me vete disa pleq nga Izraeli; merr në dorë edhe bastunin me të cilin rrahe lumin, dhe nisu. Ja, unë do të rri përpara teje, atje mbi shkëmbin ne Horeb; ti do të rrahësh shkëmbin, prej të cilit do të burojë ujë dhe populli do të pijë”. (Eksodi 17, 2-7). Sipas një legjende tjetër Skënderbeu i bindi ushtarët që të pinin nga uji i lumit dhe që nga ajo kohë u quajt Kroi Skenderbeg: “N’grykë t’Altarit t’katunit Milotit n’Kurbî, drejti për drejti në Shkallë t’Milotit (ndërmjet e rremon valën e vet lumi Matja) gjinet një kruë qi e thrrasin Kroj Skendërbeg”.<sup>20</sup>

Nga krahasimi me pasazhet Biblike të mëposhtme del se edhe kjo legjendë e lashtë ka motive nga Bibla. Ja se ç’thonë pasazhet Biblike: “Pastaj Moisiu i nisi Izraelitët nga Deti i Kuq dhe këta u drejtuan nga shkretëtira e Shurit; ecën tri ditë në shkretëtirë dhe nuk gjetën ujë. Kur arritën në Mara nuk mundën të pinë ujërat e Marës, sepse ishin të hidhura; prandaj ky vend u quajt Mara. Atëherë populli murmuriti kundër Moisiut, duke thënë: “Ç’do të pimë?”. Kështu ai i bërtiti Zotit; dhe Zoti i tregoi një dru; ai e hodhi atë në ujë, dhe ujërat u bënë të ëmbla”. (Eksodi 15, 22-2)

<sup>20</sup>-Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, Vol. III, Tiranë 1962, faqe 497.

## VDEKJA E GJERGJ KASTRIOTIT

Tek arbëreshët e Kalabrisë, këngët kushtuar figurës së Gjergj Kastriotit janë kuptimplota dhe ruhen me fanatizëm prej popullit. Ato këndohen dhe kërcohen nëpër festat tradicionale të arbëreshëve të Italisë. Këto këngë janë krijuar prej bëmave të heroit. Sipas baladës së lashtë, në kohën kur Gjergj Kastrioti u nis për në luftë i doli përpara vdekja dhe i tha: -Kthehu prapa se të është sosur jeta. Ai menjëherë zhveshi shpatën, por ajo nuk tundej. Këtë e paraqet në vargje poeti arbëresh Jeronin de Rada.

Menatet kur na u nisë  
Skandarbeku keq i sbetë,  
keq i sbetë e i sëmurëm,  
e luftoi lufen e prasëm,  
j’u përpoqë vëdekia,  
proksenit i psores zezë.  
-Priu, Skanderbek, prap.  
-E kush je ti e nkaha vien?  
-Emri im është vëdekia,  
gjella jote u fërnua.  
-Hije, ti ajëri si je,  
pa zëmërë ndë gji  
e m’trëmbën njerëzit,  
ka e di se u kam vëdes?

Skënderbeu urdhëroi Dukagjinin që t’i sillte të birin për t’i lënë amanetin e fundit: “Shko tek bregu i detit dhe atje është një qiparis hijegjerë e vajtimtar. Lidhe kalin dhe sipër tij ngre flamurin tim, që të valvitet nga errërat e detit dhe mbi flamur var shpatën, në majën e së cilës fle vdekja. Kur të fryjë furishëm veriu, kali do të hingëllijë, flamuri do të valvitet dhe shpata do të vringëllijë”. Këtë rrëfim nga jeta e heroit tonë kombëtar

rapsodi anonim e ka përjetësuar në vargjet e këngës:  
“Skanderbeg al figlio prima di morire”, të cilën po e japim të  
përkthyer:

“Lule e lërierëz  
lule kësaj zëmër t’ime  
mirr të t’ëmë e tri gale  
më të mirat çë ke  
e ik mbajtu kënetë  
se ndë turku më e xë  
tij të vret, e pra të t’ëmë  
ai më e nisën bashkë më të.  
Po si avron (e më par se t’ikësh)  
ndë prajën e detit  
Atje është një qiparis  
I hjeshtur e lipë madhë  
atje ti lidh kalin t’im”.  
Kur gjegjjetin këto fjalë  
zun e qajin me lak  
mbi rreth zotra e bular.  
“Hap fjamurin t’im  
e ndë mest fjamurit  
lidh e le mahjeren t’ime  
Kur frin vorea e keqë  
muexhari më hingëllisën,  
fjamuri më hapet  
e mahjeria tringëllisën.  
Nga i vrëjturi qiparis  
turku i gjegjjen e trëmbet  
e tuke kuituar vëdeqen  
çë fjë te mahjera ime  
nëng ju vjen ngaha veni”.

Në poemën e Jeronim de Radës “Rapsodi e një poemi  
arbëresh”, vdekja e Gjergj Kastriotit paraqitet si një gjëmë e  
madhe. Qielli vajton për trimin, shtëpitë dhe malet u çanë,  
kambanat e kishave binin vajtueshëm etj. Zija hyri në zemrat  
shqiptare, prandaj që nga ajo kohë xhoka tradicionale e  
Shqipërisë së mesme nga e bardhë u bë e zezë dhe kështu  
qëndron deri më sot. Kjo vjershë u botua në vitin 1866 dhe  
titullohet “Skënderbeku s’është më”.<sup>21</sup>

Shkoi një dit miegullore,  
miegullore e helmore,  
foka qielli doi t’ valtoj,  
Skënderbeku s’është më.

Gjegjjetin shpitë dhe u trihinistin,  
gjegjjetin malet dhe u ndanë,  
kampanartë e qishve.  
Zunë lipin mbë vet’hen;  
po mdër qiellt e gapta hinej  
Skanderbeku i pafanë.

Jeronim de Rada në këtë vjershë, krahason vdekjen e  
Gjergj Kastriotit me atë të Krishtit. Poeti arbëresh në këtë motiv  
e ka marrë nga Bibla (Matheu 27; 51-53): “*Edhe ja kurtin’e  
tempullit tek uça mbë dy prej së-larti gjer poshtë; edhe dheu u  
tunt: edhe gurëtë plasnë; 52 edhe varret’ uhapnë, edhe shumë  
trupa shënjtorësh që kishinë vdekurë ungjallnë; 53 Edhe  
dualinë nga varretë pas të-ngjallurit t’ati, e hynë ndë qytett  
të-shënjtëruarë, edhe uduknë mbë shumë veta*”.<sup>22</sup>

<sup>21</sup>-Agron Fico, Figura e Gjergj Kastriotit Skënderbeut në folklor, 55, 24  
nëntor 2005, faqe 21.

<sup>22</sup>-Kostandin Kristoforidhi, DHIATA E=RE e Zotit edhe Shpëtimtarit  
t’ënë JISU KRISHT , kthyerë prej Elinishtesë SHQIP, ndë të folë  
Toskënisht.



Studiuesi Shaban Sinani në artikullin e tij “Paralele motivesh biblike në epikën popullore shqiptare” na paraqet një këngë dy gjuhëshe, shqip dhe greqisht, e cila këndohej gjatë festave fetare në oborrin e kishës. Kjo këngë këndohej gjatë të Enjtes së Madhe, pas shërbesës së kryqëzimit të Krishtit.

Sot qielli është nxirosur,  
Edhe dita u sterros,  
Edhe malet po vajtojnë.

Prof. Dr. Shaban Sinani duke bërë krahasimin ndërmjet kësaj kënge popullore me tekstin e këngës kushtuar vdekjes së Gjergj Kastriotit, mendon se ka përputhje në formën gjuhësore ndërmjet tre vargjeve të para. Fshatrat minoritarë të jugut, janë të besimit ortodoks prandaj ditët e Javës së Madhe përjetohen emocionalisht nga besimtarët.

### **GJERGJ ELEZ ALIA**

Këngën e Gjergj Elez Alisë e gjejmë tek të gjithë popujt e Ballkanit me përjashtin të grekëve. Trim mbi trima kish qenë Gjergj Elez Alia, i cili sakrifikohet për të tjerët. Ai i kishte dalë zot truallit të të parëve duke mbrojtur nderin. Nëpër betejat e shumta me armiqtë kishte dalë fitimtar, por trimi kish marrë nëntë plagë dhe prej nëntë vjetësh dergjej në shtrat. Motra i rrinte tek koka dhe i mjekonte plagët, të cilat e mundonin shumë bacë Gjergjin. Që në vargjet e para “trim mbi trima” tregohet karakteri i fortë i Gjergjit. Dy personazhet e baladës jetojnë në varfëri. Motra përdor rroba të nënës dhe petka të babës për të lidhur plagët e trimit. Ndonëse Gjergji dergjet në shtrat nga plagët e luftës, motra ia vendos armët e luftës tek koka. Zakonisht baladat e kreshnikëve karakterizohen nga motivet e

ashpra të trimërisë dhe të gjakmarrjes, por në to shpesh hasim edhe ndjenja të njeridashjes. E tillë është dashuria e motrës për vëllanë.<sup>23</sup>

Trim mbi trima ay Gjergj Alez Alija!  
Qe nand' vjet nand' varra në shtat m'i ka:  
Veç një motër, natë e ditë te kryet;  
Ia lan varrat me ujt e gurrës nand-vjeçe;  
Ia lan varrat me ata lott e syve;  
Ia terë gjakun me ata flokët e ballit;  
Shtatin vëllaut ia shtërngon m' ruba të nanës;  
N' petka t' babës trupin ia hijeshon;  
Armët e brezit ia rendon mbi krye.

Vitin e nëntë u hap fjala se kishte dalë nga deti një bajloz i zi, i cili kërkonte prej çdo familje një dash të pjekur dhe një vashtë të re. Bajlozi kishte vrarë shumë kreshnikë dhe askush nuk guxonte ta kundërshtonte, sepse topuzi i tij ishte shumë i rëndë dhe shpata shumë e mprehtë.

A dalë zani e paska marrun dhen,  
Se'i baloz i zi a dalë prej detit.  
Trim i prapët e belagji qi ish'kanë,  
I a ki'qitun dh'“eut një rreng të randë:  
-Tim për tim kah një dash të pjekun!  
-Tim për tim kah një vashë me ia djergun!  
-Ditë me ditë kah një kreshnik me premun!  
-Javë për javë kah një krahinë me djergun!

Kur i erdhi rradha shtëpisë së Gjergj Elez Alisë që duhej të jepte motrën e vetme, heroi i baladës harroi nëntë plagët dhe u ngrit nga shtrati për të mbrojtur nderin e familjes.

<sup>23</sup>-Këngë popullore legjendare, zgjedhur e pajisur me shënime nga Q. Haxhihasani, Instituti i Shkencave, Tiranë 1955, faqe 122.

Edhe Gjergjit rendi te i ka ardhë;  
 Me lot faqet trimit m'i u kan mbushë;  
 Erzi i shpis qysh lshohet n'dorë t'balozit?!  
 Ia ka nisë e motra e po bërtet;  
 Krejt me lot Gjergjin p'e loton:  
 Po qysh mordja, o vlla, me na harrue!?  
 Nanë e tatë kah kalbën për nan bli!  
 Trupi i motrës n'dorë t'balozit t'zi!  
 Qysh s'u shemka kulla me na xanë!  
 Qysh s'u kthyea shpija n'nji muranë,  
 Me t'pshtue erzin, mori e zeza nanë!  
 Dy copash zemra djalit iu ka da,  
 Dy rig'lot për faqe te i kan shkue  
 Dy fjal'kullës djali ia ka fjakrue  
 -He, ju u nxisha sarajet e mija!

Nderi i shtëpisë së trimit ishte në rrezik. Kush do të mbronte nderin e motrës? Prindërit kishin vdekur dhe vëllai kishte nëntë vjet që dergjej në shtrat? Motra sintetizon karakteristikat tipike të vajzës shqiptare: ndershmërinë, thjeshtësinë, besnikërinë dhe dashurinë e pakufishme për të vëllanë. Gjergji porositi motrën të shkoj tek nallbani për të mbathur kalin.

Të marrsha gjogun, motër të m'bijsh  
 E t'më shkojsh tu nallban probatini.  
 Fal'me shnet, thuej, Gjergji të ka çue,  
 Me ma math, me patkoj prej tumakut,  
 Me m'ia u shti thumbat-o prej çelikut,  
 Se n'mejdan balozit due me i dalë.

Duhej një fuqi e mbinatyrshme që t'i jepte forcë dhe kurajo Gjergjit, për të mbrojtur nderin e familjes. Perëndia e kishte lënë gjallë për këtë qëllim.

Ça kish ba ay trimi Gjergj Alija?  
 Falë me shnet balozit m'i ka çue:  
 Me dalë heret n'at fushën e mejdanit  
 Çikë për ty, baloz, nu'm'ka qillue;  
 Desht e vathit për ty nu' m'janë majë;  
 Sall nji motër, nu'po muj me lshue;  
 Varrët e shtatit s'a kush qi m'i lidhë!  
 Sa ka nisun drita me zbardhë majet,  
 N'fushë të mejdanit trimat konkan dalë;

Gjergji dhe bajlozi u takuan për duel në fushën e betejës. Bajlozi kishte veshur parzmore të rënda dhe kishte vënë në kokë një përkrenare prej çeliku, ndërsa Gjergji hipur në gjogun e vet. Ndërsa kuajt po vinin në drejtim të njeri-tjetrit, Bajlozi lëshoi topuzin e rëndë, i cili pasi i fluturoi Gjergjit mbi krye, u ngul dymbëdhjetë pash nën dhe. Gjergji e qëlloi bajlozin në lule të ballit duke e shtrirë të vdekur përdhe. Gjergj Elez Alia mbrojti nderin e shtëpisë dhe mbrojti vendin nga tirania e bajlozit të zi.<sup>24</sup>

Por shtërngohu, baloz, se t'ka ardhë dita,  
 Se ktu i thonë-o Gjergj Alez Ali!  
 E i kan ba dy gjogat tim me tim,  
 E n'topuz balozit e ka shinue;  
 N'dy gjut gjogu Gjergjit te i ka ra;  
 Përmbi kryet topuzi i ka fjurue;  
 Dymbëdhjetë pash m'ledinë u ngul topuzi;  
 Dymbëdhjetë pash përjetë, si re u çue pjuhni.  
 At'herë Gjergjit rendi te'i ka ardhë.

<sup>24</sup>-Mitrush Kuteli, Vepra letrare 4, faqe 35-41.

Sa mirë trimi n'topuz qi ka dredhë!  
Lik përmet balozit te i ka ra;

Le të krahasojmë baladën e Gjergj Elez Alisë me pasazhin biblik Davidi dhe Filisteu: “*Kur Filisteu lëvizti e shkoi përpara për t’u ndeshur me Davidin, edhe Davidi nxitoi menjëherë drejt mejdanit, ballë Filisteut; vuri dorën në thes, nxori prej tij një gur, e hodhi me hobenë dhe e goditi në ballë Filisteun; guri iu fut në ballë Filisteut dhe ai ra me fytyrë për tokë. Kështu Davidi me një hobe dhe një gur mundi Filisteun; e goditi dhe e vrau...*” (1 Samuelit 17; 48-50). Të kthehemi përsëri tek vargjet e fundit të baladës, të cilat përshkruajnë dhimshëm që vëllai dhe motra pushonin (të vdekur) nën një bli. Varri i tyre u rrethua nga një mur, prej një grumbulli gurrësh, që të mos harrohej kurrë dashuria e motrës për të vëllanë. Kur nisi të dushkohet mali, qyqja qëndroi mbi murin e varrit dhe e gjeti blirin e tharë e kullën e Gjergj Elez Alisë të rrënuar. Atëherë qyqja qëndroi në dritare dhe këndonte duke ju kujtuar atyre që kalonin asaj udhe.

Amanet more shtegtari i malit!  
N’kofsh tuj knue ksajt, kajën me e pushue!  
N’kofsh tu’kajtë ksajt, gjamën për me e xanë!  
Kah kërkova gjithkund bjeshkë e m’bjeshkë,  
Kah verova gjithkund vrri e n’vrri,  
Kah mjerova gjithkund shpi e n’shpi,  
Kërkund s’ndesha m’Gjergj Alez Ali!<sup>25</sup>

Qyqja është zog shtegtar dhe kur u kthye nga mërgimi i largët e gjeti blirin me degë të thara dhe kullën e rrënuar. Atëherë qyqja filloi të vajtojë për Gjergjin. Qyqja simbolizon

<sup>25</sup>-Benardin Palaj, Donat Kurti, Visaret e Kombit, II, Shkodër 2005, faqe 42-48.

shkretimin, mbylljen e derës së një fisi, shuarrjen e jetës së një njeriu etj. Në vajtimin e saj, ajo u kujton udhëtarëve për tragjedinë që ka ndodhur në atë vend dhe i porositi të nderojnë trimin Gjergj Elez Ali. Në baladën bullgare “Bolan Djonich” bëhet fjalë se në fushat e Selanikut kish dalë një “Harap i zi”, i cili merrte nëpër këmbë nderin e njerëzve duke kërkuar çdo ditë “ka’i dash t’pjekun” dhe çdo natë nga “ka’i vash të re”.

Kisha dalë një Harap prej detit  
Trim i zi e belaxhi  
Edhe qitka’ i porez t’randë  
Ka tri bukë pogaçe për shpi  
Shate mbase venë për ditë me i pi  
Ka i taroc për mish të zi,  
Ka një dash n’mjesditë m’ia pjekun  
Ka një skjap për darkë m’ia repun.

Kur i erdhi radha Angjelinës, motrës së Dojçinit, ky i fundit ndonëse me plagë në trup u ndesh me “harapin e zi” për të mbrojtur nderin e familjes. Pasi vrau harapin e zi, Bolan Djonich kthehet në shtëpi dhe kërkon që të vijnë “priftërinjtë e shenjtë”, të cilët i ndezin qirinjtë dhe heroi jep shpirt.<sup>26</sup>

## BALADA E RINJOHJES

Balada e rinjohjes ka në qendër të saj dy personazhe, burrë e grua, vëlla me vëlla ose vëlla e motër, të cilët njohin njeri-tjetrin pas shumë vitesh. Rinjohja bëhet me anën e një shenje, si për shembull, një nishan, një e kafshuar ose gjashtë gishtërinj në dorë etj. Kjo baladë tek arbëreshët e Italisë njihet me emrin “Kostandini i vogël” dhe është e njënjtë me atë të

<sup>26</sup>-Gjergj Zheji, Folklori shqiptar, Tiranë 1998, faqe 172.

“Ago Ymerit”. Pas islamizimit të shqiptarëve baladat e vjetra mbijetuan në sajë të ndryshimit të emrave nga Kostandin në Aga Ymer, Imer Aga, Omer Aga etj. Gjithsesi ndonëse kanë ndryshuar emrat përmbajtja e tyre ka mbetur e njejhtë. Ngjashmëri ka një këngë serbe *Ropstvo Jankovica Stojana* që do të thotë *Kapja rob e Jankoviq Stojanit*.<sup>27</sup>

Kostandinit të vogël që kishte vetëm tri ditë martuar, i vjen letra të shkonte ushtar. Me të marrë kartën, Kostandini shkoi tek dhoma e nënës që të merrte uratën. Më pas vajti tek nusja, i dha unazën dhe e porositi se do të shkonte në dhe të largët për të luftuar. Po të kalojnë nëntë vjet e nëntë ditë dhe unë të mos kthehem, atëhere ti mos më prit më, por martohu. Këtë ngjarje rapsodi anonim e ka përjetësuar në vargjet:

Kostandini i vogël,  
Tri ditë dhëndër!  
Si shkuan tri ditë,  
Me nusen të re, të re,  
I erdh karta e Zotit të madh  
Që të vente në ushtri  
Atëhere Kostandini  
Shkoi tek dhoma e prindërve  
Dhe, si u puthi dorën  
U lypu atyre uratën;  
Pastaj gjeti të dashurën,  
Hoqi unazën e ia dha asaj,  
Si të shkojnë nëntë vjet  
Dhe unë në mos u kthefsha,  
Vajzë ti të më martohesh.

<sup>27</sup>-Stavro Skëndi, Poezia epike gojore e shqiptarëve dhe e sllavëve të jugut, Bota shqiptare, Filadelfia 1954, faqe 73.

Kaluan nëntë vjet e nëntë ditë dhe Kostandini nuk po kthehej. Atëherë nusja vendosi të martohet dhe caktuan ditën e dasmës. Kostandini që luftonte në dhe të huaj, pa një ëndër të frikshme, u zgjua me rrëmbim, morri kalin e bardhë dhe u nis të arrinte nusen përpara se të vinte kurorën e dytë.

Sapo shkuan nëntë vjet,  
Nëntë vjet e nëntë ditë  
Pastaj plaku, i vjehëri,  
“Bija ime, i tha, martohu”.

Sosi në fshat në kohën e meshës së madhe dhe rendi drejt kishës. Në momentin që nusja me dhëndërin po vinin drejt kishës, Kostandini i zbriti kalit, ngriti flamurin te dera dhe u tha dasmorëve: -A më doni mua nun që t'i vë kurorë kësaj nuseje?

Në kohën e meshës,  
Arriti te katundi i tij,  
Drejt në derë të kishës,  
Kur po vinte nusja,  
Dhëndëri e fshati pas,  
E nguli trimi flamurin,  
Më pranoni mua për nun,  
Në kurorën e kësaj nuseje?

Kur erdhi koha që nusja të shkëmbente unazën me atë të dhëndërit, Kostandini i vuri në gisht unazën e vet. Nusja e njohu që ishte Kostandini.<sup>28</sup>

<sup>28</sup>-Mitrush Kuteli, Vepra letrare 4, faqe 42-45.

U hap kisha e hynë,  
 Erdh pastaj koha,  
 Të ndërrojë trimi unazën.  
 Ai e vuri tek gishti i tij,  
 Zonja e njohu unazën e ra në mendime,  
 Sumbulla-sumbulla faqes kuqe,  
 Pik-pik gjirit bardhë.  
 Kostandini me ma pa:  
 O ju priftër e bujarë,  
 Dale mbani ato kurorë  
 Kostandini kurorë e parë,  
 U lidh me këtë vajzë përjetë,  
 Unë jam vetë Kostandini.

Vargjet e baladës janë marrë nga “Dorëshkrimi i Kieutit”, i cili daton më 1737. Arbëreshët e këndojnë këtë baladë në çdo martesë. Pas gostisë, të gjithë burra dhe gra ngrihen dhe formojnë një rreth, në mes të së cilit qëndron nusja me dhëndërin. Më pas vijon vallja e kënduar, e cila është një lavdërim poetik i besës së gruas së martuar. Në Hora e Arbëreshëve, në kishën e Shën Gjergjit gjendet gjurma ku ka shkekur thundra e kalit të Kostandinit. Kjo baladë është një reminishencë e *Kostandinos o mikros* i këngëve popullore greke, të cilin e sollën arbëreshët kur u shpërngulën nga Moreja për në Kalabri. Mikros Kostandinos është i biri i perandorit Andronikos, për të cilin Digenis Akritas ka thurrur shumë vargje.<sup>29</sup> Një motiv tjetër i rinjohjes është edhe ai i vëllait me motrën. Këtë e hasim në baladën e Gjon Petrikës në veri, atë të Gjino Vakut në jug (Labovë të Gjirokastrës), Olimbinë dhe Vllastarin tek arbëreshët etj. Në Shestan edhe sot e kësaj dite këndohet rapsodia e Gjon Petrikës, i cili ishte më trimi nga

<sup>29</sup>-Eqerem Çabej, Konstandini i Vogëlith dhe kthimi i Odiseut, Drita, 11 mars 2007, faqe 7.

ushtarët. Ai shkon të zëri në mal bareshën, e cila i thotë se ka një vëlla ushtar që quhet Gjon dhe ka gjashtë gishta në dorë e në këmbë.

Këndon bleqa, zanë në mal;  
 Mendon, se s’po ndien kush;  
 Gjith ushtrija p’e ndigjon:  
 Sa mirë bleqa po këndon!  
 Kush asht trim e kush asht djalë,  
 Për m’e xanë blegën në mal?  
 Gjon Petrika, trim i mirë,  
 Ndodhi trim e ndodhi djalë;  
 Aj edhe e xu’blegën në mal:  
 Për flokësh po e hjek rrqanë.  
 Mos hiq, trim, o i paganë!  
 Se as nuk jam e shkretë,  
 Por e kam-e një vëlla!  
 -Ku e ke, he mos e paç!  
 Mos m’a nem, goja t’u thafët!  
 Në ushtri e kam diku.  
 Emënit-o m’i thonë Gjon.  
 Aj ka shenja për t’u njoftë:  
 Gjeshtë gishta në një dorë,  
 Edhe gjashtë në një kambë,  
 -A je ti, Fasile motër?<sup>30</sup>

<sup>30</sup>-Benardin Palaj, Donat Kurti, Visaret e Kombit, II, Shkodër 2005, faqe 259.

Çajupi në vjershën “Atdheu dhe dashuria” flet për njohjen e vëllait me vëllanë, të cilët pasi dolën të ndeshen me njeri-tjetrin.

Tani do ta shoq dhe vetë  
Kush është trim i vërtetë...  
Këto thosh turku dhe vinte  
Po dhe Jorgua e printe;  
Hodhi armëtë përdhezë  
Dhe zuri të sgjeshë brezë,  
Që kish qepur Vitua vetë,  
Si fustan'e fermeletë;  
Kur e kujtoi u shëmp,  
Mos pandeni se u trëmb;  
Bëri kruqn e fshiu lotë,  
Jam azër! Hidhet i thotë  
Edhe më dorë një thikë  
Ju vërsul turkut pa frikë.  
Trimi rrëmbeu anxharë  
Dhe po hidhej si i marrë.  
Fryti era; nga rrëmbimi  
Lëshon flokatenë trimi;  
Atje ku qe afëruar  
Me gjoks hapët leshëtuar,  
Ju duk në grykë të ti,  
Varurë një hajmali.  
Jorgji, kur pa hajmalinë,  
Sytë përmi të i ngrinë,  
-Dale, - tha, - ashtu më rruash,  
Pa lëftojmë kur të duash,  
Po në beson në Perëndinë,  
Kush ta fail hajmalinë?  
-Nëna në foshnjëri

Ma vari për mbarësi...  
Po ç'të duhetë kjo punë?  
Një të tillë kam edhe unë!  
Shuko! Mëma ma ka falë  
Dhe mua, kur jeshë djalë.  
Të dy trimat hapnë gjitë  
Dhe shukonin hajmalitë  
Qepur me pë të florinjte;  
Si njera dhe tjetëra,  
Të dya të vjetëra;  
Përmbërënda, pshellur me kartë,  
Gjenë nga një kryq të artë!

Papritmas ata panë se kishin kryqe të njejta. Këto ua kishe varur nëna kur qenë fëmijë.

### MË JEP PAK UJË

Lipset guxim dhe heroizëm, për të treguar dikush dashuri për armikun e tij. Për këtë Krishti na mëson: “*Nëqoftëse armiku yt ka uri, jepi të hajë, në pastë etje, jepi të pijë*” (Romakëve 12,20). Nga kjo shprehje ungjillore e ka marrë motivin balada që do t’u rrëfej. Balada “Rina dhe Radovani” rrëfen se Rina kishte një vëlla të vetëm, i cili ishte trim mbi trima. Sa herë që kthehej nga lufta, të parët e ushtrisë i vinin mbi krye një kurorë me dega lisi e dafine, në shenjë burrërie dhe trimërie. Trimat lëvdoheshin me bëmat e Radovanit, vashat i thurrnin vargje e kërcenin me gëzim, ndërsa zogjtë ia thoshin këngës. Njëherë Radovani shkoi në luftë dhe nuk u kthye më. Pas përfundimit të betejës, e motra doli të kërkonte vëllanë. Ajo kërkoi shumë, tri ditë e tri netë, kaptoi tri male dhe e gjeti të vëllanë të vranë pranë një lisi hijerëndë. Përreth tij kishte shumë ushtarë armiq të vranë nga shpata e Radovanit. Rina

nuk qau dhe vajtoi, por e morri vëllanë dhe pasi e mbuloi me flamurin e kuq të Arbërit u nis për në shtëpi. Udhës qëndroi pranë një kroi, që të shuante etjen. Në atë kohë i afrohet një ushtar armik dhe i thotë: -Nëm një pikë ujë, moj e bukura Rinë?<sup>31</sup>

Dbuar Rina të vëllanë,  
Të vëllanë, Rada Vanë,  
Tri ditë atë kërkoi,  
Tri dit' e kërkoi me diellin  
E tri net me hënëzën.  
Pastaj e gjeti të vëllanë,  
Vëllanë e kryetë të prerë,  
Nd' atë sheshin e Napulës.  
Të varfërit e ndihmuan,  
E vuri mbi mushk' të zezë,  
E kthy' prap' drejt e në ship.  
Udhës, aty ndë përulla,  
Pushoi pak, mushket e zbriti,  
Me flamurin e mbuloi.  
Kaloi ushtri e Arminoit<sup>32</sup>  
-Një pikë ujë ëm, moj Rinë.

Në Bibël flitet për dialogun e Krishtit me gruan samaritane. *“Kur Jisui arriti pranë Samarisë në një qytet që quhej Sihar, qëndroi pranë pusit të Jakovit për të shuar etjen. Një grua nga Samaria erdhi për të mbushur ujë dhe Krishti i tha:- Më jep të pi pak ujë. Gruaja u çudit sepse nga veshja e njohu se kalimtari ishte jude dhe këta të fundit ishin në armiqësi me samaritanët. Megjithatë Krishti iu drejtua përsëri: “Po ta njihje ti dhuratën e Perëndisë dhe kush është ai që të thotë më jep të pi, ti vetë do të kërkoje nga ai dhe ai do të jepte ujë të*

<sup>31</sup>-Mitrush Kuteli, Vepra letrare, IV, Tiranë 1990, faqe 213-214.

<sup>32</sup>-Arminoit ka qenë një fisnik shqiptar, i cili u shërbente osmanëve.

*gjallë”.* Gruaja iu drejtua:- Zot, ti nuk ke as kovë për të nxjerrë ujë nga pusi, nga e ke pra atë ujë të gjallë. Vallë mos je më i madh se Jakovi, ati ynë ? Jisui iu përgjigj: *“Kushdo që pi nga ky ujë do të ketë përsëri etje, por kush pi nga uji që do ti jap unë nuk do të ketë kurrë etje”* (Joani 4, 5-42).

E dhëna kryesore e Ungjillit është dialogu që bën Krishti me gruan samaritane. Ne kemi parë edhe raste të tjera që Jisui dialogon me gratë e përdala, me lebrozët, me targambledhësit, me farisenjtë etj. Megjithatë ai kurrë nuk i gjykoi njerëzit, por i trajtonte të gjithë me dhembshuri dhe dashuri. Krishti me anë të dialogut arriti që ta bindte atë grua që të ndryshonte udhë dhe kështu ndodhi vërtet. Samaritanja u ndriçua dhe u shenjtërua. Fundi i rrëfimit rreth gruas samaritane nuk është shkruar në Ungjill, por nga tradita e kishës dimë që ajo grua mëkatore pas takimit me Krishtin, mori një drejtim tjetër në jetën e saj, duke u martirizuar. Kjo është Shën Fotinia. Samaritania e Ungjillit të sotëm u gjend përpara dy burimeve. Pusi i Jakovit i dha asaj ujin material, ndërsa Krishti atë shpirtëror. Gjithashtu duke u nisur nga pasazhet e biblike, për dashurinë ndaj armikut, janë krijuar anekdoda të ndryshme. Njëherë gjenerali Silvester Ugo po kalonte përmes fushës së betejës. Papritur dëgjoi një klithmë. Ishte një ushtar armik i plagosur që kërkonte pak unë. Gjenerali, mori paguren, por në kohën që po matej për t'i dhënë të pinte, i plagosuri nxori pistoletën dhe e qëlloi, por fatmirësisht pa e prekur. Por gjenerali trim nuk u tërhoq. U përkul përsëri me paguren në dorë. Lipset guxim e heroizëm, për të treguar dikush dashurinë për armikun.

## KËNGA E TANËS

Kënga e Tanës bën fjalë për komunikimin mes njerëzve duke përdorur si mjet komunikimi mesazhin që buron prej tingujve të fyellit. Në jug të Shqipërisë e njohim me emrin “Kënga e Tanës”. Kjo këngë bën fjalë për përdorimin e muzikës si gjuhë dhe heq paralele me forcën e harpës së Orfeut. Sipas Prof. Ramadan Sokolit: -fyelltarët e vjetër të malësive tona mendonin se jonet e fyellit ushtronin ndikim të dobishëm mbi bagëtitë. Në mënyrë përmbledhëse historia e këngës është: Tana kishte rënë në dashuri me një bari që kulloste dhëntë në mal. Të rinjtë kuptoheshin nëpërmjet melodisë së fyellit që bariu e zotëronte me mjeshtëri të rrallë. Njëherë në stan venë hajdutët dhe i grabitën delet. Bariu u kërkoi si nder që ta linin t’i bjerë fyellit. Me anën e tingujve të fyellit, bariu njoftoi Tanën për atë çfarë i kishte ngjarë.

Tanë, Tanë, e zeza Tanë,  
zgjuaj nënën e babanë,  
se dhëntë tona shkuan e vanë,  
te lisi në brekt janë,  
qen’ e zi të madh e vranë,  
dashn’ ogiç për hell e kanë

Në Kosovë balada e Tanës njihet me emrin “Kajka e çobaneshës”.

N’ato bjeshk’, n’ato ledina,  
Mir’ po bin-o qata fylla,  
Po ma s’miri ndër ata fylla,  
Bike fylli i çobaneshës,  
Çobaneshës qasaj kreshnikes,  
Qi po i ruen treqind cop’ dhen.

Balada e Tanës është cilësuar si “këngë barinjsh” ku në qendër të saj qëndron motivi i mitit të muzikës si art. Fyelli është një vegël muzikore që përdoret kryesisht prej çobanëve. Emërtimet për fyellin janë të shumta: *cirifilja* dhe *cula* në Labëri, *duduku* në jug-lindje të Shqipërisë, *kavalli* në rrethin e Gramshit, *fishkaroli* dhe *flojera* tek arbëreshët etj. Fyelli bëhet me dru bushi, shtogu, panje, arre, por edhe nga gypa metalikë prej tunxhi ose bronxi. Repertori i melodive të fyelltarëve lidhet me mjediset blektorale. Tingujt e fyellit kombinohen me rënien e këmborëve të bagëtitë. Shpesh bashkohen dy fyej, ku njeri luan melodinë dhe tjetri mban ison.

Prej shokës fyllin e nxerr,  
Nxerr fyllin e mir’ po i bjen,  
Kush e nin, n’ dhe gjall’ po hin.  
Ka nis’ bjeshka me ushtue,  
Kan’ nis’ krojet mos me bunue,  
Jan’ nal’ projet, s’po udhtojnë,  
Asht nal’ shpent ma nuk po knojnë,  
Jan’ nis’ zanat aty me ardhë.  
Tre sahat fylli asht ni,  
Larg asht ni n’shipi t’çobaneshës,  
E kan’ njoft fyllin e çobaneshës,  
Çobaneshë qi asht shumë ngusht;  
Shum ngusht-o e n’zor të madh.

Kjo këngë është mbledhur në Karaçevën e Epërme të Kosovës.<sup>33</sup> Folkloristi Agron Xhangolli duke gjurmuar në Lapardha të Vlorës ka mbledhur një variant tjetër të titulluar *Legjenda e Tanës*.<sup>34</sup>

<sup>33</sup>-Vladimir Zoto, Balada shqiptare, Dasara, Tiranë 2006, faqe 209-213.

<sup>34</sup>-Anton Pappleka, Balada shqiptare, Toena, Tiranë 2005, faqe 109-110.



Tan' moj e zeza Tanë,  
Se dhënt, i muarr' dhe vanë,  
Tan' moj e zeza Tanë,  
Dhe mua lidhur më kanë,  
Tan' moj e zeza Tanë,  
Korbecin në shtrung' e vranë,  
Tan' moj e zeza Tanë,  
Erdhën hajdutët në stan.

Balada e Tanës ka një shtrirje të gjerë gjeografike. Këtë këngë e hasim në Eube të Greqisë, Kosovë, Çamëri, Sarandë, Gjirokastër, Përmet, Tepelenë, Vlorë, Fier, Lushnjë, Berat, Skrapar, Gramsh, Kolonjë, Korçë, Pogradec, Elbasan, Dibër, Kukës etj. Në fondet e Institutit të Kulturës Popullore në Tiranë gjenden rreth 70 variante të kësaj kënge. Mund të themi se kjo këngë ka marrë motive nga jeta liturgjike e kishës. Protopsalti i fryn *diapazonit* për të dhënë tingullin përkatës tek psaltët që e pasojnë. Gjithashtu duke dëgjuar tinguj e kanbanës besimtarët mblidhen në kishë. Tingujt janë të ndryshëm sipas rasteve. Në rast se ka vdekur dikush kambana bie përzishëm. Në të kremte të mëdha bie më hareshëm se në të kremtet e zakonshme. Besimtarët dëgjojnë tingujt dhe rendin drejt kishës për zi ose për gëzim. Shembuj të ngjashëm me këngën e Tanës kemi edhe në ciklin e kreshnikëve në veri të Shqipërisë. Kur duan t'ja prishin gjumin Mujit, nga që ka ndodhur një ngjarje e rëndë, dikush i bie lahutës tek koka e shtratit. Në këtë mënyrë ai zgjohet natyrshëm. Në këto raste përdoret si zëdhënës tingulli i lahutës. Në këngët "Halili merr Rushën e Krajlit" dhe "Halili i qet bejleg Mujës".

1-Ia kan' pru lahutën prej palnet  
edhe zharkun prej gomarit  
edhe qime t'kalit t'mazit,  
edhe at dorzën e kish prej thanet.  
Merr Sokoli n'dor me i ra,  
fort ma mir me goj' po i ndihmon,  
në Jutbin' me Mujën po fol:

2-Sa kan' ardh' n'oborr të kishës,  
ka qit Muja, u paska thanë:  
-Nji rixha e kam me ju:  
nji her' izmin me ma dhane,  
sall nji her' po du' me knu,  
shoqin tem mrapa s'po e la,  
as n'Shqypni, as në kaurr.  
Ç'ka ka than' Muji me kajkë?

Në mitologjinë greke përsa i përket komunikimit nëpërmjet gjuhës së tingujve kemi legjendën e Arionit (rreth vitit 625 p.k), poetit dhe muzikantit nga ishulli Lesbos, i cili nëpërmjet lirës së tij komunikonte me delfinët e detit.

## KREU I TRETË

### MBYTJA E DHESPOTIT

Më 8 maj të vitit 1875 Mitropoli i Korçës, Dhorothe Evelpidhi u mbyt në Vjosë. Trupi i tij u gjet pas një jave në fshatin Peshtan. Imzot Dhorotheu kishte vendosur që Pashkët e atij viti t'i celebronte në fshatrat e Përmetit, por nuk mundi që ta realizonte misionin e tij. Ndërsa po kthehej për në Përmet, e zuri një shi i stuhishëm dhe i pafuqishëm që t'i rezistonte rrymës u mbyt në Vjosë. Besimtarët menjëherë e përjetësuan në vargje:

Në përrua të Velçishtit,  
Seç u mbyt veqil i Krishtit,  
N,atë përrua të shkretë  
Seç u mbyt veqili vetë,  
Atje ku s'kishte asnjë pulë  
U mbyt goxha dhespot me vulë.

Lipsani i tij u varros në hieroren e Kishës së Shën Kollit në Përmet. Imzot Dhorotheu përpara se të bëhej Mitropoli i Korçës ka pasur një funksion shumë të rëndësishëm atë të Protosingjelit të Madh të Patriarkanës Ekumenike.<sup>1</sup>

<sup>1</sup>-Stilian Adhami, Vështrim mbi kulturën popullore të trevës së Përmetit, Tiranë 2002, faqe 221-222.

## KËNGA E ÇAUSH PRIFTIT

Kënga e Çaush Priftit flet për kryengritjen e Hormovës. Vendasit u mblodhën tek rrapi i Dervenit dhe i shpunë fjalë Ali beut që të vinte në Tepelenë.

Nd'atë zemanin e parë,  
hormovitë kordhëtarë,  
tetëqind qenë me pallë.  
Tetëqind me pallë qenë,  
te rrapi zunë dervenë,  
Dëgojnë mi Ali benë  
të vij posht' në Tepelenë,  
se xhindet muarnë dhenë.

Kjo këngë është kënduar në Labovë të Madhe të Gjirokstrës më 1949. Një këngë tjetër bën fjalë për kryengritjen hormovitëve, nën udhëheqjen e priftit Çaush kundër Ali pashë Tepelenës.

Hormovitë kordhëtarë,  
Katërqind burra me armë,  
Të gjithë me jataganë,  
Te ur, e Subashit vanë,  
Të vritnin Ali Pashanë.

Më pas kënga vijon me hakmarrjen e pamëshirëshme të vezirit të Janinës ndaj hormovitëve.

Gjithë geg' e tosk' i mblodhi,  
Në Hormovë i dërgoi,  
Çaush priftin e kërkoi,  
Të gjallë në hell' e shkoi.

Kjo këngë është mbledhur gjatë ekspeditës së Qemal Haxhihasanit në rrethin e Përmetit. Gjithashtu edhe Thimi Mitko dhe Spiro Dine kanë botuar variante të përafërta me këngën e mësipërme.<sup>2</sup> Gjyshti im, Koço Llukani “Mësues i merituar” më ka rrëfyer një variant të ngjashëm, i cili tregon për besimin dhe burrërinë e priftit të Hormovës.

Çaush bej, Çaush Hormova,  
Me pikë helli trupin ta shkova,  
Besën dot s'ta ndërrova.

Çaush Prifti ishte një kapedan i krishterë, i cili më 1746 u dorëzoi si skllave kardhiqiotëve, të ëmën e Ali pashës. Kur mësoi këtë gjë Ali pashai u hakmorr ndaj Çaush Priftit. Ai urdhëroi që ta kapnin dhe ta pjekin në hell. Kështu ndodhi vërtet, më 1759. Këtë ngjarje e rrëfen kënga e mbledhur nga Thimi Mitko.

Kini par, a s'kini parë,  
Të piekë, i biri tanë?  
Që Hormov' e tatëpietë,  
Kapedan se ç'jeshë vetë.  
Me njëqind e pesëdhjetë,  
S'fala turk mbë këtë jetë.  
Kapedan, o Çaush priftë,  
Ç' deshe ti te Hormovitë?  
Mo na shkoni nga Zhulati,  
Se na sheh Isuf Arapi.  
Kapedan Çaush-Hormova,  
Dhiam' e dyllë të pikova,  
Ty dot besën s'ta ndërrova,  
Nën' o moj, e zeza nënë!  
Del e shih Çaushnë tënë.  
Tek' e piekinë ndë lëmë.

<sup>2</sup>-Stilian Adhami, Vështrim mbi kulturën popullore të trevës së Përmetit, Tiranë 2002, faqe 228.

Isuf-Arapi, një gjëmë!  
Tyn'ore Isuf-Arapi.  
Ç't'ertka ndore si kasapi.

Ndonëse Çaush Prifti i Hormovës u shkua në hell prej Ali Pashait, nipi i tij Vasil Papakristu duke vazhduar traditën e familjes, u dorëzua Mitropolit i Drinopulit. Vasil Papakristu qëndroi në fronin e Mitropolitit të Drinopulit nga viti 1909 deri në 1929. Ai fjeti më 26 shkurt të vitit 1936 dhe u varros në Delvinaqi. Në ditën e varrimit të tij, pazari i Janinës u mbyll në shenjë zie kombëtare. Monumenti i tij që gjendet në Delvinaqi ka të njejtën vlerë me ushtarin e panjohur.<sup>3</sup>

## KORFUZI KA TË ZONË

Në librin “Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar II” faqe 101, gjendet një këngë e mbledhur nga Thimi Mitko, e cila flet për një mrekulli të Shën Spiridhonit.

Se Korfuzi ka të zonë,  
Të zonë Shën Spiridhonë.  
Spiridhon, o shënjt i gjallë,  
Re në det e dolle mbanë,  
Shpëtove Korfuz kalanë!  
Tetë kandile t'ergjenda,  
Katër jasht' e katër brenda,  
Tri të lara me flori,  
As e fal, o Perëndi!

Kjo ngjarje ka ndodhur në vitin 1716, ku Shën Spiridhoni me anë të një mrekullie shpëtoi Korfuzin. Agarinasit

<sup>3</sup>-G. Gagari. Kalendari Dhodhoni, Viti II 1899, faqe 142-144

rrethuan Korfuzin nga toka dhe deti. Ky rrethim zgjati nga 24 qershori deri më 11 gusht. Ushtarët armiq qenë të shumtë, rreth 50.000, të cilët i usdhëhiqte Pizani. Banorët e Korfuzit kërkuan ndërmjetimin e Shën Spiridhonit, i cili u shfaq në të gdhirë të 11 gushtit 1716. Shën Spiridhoni mbante në dorën e djathtë një shpatë të zjarrtë. Papritmas në det filloi një furtunë e madhe, e cila i mbyti anijet armike. Këtë ngjarje populli e përjetësoi në vargjet e këngës që përmendëm mësipër, e cila ka ngjashmëri me një himn që është krijuar në Kostandinopojë.<sup>4</sup>

Përlufteshës Gjenerale është një himn i krijuar nga populli i Kostandinopojës gjatë një rreziku që kanoste qytetin. Perandori Iraklio u vu në krye të ushtrisë, në luftën kundër persëve. Në ceremoninë zyrtare që u bë në kishën e Shën Sofisë, më 5 Prill 622, ditë që përkonte me të Hënën e Pashkës, u lutën më Zotin që të mbështeste qytetin dhe bijtë e tij të mitur nën mbrojtjen e Hyjlindëses. Ndërsa Iraklio ndërmori beteja fitimtare në luftën ndaj persëve, Avarët sulmojnë papritur Kostandinopojën nga toka e deti.

Të gjithë, të mëdhenj e të vegjël luteshin më Zotin, duke u përpjekur me ç'të mundnin për të mbrojtur qytetin. Patriku Serxhio me ikonën e Hyjlindëses në duar frymëzoi të paktit, por heronj mbrojtës të qytetit. Të gjithë këkonin ndërmjetimet e Hyjlindëses. Ata e quajnë "Përlufteshës Gjenerale" në luftën e pabarabartë të tyre. Dyndjet e sulmeve avare s'mbrapseshin nga luftëtarët trima. Papritur, një furtunë e fortë i zhyti anijet armike në det. Mrekullia që të gjithë e prisnin tashmë ishte bërë realitet. Hyjlindësja kishte shpëtuar qytetin. Banorët e Kostandinopojës, u grumbulluan në kishën e Shën Marisë në Vllahernë, ku në shenjë mirënjohje e shprestarie psalën pa u ulur himnin falenderues të Hyjlindëses që u bë atë natë.

<sup>4</sup>-Dhimitër Vasho, Kujt i përket lavdia, faqe 380.

Përlufteshës Gjenerale, këngët mundëse  
Si falenderim që u shpërbleve prej tmerreve.  
Qyteti yt po të përshkruan o Virgjëreshë  
Po sikundër ke fuqi të palëftuarshme  
Prej çfarëdo rreziqesh shpëtomë,  
Sepse të thërres "Gëzohu o Nuse e panusëruar".

Ky himn, së bashku me disa tropare të tjera, si dhe gjithë përshëndetjet e Hyjlindëses që ishin bërë deri më atë kohë u quajtën "Himni Akathist" (sepse u psall në këmbë). Ky himn këndohet në të pesë të Premtet e Kreshmëve të Mëdha.<sup>5</sup>

## O E BUKURA MORE

Nuk dihet se cili arbëresh i ka thurrur këto vargje dhe kush e këndoi i pari këtë këngë nostalgjie dhe dhimbjeje për atdheun e të parëve. Kjo këngë për herë të parë u gjet në dorëshkrimin e Kieutit (1708) dhe më pas e botoi Dhimitër Kamarda në librin *Appendice al Saggio di Grammatologia Comprata sulla lingua Albanese* më 1866.<sup>6</sup>

Oj e bukura More,  
si të le e më ngë të pash  
atje kam u zotin tat  
atje kam u zonjën mëmë  
atje kam edhe tim vëlla  
gjithë t'buluar nën at dhe!

<sup>5</sup>-Përlufteshës Gjenerale, Ngjallja, mars 1999, faqe 7.

<sup>6</sup>-Hyqmet Zane, Historia e një kënge 600-vjeçare, Republika, 14 gusht 2008, faqe 16.

Moreja është Peleponezi i Greqisë, nga ku u larguan arbëreshët drejt Italisë. Me pushtimin e kështjellës së Koronës në Peleponez më 1534 Andrea Doria mori arvanitët dhe i shpuri në Italinë e Jugut, në Kalabri dhe në Sicili.<sup>7</sup>

Na tha Dorja, zoti Ndre  
Lipim qellnjëm ka do vemi  
Se buartim mallin e s'e kemi  
Me kët zemër, me këta si  
Klajëm keq kët Arbëri.  
Ndallandishe e ler e ler  
Kur të vish ti te Korona  
E s'gjën më shpit e tona!  
Më së gjën trima hajdhjar  
Po ngë një qen, çë kloft i vrar!  
Kur u nistin gjith ka sit  
Burrat gjith me një vajtim  
Thirrtin grat me një vajtim  
Dil e hana ti, Stihji!  
Oj More! Oj Arbëri!

Gjithashtu pas rënies së Krujës (1478) shqiptarë të tjerë u shpërngulën drejt Italisë në tokat e Pulias, të cilat ia pati dhuruar Gjergj Kastriotit princi Ferdinand. Shqiptarët katolikë u përshtatën shpejt me gjuhën, kulturën dhe fenë e vendasve, ndërsa shqiptarët ortodoksë ruajtën fenë dhe ritualin ortodoks bizantin.<sup>8</sup>

Petkat e të mirat tona  
Na i lam te Korona  
Krishtin na kemi me ne  
Oj e bukura More.

<sup>7</sup>-Arbëreshët dhe kënga e Moresë, Le Radici, Anno 5, n.6, dicembre 2007, pagina 7.

<sup>8</sup>-Lirio Nushi, O e bukura More, Le Radici, Anno 6, n.3, luglio 2008, pagina 8.

Thell të plas, me lot ndër si  
Na të lipisnjëm, Arbëri!  
Petkat e të mirat tona  
Na i lam te Korona  
Shën Mërin kemi me ne  
Oj e bukura More.

Meqenëse këta të shpërngulur nga trojet e tyre kishin besimin ortodoks, gabimisht ata i merrnin për grekë, prandaj krahina pranë Palermos u quajt "Piana dei Greci" (krahina e grekëve) deri në kohën kur Musolini e korrigjoi atë në "Piana degli Albanesi". Madje edhe sot e kësaj dite këta njerëz e quajnë veten me krenari "Arbëreshë".

Thell të plast, me lot ndër si  
Na të lipisnjëm, Arbëri  
Malet tan me lis e driza  
Të bukur kronje, të bukur gropa  
Të bukur gjerdhe me fallopa!  
Jemi e vemi ndë Itali  
E më, s'ju shomi me këta si!  
Dherat të huaj hare s'kan  
Se s'mbllin printët tan  
Prindë, luftuat me thik në dor  
Ndërpër shi e ndërpër bor  
Ni ju lëm pa një qiri  
Luajtim valle nd'atë More  
Shtum kangjle ndë ato hije  
Klisht e tona të bukuruara  
Shpizit tona të nderuara!  
Ni vjen turku, turki i zi  
E tërpëron klishe e shpi.

Këta refugjatë vazhdonin të kishin ritin ortodoks dhe kishin dy episkopë, njerin në Ungra të Kalabrisë dhe tjetrin në Piana degli Albanesi, ose siç e quanin ndryshe Hora e Arbëreshëve. Për dorëzimin e priftërinjve ata u drejtoheshin peshkopëve të kolonive italo-greke. Nga shkaku se flisnin gjuhën shqipe dhe kishin ritin ortodoks, ata u ndeshën me vështirësi në mjedisin latin. Për të lehtësuar kalimin e tyre në ritin latin në vitin 1576, Papa Gregori XIII themeloi Kolegjin Grek në Romë. Qendra të tjera të kulturës shqiptare dhe të mësimit shqip qenë: Kolegji Ilir në Loreto, Manastiri Bazilian i Grotaferratës, Seminari Greko-Arbëresh i Palermos etj.

### VAJZA E VALËVE

Kjo këngë është krijuar nga rapsodi popullor Neço Muko dhe është kënduar në Himarë nga grupi polifonik i “Akroqeranës” më 10 shkurt të vitit 1923. Himariotët tregojnë se shkëmbi ku u thurr kënga gjendet në Gjirin e Gjipesë. Plaku i urtë Neço Muko rrinte mbi një gur të futur në det dhe shkruante vargjet e këngës “Vajza e Valëve”.

Vajza e valëve zemëra s’ja mban  
Mbi një gur anës detit qan e zeza qan!  
Pret atë që prët dhe një dhimje ndjen  
Gjithë bota venë e vijnë, po ai nuk vjen?  
Pranvera arrin një mëngjes të qet’  
Vijnë e shkojnë dallandyshtet vajza u thërret.

“Ju të bukur zogj” te ju kam një shpres’  
Ju që shkoni dete e male dua t’ju pyes!  
Një jetime jam pa nënë dhe baba  
Një që kisha një që doja iku dhe më la!

Mo se patë ju rron apo nuk ron  
Ndonjë lajm a ndonjë letër vallë më kujton.

Shkoi shumë koh’ vetëm pa njeri  
Qante vetëm qante fatin n’atë varfëri!  
Erdhi dimri i keq një mëngjes të zi  
Ç’u nxi qielli edhe deti gjëmon bie shi!  
Në ëndër se ç’e pa djalin në vapor  
Sikur shkonte dhe i hodhi vajzës një kuror.

Letër e zezë vjen e me të vërtet’  
Djali kishte udhëtuar pa kthimin për jet’!  
Thoshte i mjeri djali, Vajzë e Valëve,  
Merre këtë letër e qamë: tjetër vend më prët  
Ah, kjo dynja një qëndrim nuk mba  
Dashuria jonë shuhet fati i zi na ndan!

Mos u dëshpëro je një vajzë e re,  
Unë martohen në atë jetë e ti martohu atje!!!  
“Vajzë e Valëve” t’i qofsh me shëndet,  
Mos kujto jetën e shkuar po harroje shpejt!  
O i dashur djalë që shkove dhe më le  
S’pate faj as ti as unë ashtu qe për ne!

Ne u ndamë këtu qielli atje lart  
Do të na bashkojë o djalë, prit se vij për pak!  
Lamtumir o gur mjaft me laqë koh’  
Vuajte edhe ti për mua shkoi e më s’të shoh!  
Haj dynja, dynja s’ke gjë të vërtet’  
Lamtumirë o jetë e rreme, merrëm val o det!

Kjo këngë është ruajtur së bashku me disa perla të tjera të muzikës polifonike himariote. Të gjitha këngët e kënduara

nga grupi polifonik i “Akroqeranës” i ka mbledhur me kujdes Mësuesi i Popullit, Janko Pali. Banorët e Himarës kanë pranuar propozimin e diturakut Moikom Zeqo, që mbi shkëmbin ku u thurr kënga “Vajza e Valëve” të ngrihet një monument vajze. Në Danimarkë, mbi një shkëmb të tillë ngrihet statuja e “Sirenës së vogël” për të kujtuar Hans Kristian Andersen, i cili ishte përraltari më i madh i botës.<sup>9</sup>

### KËNGA E GERALDINËS

Kënga i kushtohet mbretëreshës Geraldinë dhe është kënduar në ditën e dasmës së mbretit Zog I. Sipas traditës shqiptare në përfundim të dasmës, nusja e re duhej t’u servirte kafënë të ftuarve. Kështu veproi edhe mbreti Zogu I. Mbretëresha ndonëse e huaj, që në ditën e parë të dasmës filloi të kryente zakonet e moçëm shqiptar. Ndërsa të ftuarit e shumë të pinin kafënë që ua kishte servirur mbretëresha Geraldinë, një dasmor nga fshati Dukat i Vlorës sajoi dhe këndoi këngën e Manxhares.

Manxhare leshura tënë,  
Ke ikur ke lënë vënë,  
Kaluar apo në këmbë?  
Kaluar se s’dija vëndë.  
Fajin ta pati jot ëmë,  
Të dha në oxhak të rëndë,  
Ç’u trete qiri në këmbë,  
Kafe miqve duke dhënë.

Manxhare do të thotë hungareze. Kjo këngë është kënduar në Vlorë, Tepelenë, Berat etj. Gratë e këndonin këngën

<sup>9</sup>—Irena Shabani, Miti i Vajzës së Valëve përjetësohet në shkëmbin, Panorama, 1 qershor 2003, faqe 19.

në momentin kur nusja zbriste nga kali dhe e shpinin në dhomë që të nusëronte. Menjëherë vinte dhëndëri dhe i hiqte duvakun. Pas kësaj gratë ia merrnin këngës: Manxhure leshura tënë... Kënga këndohej përsëri, atëherë kur nusja u servirte kafënë dasmorëve, përpara se të largoheshin. Me pirjen e kafesë dasma mbyllej dhe nusja dorovitej. Të ftuarit shkundnin xhepat mirë dhe largoheshin. Paratë më të shumta i doroviste dajua. Mbretëresha Geraldinë u ka servirur gjithë dasmorëve kafënë për t’u treguar bujare ndaj mbretit Zogu I, i cili si njeri i emancipuar dhe fisnik që ishte, pranoi kushtet e martesës. Cilat qenë kushtet? Gazeta zyrtare e Vatikanit “Observatore Romana” e datës 15 shkurt 1938 sqaronte pozicionin e Selisë së Shenjtë në lidhje me miratimin e kërkesës për martesë të Mbretit Zogu I, i cili i përkiste besimit musliman dhe princshës Geraldinë që ishte katolike. “Kushti kryesor sipas së Drejtës Kanonike Kishtare, ishte që martesë duhet të bëhej sipas ritit të Kishës Romanokatolike dhe duhej të celebruhej përpara martesës civile. Gjithashtu nusja katolike nuk duhej të ndryshonte besimin e saj dhe fëmijët e lindur nga kjo martesë duhet të edukoheshin sipas besimit romanokatolik”.<sup>10</sup>

Por si u mundësua ardhja e konteshës Geraldinë në Shqipëri? Sekretari personal i mbretit Zogu I, Jak Koci u dërgua të vizitonte familjen e konteshës Apponyi në Budapest. Ai i parashtrroi familjes Apponyi se mbretit i pëlqente eleganca dhe sharmi i konteshës dhe dëshironte të njihej nga afër me të. Gjithashtu u ofroi ftesën për një vizitë në Tiranë, gjë e cila u prit mirë nga kontesha dhe familja e saj. Më 30 dhjetor 1937 kontesha Geraldina Apponyi, e cila njihej si “Trëndafili i bardhë i Hungarisë” mbërriti në Tiranë. Kontesha shoqërohej nga baroni Rueling, kujdestari i familjes Apponyi. Për të pritur konteshën kishte dalë ministri i oborrit mbretëror Sotir Martini. Të

<sup>10</sup>—Astrit Kola, Kushtet e Vatikanit për miratimin e fejesës së mbretit Zog, 55, 8 korrik 2007, faqe 16-17.

nesërmen më 31 dhjetor 1937 kontesha Geraldinë u prit në pallatin mbretëror. Gjatë ballos së organizuar me këtë rast kontesha shoqërohej nga princesha Snije, e cila e prezantoi me mbretin Zog. Ky i fundit pasi bisedoi me të në gjermanisht i propozoi për martesë. Kështu më 27 janar 1938 Oborri Mbretëror konfirmoi zyrtarisht martesën ndërmjet mbretit dhe konteshës. Për këtë arsye kryeparlamentari Pandeli Evangjeli, më 31 janar 1938 thirri parlamentin në seancë të jashtëzakonshme për të shqyrtuar kërkesën për martesë së Mbretit Zogu I me konteshën Geraldina Apponyi. Parlamenti konform nenit 89 të Statutit Themeltar të Shtetit miratoi unanimisht kërkesën. Menjëherë pas miratimit zyrtar, me anën e një dekreti mbretëror kontesha Geraldinë u ngjit në rangun e “Princëshës së Shqipërisë”.<sup>11</sup>

### BALTA

Andon Zako Çajupi ka botuar vjershën “Balta” në revistën Albania më 1904.

Baltë, moj balt' e bekuar,  
Ti nukë je për të sharë,  
Se Zoti të ka gatuar  
Kur bëri njerin' e parë.  
Mori baltën e gatoi  
Zot' i Math e i vërtetë  
Edhe përmbi baltë shkroi  
Zoti, fytyrën e vetë.  
Gjithë pra nga balta jemi,  
Se nga baltë jemi bërë  
Dhe në baltë do të vemi,

<sup>11</sup>-Mbreti Zog, fejesa, Vatikani dhe kriza gjeopolitike, Standart, 06-05-2006, faqe 19-20.

Si kanë vatur të tërë...  
Mos më shaj, Zoti të faltë;  
Me fuqi të Perëndisë,  
Dhe në jam bërë nga baltë,  
Jam nga balt' e Shqipërisë.

Këtë vjershë Çajupi e krijoi për të replikuar me mikun e tij Milo Duçi. Ky i fundit kishte botuar disa vargje satirike për Çajupin: “Si vjershëtor lartë hipe / Vjershëria është' e naltë / Ngrite vjershërinë shqipe / Po..si...njeri..re në baltë”.<sup>12</sup>

### BETIMI MBI FLAMUR

I pari që ka shkruar për Himnin Kombëtar është Lasgush Poradeci. Në artikullin “Himni kombëtar “Flamurit pranë të bashkuar dhe gjeneza e tij”, Poradeci trajton me vërtetësi historinë e himnit kombëtar. Sipas Poradecit shqiptarët e Bukureshtit kishin korin e tyre, që drejtohej nga rumuni Ionesku. Përveç këngëve patriotike shqiptare, kori mësoi edhe himnin e Rumanisë, i cili titullohej “Mbi flamurin tonë”.

Mi flamurin t'onë është shkruar bashkim,  
bashkim në vetëdije dhe në ndjenja  
dhe në hijen e tij të madhërishtme  
do përballim çdo goditje.

Në luftën e rëndë trembet ay,  
që vetë është mëndje-arratur,  
po ne të bashkuar në çdo kohë  
do jemi, do jemi mundës.

<sup>12</sup>-Andon Zako Çajupi, Baba Tomorri, Dituria, Tiranë 1997, faqe 142-143.



E armatosmë dorën t' onë  
që të mpruajmë një vend të shtrenjtë,  
e drejta jonë është zotëronjëse,  
dhe qëllimi ynë i shenjtë.

Dhe në librën e përjetësisë shkruan  
se shumë kombe do humbasin,  
po Rumanija jonë e Shtrenjtë  
përjetë, përjetë do lulëzojë.

Himni kombëtar i Rumanisë është shkruar nga poeti  
Ioan Barsan dhe është kompozuar prej Ciprian Porumbeskut.  
Shqiptarët e Rumanisë të entuzjasmuar prej këtij himni iu lutën  
Asdrenit që të përshtaste vargjet në gjuhën shqipe. Poeti Asdreni  
përshtati fjalët shqipe sipas melodisë së himnit rumun dhe tekstin  
e titulloi “Betimi mbi flamur”.

Rreth flamurit të përbashkuar,  
me një dëshir' e një qëllim,  
të gjith' atij duk' iu betuar,  
të lidhim besën për shpëtim.

Prej lufte veç ay largohet,  
që është lindur tradhëtor,  
kush është burrë, nuk frikohet,  
po vdes, po vdes si një dëshmor.

Në dorë armët do t' i mbajmë,  
të mprojmë atdhenë në çdo kënt;  
të drejtat tona ne s' i ndajmë,  
këtu armiqtë s' kanë vënt!

Se Zoti vetë e tha me gojë,  
që kombe shuhen përmbi dhe,  
po Shqipëria do të rrojë,  
për të, për të luftojmë ne!

O flamur, flamur, shenj' e shenjtë,  
te ty betohemi këtu.  
për Shqipërin' e atdhen' e shtrenjtë,  
për nder edhe lavdimn e tu.

Trim, burrë quhet dhe nderohet  
Atdheut kush iu bë theror,  
për jet' ay do të kujtohet  
mi dhet, mi dhet si një shenjtor!

Ky himn u popullarizua shumë tek shqiptarët e  
Bukureshtit dhe më 1908 mbërriti në atdhe me anën e Tashko  
Ilos dhe Hilë Mosit. Këta të fundit sollën partiturat e himnit në  
Korçë dhe më pas e përhapën në gjithë Shqipërinë. Hilë Mosi,  
i cili kishte prirje për muzikë bëri përshtatjen e himnit në gjuhën  
shqipe sipas muzikës rumune. Ky himn ka shoqëruar ngritjen e  
flamurit në Vlorë, më 28 nëntor të vitit 1912. Ndonëse në atë  
kohë kishte pesë himne të ndryshme, megjithatë u vendos që  
himni kombëtar të mbetej ky, i cili qe i huaj si në tekst edhe në  
vijën melodike.

Pas shpalljes së Pavarësisë shumë patriotë shqiptarë  
filluan të krijonin tekste të himnit kombëtar. Disa nga krijuesit  
janë: Anton Zako Çajupi “Hymni Kombëtar” më 1913, Gjergj  
Fishta më 1913, Ernest Koliqi më 1921, Fan Noli “Hymni i  
flamurit” më 1926, Mihal Grameno “Kënga kombëtare”,  
Lasgush Poradeci më 1933 dhe Hilë Mosi “Himn i Djelmënisë  
Shqiptare”.

Thirjes për të krijuar himnin kombëtar shqiptar nuk i ka shpëtuar edhe Çajupi. Në përvjetorin e parë të shpalljes së Pavarësisë, më 1913 Andon Zako Çajupi ka shkruar poemën “Një Endërr”. Në faqen e fundit të këtij dorëshkrimi gjendet teksti i himnit kombëtar i shkruar me laps. Ky himn përbëhet prej tetë vargjesh, ku vargu i tretë është fshirë nga koha. Poezia e tij titullohet “Hymni Kombëtar”.

Male, Male Shqipëria  
është djep’i Trimërisë  
.....  
dhe urat’ e Perëndisë.

Neve këtë vënt nderojmë  
ndë këtë vënt do të rojmë  
për këtë vënt do të vdesim  
më të bukur nafak s’presim

Teksti i Çajupit përshruhet nga një ndjenjë e thellë patriotike dhe e rendit poetin në listën e atyre që patën kurojon të shkruanin Himnin Kombëtar. Gjergj Fishta më 1913 krijoi një himn mjaft të bukur, i cili këndohej me ëndje nga rinia shkodrane. Sipas poetit Fatos Arapi himni i Fishtës është autentik shqiptar, ndonëse nuk dihet me saktësi se kush e ka kompozuar.

Posi fleta e engjëllit t’Zotit,  
por edhe flamuri i Shqipërisë  
thërret bijtë e Kastriotit  
me u mbledh tok në çeta t’ushtrisë

Bini toskë e bini gegë  
si dy rr’fe që shkojnë t’uj djeg  
bini lekë e malësorë  
trima lidhuni dor’ për dor.

Më 14 nëntor të vitit 1926, Noli ka shkruar “Himni i flamurit”, ku tregon qëndresën e popullit tonë ndër shekuj. “Himni i flamurit” u botua në gazetën “Liria kombëtare” të Gjenevës.

O Flamur gjak, o flamur shkabë,  
o vend e vatr’, o nën’ e babë,  
lagur me lot, djegur me flakë,  
flamur i kuq, flamur i zi.

Fortesë shkëmbi, tmerr tirani,  
s’të tremb romani as veneciani,  
as serb Dushani, as turk sulltani,  
flamur i madh për vegjëli.

Flamur që lint Shën Kostandinin,  
pajton islamin me Krishterimin,  
shpall midis feve vllazërimin,  
flamur bujar për njerëzi.

Në vitin 1931 Hilë Mosi ka shkruar poezinë “Himni i Dlejmënisë Shqiptare”, që është kompozuar nga L. Cireni. Himni është shtypur më 1931, në Tiranë në shtypshkronjën “Vlora”, e cila shquhej për shtypshkrimet muzikore.

Djelmëni, ti je gjith shpresa,  
E njaj hylli, qi agon,  
E n' Shqipni sot po flakron!  
Djelmëni, ti je qindresa,  
E Atdheut, kur n'luft na fton.

Djelmëni gjithmonë përpara,  
Për flamur edhe për mbret,  
Hurra djelm ju dhashtë e mbara,  
N'paq e n'luft kur Shqipja thret.

Gjithkund toka asht e jona,  
Ku kjo gjuhë e shenjtë tingllon,  
E një gjak shqiptar vëlon,  
Pra një zot, na tjetër s'dona,  
Kur në luft Atdheu na fton.

Me rastin e 25-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, në vitin 1937, Mbreti Zogu I ishte inisiatori për shpalljen e konkursit për himnin kombëtar. Për këtë qëllim u ngrit një komision i posaçëm i përbërë nga Parashqevi Kyrias, Mati Logoreci, Kol Rodhe, Telki Selenica, Sotir Papakristo, Karl Gurakuqi, Zoi Xoxa, Lasgush Poradeci, Qemal Bitka dhe Odhise Paskali. Komisioni i mbledhur më 5 mars 1937 ngriti një juri, e cila do të seleksiononte krijimet e paraqitura. Në juri qenë Gjergj Fishta, Mit'had Frashëri dhe Kostandin Cipo. Interesimi i krijuesve për të hartuar një himn me frymë shqiptare ishte i madh. Nga 76 tekstet e paraqitura, juria shpalli fituese poezinë e Beqir Çelës, i cili shkruante me pseudonimin “Osja i Ri”.

O flamur, yll i lirisë,  
valëvit me plot shkëlqim;  
e prej qiellit t' Shqipërisë  
të dëgjohet në amëshim.

Në vijim u zhvillua konkursi për melodinë e himnit kombëtar, të cilin e fitoi kompozitori italian Xhovani Gaeto. Kështu melodia e himnit kombëtar u kompozua përsëri nga një i huaj dhe himni nuk u ndryshua, por mbeti ai që këndohej më parë. Me vlerë ishte edhe krijimi i Kristo Floqit me titull “Flamuri ynë”.

Valo, valo si të ka hije  
Shkrep, po si dielli vetëti,  
Flamur! O shenjtë trimërie  
Valona sot në Shqipëri.

Pas kaq kohë tiranie  
Pesëqind vjet në robëri  
Flamur! O shenjtë trimërie  
Valona sot në Shqipëri.

Shpresa, dëshira atdhësie  
Ndjenja të larta, dashuri!  
Flamur! O shenjtë trimërie  
T'epresim sot në Shqipëri.

Celi, o djemt e Shqipërisë,  
Clodhi, dëshmorët e Atdheut  
Se valon flamur i lirisë  
Flamur i kuq i Skënderbeut.

Valo mi mallet e bekuar  
Brigje dhe fusha ti mbulo  
Valo i mburur, i lëvduar  
Valo flamur! Valo, valo!

Ti që udhëhoqe Skënderbenë  
Në luftra, në mundësi  
Flamur që mbrojte ti atdhenë  
Ngrihu dhe sot në Shqipëri.

Unju më gjunjë të të adhurojmë  
Shpresa dhe fatin varim tek ty  
Dhe besa besënë betohemi  
Flamur! Të vdesim në për ty.

Rrofsh o flamur i Shqipërisë  
Me nder, gëzim e dashuri  
Flamur i bukur i lirisë  
Valona sot në Shqipëri.

Sipas Ramadan Sokolit pas çlirimit të vendit janë zhvilluar edhe 4 konkurse të tjera për himnin kombëtar, por edhe ato kanë dështuar. Konkursi i parë shtetëror për krijimin e himnit tonë kombëtar u zhvillua më 11 janar të vitit 1946. Në konkurs u paraqitën shumë krijime të autorëve vendas. Juria vlerësoi si krijimin më të mirë tekstin e Skënder Luarasit me titull “Himni i Shqipërisë së re”, kompozuar nga Kristo Kono. Gjithsesi ky himn nuk u ligjërua dhe himni kombëtar nuk u zëvendësua.

Në vitin 1970 Këshilli i Ministrave, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë shpallën konkursin për “Himnin e Republikës”, në të cilin morrën pjesë krijuesit më të mirë të

asaj kohe Çesk Zadeja, Ismail Kadareja, Tish Daija, Fatos Arapi, Xhevhair Spahiu, Nikolla Zoraqi, Pjetër Gaci, Feim Ibrahim, Tasim Hoshafi etj. Juria e konkursit arriti të vlerësonte dy krijime, himnin e kompozuar nga Çesk Zadeja dhe atë të Nikolla Zoraqit me tekst të Fatos Arapit “E lirë u ngrit toka jonë”. Janë zhvilluar edhe konkurse të tjera, por himni kombëtar ka mbetur po ai. Vetvetiu na lind pyetja: –A duhet të ndryshojmë himnin? Himni duhet të ndryshojë, sepse çdo himn kombëtar duhet të jetë origjinal dhe i lidhur me kombin. Me rastin e 100 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë shqiptarët të kenë himnin e tyre origjinal.<sup>13</sup>

## LULE BORE

Këngën *Lule bore* e ka kompozuar Simon Gjoni me tekst të Zef Palit. Si çdo këngë edhe *Lule bore* e ka një histori të sajën, pra i është kushtuar dikujt. Dikur një gazetare 19 vjeçare, e cila quhej Florenca Pali vajti me shërbim në qytetin e Shkodrës. Dikush i kishte dhënë një pako për Zef Palin dhe vajza e takoi pranë Shtëpisë së Kulturës. U ulën të pinin kafe në një lokal, pranë të cilit gjendej një kopësht me lule të bukura. Ndërsa Florenca filloi të fliste për letërsinë, poeti Zef Pali seç po shkruante. Sapo përfundoi poezinë iu drejtua Florencës: - Urdhëro këtë e kam për ju. Florenca filloi të lexonte me kureshtje vargjet e poezisë.

Tuj shëtitun n’ mal e n’ kodër  
tuj prek lulet gjithë me dorë,  
në një kopsht ma t’bukurin Shkodër  
ty të gjeta lule bor.

<sup>13</sup>-Andrea Llukani, Historiku i Himnit Kombëtar, Drita, 3 dhjetor 2006, faqe 1, 3.

Je e vogël por e plot  
ty t'kërkoj unë tash sa mot.  
tash sa mot unë ty t'kërkoj  
se me ty jetën do t'çoj.

Eja eja lule bor  
se me ty do të thurr kuror  
Eja eja lule bor  
se me ty do të thurr kuror.

Pash ma t'bukurën stin pranvere  
pash ma t'bukurin drandofill  
mos ja fal ti askujt erën  
se për mu vetëm ke çil.

Zef Pali këputi një tufë me lule bore dhe ia zgjati Forencës duke i thënë: -Nëse keni mirësinë të vini dhe këto lule t'ia dhuroni nënës sime, e cila dergjet në shtrat e sëmurë. Florenca vajti në shtëpinë e Zefit dhe ia dhuroi lulet nënës së tij. Pasi përfundoi shërbimin në Shkodër vajza 19-vjeçare u kthye në Tiranë. Pas disa ditësh ishte shtangur kur kishte dëgjuar në radio këngën *Lule bore*, e cila i ishte kushtuar asaj. Por si u bë i mundur realizimi i këngës? Poeti Zef Pali ia kishte dhënë tekstin kompozitorit Simon Gjoni duke i thënë: -Nëse të frymëzojnë këto vargje merri dhe kompozoi një këngë. Simoni menjëherë krijoi muzikën dhe grupi i miqve të tij Tish Daija, Zef Gruda dhe Tonin Rrota e kishin orkestruar dhe inçizuar në Radio Shkodra. Shumë shpejt kënga *Lule bore* u bë shumë e dashur dhe përhap në gjithë Shqipërinë, sepse bënte fjalë për dashurinë e çiltër të një poeti dhe të një gazetaresje të re në qytetin ku ka shumë lule bore.<sup>14</sup>

<sup>14</sup>-Andrea Llukani, *Lule bore*, *Le Radici*, ano 9, n. 2, Maggio 2011, pagina 17.

## SERENATAT KORÇARE

Korça, qyteti i rrugicave me kalldrëm ose siç quhet ndryshe qyteti i serenatave. Kur lindën dhe kush i këndoi serenatat? Askush nuk mund të japi një përkufizim të qartë, sepse ato lindën natyrshëm dhe u kënduan nga të gjithë. Zanafilla e serenatave fillon nga vitet 1930 dhe vijon deri në ditët tona. Korçarët janë njerëz të ndjeshëm dhe me temperament. Natyra e bukur që u ka falur Perëndia, sigurisht ka ndikuar në krijimtarinë e tyre. Në serenatat e para korçare i këndohej me pathos natyrës, dëborës që zbardhi malet e fushën tatëpjetë etj.

Dëbora zbardhi maletë  
dhe fushën tatëpjetë;  
njerëzit më s'dalin  
dhe rruga është e shkretë.

Të thashë moj zyzezë  
se më s'këndon bilbili  
se gjethet zunë po bien-ë  
dhe po afrohet dimri.

Vargjet e kësaj kënge janë krijuar nga Asdreni, i cili me ndjenjë përshkruan natyrën dhe peisazhin dimëror të Korçës. Janë vargje shumë të bukura, me anën e së cilave tregohet që dëbora fillimisht zbardh malet dhe derdhet tatëpjetë mbi rrugët e shkreta të qytetit. Në këtë kohë vajza korçare qëndronte e mbyllur në shtëpi dhe qëndiste pajën. Në mendjen e saj fluturojnë lloj-lloj fantazish. Ajo krijon në qëndisimat e saj një mbretëri me lule, sytha, gonxhe dhe zogj. Gjithashtu ëndëron princin e kaltër, një djalë që nuk pi verën as rakinë, por të jetë djalë për shtëpinë.

Djemtë korçarë prisnin me padurim që të vinte stina e pranverës, që qyteti të gjallërohej dhe të shihnin çupkat.

Dua mëngjeset e majit  
Kur këndon bilbil i bukur  
Kur fryn erëza e malit  
Dhe qarku është i skuqur,  
Dhe lulet e fushësë  
Në mëngjes kur janë me vesë,  
Doçkat e bardha të çupësë  
Që vetë mali ti presë.

Mbrëmjeve, djemtë korçarë dilnin në bulevard për të shëtitur dhe ngacmuar çupkat. Këtë e thonë vargjet e këngës:

Bulevardi i Korçës,  
Ka vajza pa masë  
Që dalin e shëtisin,  
Pa lejen e mamasë.

Tek dyqani i Tasit-ë  
për karshi Mitropolisë  
dalin vajzat e skolisë  
nga sevda e dashurisë.

Mjaftonte vetëm një shikim ose një buzëqeshje dhe zemra e djalit ndizej zjarr, të cilin do të mund ta shuante vetëm tek burimi i çardhakut.

O burimi i çardhakut,  
sa i ftohtë që je ti,  
sa dhe djalit dje plakut,  
i fal jetë e kënaqësi.

Uji yt fort i kulluar,  
që buron si qelibar,  
edhe vjen duke kënduar,  
n'ato fusha plot me bar,  
në atë shesh, në atë lëndinë  
sa kënaqem që të rri.

Kënga "Burimi i Çardhakut" është kompozuar nga Jorgji Kroj, i cili ka qenë me origjinë nga Vithkuqi i Korçës. Jorgji u rrit duke luajtur në violinë, të cilën nuk e ndau për asnjë moment. Jorgji Kroj ka kompozuar disa këngë karakteristike korçare. Në natyrën e bukur mes karafilave dhe trëndafilave, djali i përvëlur nga dashuria fillonte të krijonte serenatën.

Perëndeshë e bukuris më je  
Un për ty moj do pëllesë,  
Dashurinë që kam shtënë për ty  
U bu bu si do të ngjasë.  
Ilaçet nuk më bëjnë derman,  
S'më shërojnë plagëtë,  
Përveç syrit tënd të zi  
Që më dogji zemrënë.

Në vijim merrte kitarën dhe shkonte poshtë ballkonit të vajzës për të kënduar serenatën. Më pas vinte andej nga Panda për të qerasur shoqërinë me birra korçe. Si kishin pirë disa birra, ftonin edhe kafexhiun dhe ia merrnin përsëri këngës.

S'kam ç'e dua pasurinë  
Po s'ma deshi zemra sot,  
Nuk e ble dot dashurinë,  
Me të holla s'blihet dot.

Korça është qyteti i serenatave. Brenda tyre fshihen shumë histori dashurie, suksese e dështime, për të mos thënë edhe ndonjë tragjedi.

Kush nuk këndoi njëherë një serenatë  
Kush nuk dashuroi njëherë me çmenduri  
Për të jeta është një mandat  
Është thjesht një epitaf i zi...

Kush më shumë e kush më pak, të gjithë korçarët i kanë kënduar serenatat. Ka momente në jetë që çdokush, kur i lind një dashuri e ndjen veten poet.

## **KREU I KATËRT**

### **FJALË TË URTA ME TEMATIKË FETARE**

Ai që nuk don babanë dhe nënën, ai nuk don askënd.  
Aman zot' i shën Kollë, sa të shkonj lumën.  
As të vdes, as të ngjall.  
Atë s' e qasin në fshat, kërkon shtëpin' e priftit.  
Ati i digjet mjekra, t'jatri thotë: dale të ndes çibuknë.  
Atje ku s' ka, s' merr as perëndia.  
Ata të mirë që t' ia bash fqinjës tenzone ia ban.  
Ato q' i ep dhaskali, do mësonjë djali.  
Ay korr atje ku s' ka mbiellë.  
Basti është i shejtanit.  
Bëji udhë djallitë.  
Bëni si them unë dhe mos bëni si bëj unë.  
Bënë të mirën edh' hidhe ndë det, se do t' të dalë ndë krypë.  
Borxhi i harruar, vjen në ditë të shtrënguar.  
Borxhi i vonë, gëzon të zonë.  
Bota thonë, po s' thot i zoti.  
Bylbyli njihet në këngë, njeriu në punë.  
Bukë e kryp në vatrën tanë.  
Burrat besojnë se bota është krijuar vetëm për ta.  
Burri një herë ka lindur dhe një herë do të vdesë.  
Butësia e bën njeriun gjithçka, përveç pasurisë.

Çdo që pillët, do të vdesë.  
 Çdo mizor e ka ditën e vet të gjykimit.  
 Çdo pesim është edhe mësim.  
 Çdo gabim i gruas së ndershme është i falur nga burri i saj.  
 Çka mbjell korr.  
 Ç' thot ay, mos thëntë perëndija.  
 Dashuria është kripa e jetës, jeta pa dashuri s'ka asnjë shije.  
 Dilni ju të vdekur, të hyjnë të gjallët.  
 Di perëndia se ç'bën.  
 Delen që ndahet nga tufa e ha ujku.  
 Dor'e thatë s'ka uratë.  
 Dua të shënjtëronj, po s'më le djalli.  
 Durimi është më e madhja trimëri.  
 Dhe për perëndinë, ta pyes, thotë e di.  
 E drejta, e vërteta.  
 E pa perëndia, pa e bëri.  
 E shtrëmbëra është e djallit.  
 Faji është i varfëre, se asnjëri s'i del për zot.  
 Feja vete nde fea.  
 Fjala vete tek i zoti.  
 Fjalë që në kohë të Noes.  
 Fshehtësia e bukurisë është modestia.  
 Fytyra e qeshur është kripa e bukurisë.  
 Gruaja ka perëndi burrën.  
 Gur mi gur mos mbetë.  
 Guri i rëndë peshon n'vend të vet.  
 Gjithë jemi të bijt e vdekjes.  
 Gjer nesër ka perëndija.  
 Gjeti kishë të falet.  
 Gjella me kripë e kripa me karar.  
 Gjë e falur qëndron shtrenjt.  
 Gjë pa zot nukë ka.  
 Ha bukën mos e përmbys kupën.

Hidhnim' i fort, dëm' i të zot.  
 I duruari, i fituari.  
 I gjalli me të gjallët.  
 I verbëti tërheq të verbëtin dhe të dytë rrëxohen në gropë  
 I vdekuri me të vdekurit.  
 I vdekuri nukë ngjallet.  
 Ja të lëna nga njerëzia, ja me thënë perëndia.  
 Ka aman' o zot, po edhe zot aman.  
 Ka pashkë, po ka dhe faskë.  
 Ka parë diellin më parë.  
 Ka perëndija, po ka dhe djem shumë.  
 Kemi gjallje, po kemi dhe vdekje.  
 Kërcen prifti nga belaja.  
 Këshill e të urtit, vlen më shumë se ari.  
 Ku kan' e s' t'apin, ku flet e s'dëgjojnë, perëndia të ruajtë.  
 Ku është dashuria, është vetë perëndia.  
 Ku manastiri, pa kallogjer sa të duash.  
 Ku nënk isht i zot, nënk isht inzot.  
 Kur desh të hipte çifuti u ndodh e shtunë.  
 Kur vndes i varfëri fenerë, del djalli ja shuan.  
 Kur nuk shef' i zoti, nukë shef as zoti.  
 Kur s'ke pishë në shtëpi, mos ndis qiri në xhami.  
 Kur të jep zoti miell, del djalli të mer thesnë.  
 Ku s'ka, s'merr as perëndija.  
 Kur s'kam faj, as perëndisë s'i trëmbem.  
 Kush bën mirë, huan perëndinë.  
 Kush gënjen, gënjen perëndinë.  
 Kush mban kreshmë, pret pashkë.  
 Kush s'flet të drejtën, e vret perëndija.  
 Kush lypën, gjen kodo.  
 Kush mëngoi, bloi.  
 Kush s'ka njeri, s'ka as perëndi.  
 Kush së do uratën, ka nënën.



Kush njef vetvetën, njef tëzonë  
 Kush me tënëzonë u pruar, kurr u sbuar.  
 Larg teje, e afër zotit.  
 Lisi i mirë njifet nga fryti.  
 Lot prifti nga belaja.  
 Lumi fle, armiku s'fle.  
 Marsi nga kreshmët s'ndahet.  
 Mban verë e pi ujë.  
 Mbulon balta baltënë.  
 Mbyll perëndija një derë, hap dy penxhere.  
 Mendimet e larta gjinden në fjalë të shkurtra.  
 Me atë masë që të matëni, me atë keni me kenë matun (Matheu)  
 Më mirë vdekje me nder se gjall' e pa nder.  
 Më mirë të dish, se të kesh.  
 Më parë del shpirti se huqi.  
 Miku i mirë shihet në ditë të vështira.  
 Mikut iu anëko, hasmit iu lëvdo.  
 Miqësia, miqësi qesja të shkojë e të vijë.  
 Mos më bëj të bënj kryq me këmbë.  
 Mos humb kohën.  
 Mos më keq o zot.  
 Nata në Shënëndre si motra e gruas ve.  
 Ndizi dhe djallit një qiri.  
 Nevoja mëson njerinë.  
 Në më gënjejsh një herë, qofsh i bekuar.  
 Nga ay q'i pëlqen vetja, perëndija të ruajt.  
 Nga budallaj perëndija të rrojtit.  
 Nga njeriu me cen, zoti të ruajtë.  
 Nga druri bëhet kryqi, bëhet dhe lopata.  
 Ngaha del fjala, del shpyrti.  
 Ngrehu o prift të rrijë hoxha!  
 Ngrihi o të vdekur, të hyjnë të gjallët!  
 Nom i ri në fshat të vjetër.

Njeri me kryq në ballë.  
 Njeriu është' i biri i vdekjes.  
 Njeriu mbëledh, e zotynë përdredh.  
 Njeriu sa të ketë, aqë i hyn djalli.  
 Njeriun e bëjnë të përhershëm veprat e tij.  
 Njerëzit e mirë janë të gjykuar të bëhën skllavër të të këqinjve.  
 Një her u fut prifti në thes.  
 Njëra dorë lan tietërën, të dyja lajënë faqetë.  
 Pagoj si prifti.  
 Paraja tradhëtoi Krishtin.  
 Perëndija bën shkallë.  
 Perëndija e faltë, mortja e martë.  
 Perëndija e shpëtoftë, mortja e mbuloftë.  
 Perëndija na ruajt nga njeriu me cen.  
 Perëndija na shpëtoftë nga cjapi shyt.  
 Perëndija njeriut i mer mëntë pa gjënë.  
 Perëndija shtie shinë në maj dhe thotë që ka faj.  
 Perëndia të shpëtoftë nga njeriu i papunëshëm.  
 Perëndia duron, po s'harron.  
 Posi leu ashtu vdes njeriu (Sipas Jobit, 21).  
 Po s'ke njeri, nuk ke as perëndi.  
 Po s'ndeze qiri, as kisha nuk të ndih.  
 Po të dëgjonte perëndija galat, behar s'vinte kurrë.  
 Prifti s'thirri për priftëreshën.  
 Puno si rrop, e shko si zot.  
 Puna e rrëfen njerinë.  
 Pyet shtat' a tetë e bën si di vetë.  
 Qesja nuk zbrazet duke dhënë lëmoshë.  
 Qysh ashtë gjykue s'ka me mungue.  
 Ruhë, të të ruanj perëndija.  
 Ruhë nga fëngjill' i mbuluarë.  
 Rrëketë bien përrenjt, perëndija përtpjetë.  
 Rrena i ka këmbët e shkurtra.

Sa rron, mëson.  
 Si shejtani nga temjani.  
 Si vendi dhe kuvendi.  
 S'është ngadita pashk' e bajram.  
 S'ndahet marsi nga kreshmët.  
 S'ka lumturi më të madhe në botë se dashuria dhe harmonia.  
 S'të lë dialli të bëjësh pashkë.  
 Syri është dritare e shpirtit.  
 Shpirti është i dhëmshurë.  
 Shumë lajnë duart, po pakë rrinë në tryezët.  
 Shokun mos e duaj, po hisen ia ruaj.  
 Trahana perçe naporë.  
 Temjanica i qan hallet.  
 Tinë zot, unë zot, lopëtë kush i kullot?  
 Tek është dashuria, është vetë perëndia.  
 Të ligun s'e nget as djalli.  
 Të luturit e shumë i vjen rëndë zotit.  
 Të luturit e shumë ngjan me angarinë.  
 Të vraftë mushk' e priftit.  
 Tjatër kërkon, tjatër t'ep perëndija.  
 Trimi i mirë, me shokë shumë.  
 Trimin vraje e mos e shaj.  
 Thoni si them unë.  
 Thuajmë ç'besë mbeson, të të them se si shkon.  
 Thuajmë si shkon, të të them se cili je.  
 Thua ti, po ç'thotë zoti.  
 Ujë për meshë.  
 Ushqen i kërshteri derrin, që ta hajë pashkëve.  
 Uthull e fortë, enën e sajë prish.  
 Veç tënëzonë e adhuroj.  
 Veç zotynë ashtë pa mëkat.  
 Vëllazëria, si shokëria.  
 Vdis, pa të dua.

Vjen nga zoti, po dhe nga qiramidhet.  
 Vdekja është i vetmi vend ku nuk ka ikje.  
 Vdekjen s'duhet me harrue, sepse sot mua nesër ty.  
 Yshqen derrë të hajë për pashkë.  
 Zot, zot, pa shërbëtor kurdoherë nuk bënesh.  
 Zuri perëndinë me dorë.

### BETIME

Më bëftë Zoti ulok.  
 Më marrtë Perëndia mendtë.  
 Më lëntë Zoti pa sy.  
 Më lëntë Zoti pa gojë.  
 Më verboftë Zoti.  
 M'u drithtë shpirti  
 Mbetsha kallogre.  
 Në këtë jetë dhe në atë jetë.  
 Për atë qiell.  
 Për kokën e të lartëve.  
 Për shpirtin e atij që kalbet në dhe.  
 Për Shën Koll.  
 Për dyzetë shenjtorët.  
 Për Shën Thanas.  
 Për besë.  
 Për atë kishë.  
 Për Zotin.  
 Për kungim.  
 Për shpirtin e babait.  
 Për Shën mërinë e Benjës.  
 Për Perëndi.  
 Për Zotin e vërtetë.  
 Për atë Krisht.  
 Për këtë baltë.

Për atë që besojmë.  
Për atë kryq.  
Për fjalën e nderit.  
U nissha kallogre.  
U tretsha si qiri.<sup>1</sup>

## DOGANÇJA

Gjuha dogançe lindi nga nevoja për komunikim të banorëve të krahinës së Malëshovës. Fillimisht përdorej prej kallajxhinjve dhe muratorëve malëshovitë, të cilët punonin nëpër fshatra të tjerë. Ata flisnin dogançe kur donin të bënin pazarin e punës, pa i marrë vesh të tjerët, për shembull “Bëj pazon me cimadhin dhe kapsi beshot” që do të thotë “bëj pazarin me këtë djaln dhe merri paratë”. Malëshovitët përdornin dogançen në raste rreziku, për t’u shpëtuar xhandarëve dhe grabitësve kur qenë duke udhëtuar. Dy vëllezër kallanxhinj Thanasi dhe Tole Gjikdhima qenë duke udhëtuar me mushkë nëpër pyllin e Sulovës. Tolja ecte përpara dhe Thanasi tërhiqte mushkën e ngarkuar me veglat e punës. Në mes të udhës u doli një xhandar dhe u kërkoi pasaportën dhe lejen e punës. Tolja u zu ngushtë, sepse nuk kishte leje pune dhe as pasaportën nuk e kishte me vete, prandaj për të dalë nga situata i thërret të vëllait: “Fillush! Mengresi xhandua më zegos lepushkën si të setis?” që do të thotë “Vëlla! Xhandari më kërkon lejen dhe letërnjoftimin, çfarë të bëj?” Vëllai ia ktheu përgjigjen: “ftoi lepushkën e derdos” që do të thotë “jepi pasaportën e mushkës”. Xhandarët në atë kohë qenë të pashkolluar dhe dy vëllezërit dolën nga situata duke i treguar pasaportën e mushkës. Banorët e krahinës së Malëshovës e përdornin dogançen edhe në këngët e tyre. Po

<sup>1</sup>-Niko Tyto, Disa frazeologji popullore, betime, Malëshova, nëntor 2010, faqe 6.

përmend disa vargje nga një këngë që titullohet *Jam një vajzë limarjote*:

Jam nga vendi i këngës labçe,  
Ku cimadhji flet dogançe,  
Ku cimadhja flet me nojma,  
Mbretëresha që të njoma.

Fjalë të gjuhës dogançe ka përdorur Çajupi dhe Noli. Ky i fundit në përkthimin e romanit “Don Kishoti i Mançës” shkruan: “është e kolme dhe rrumbullake”. Fjala “e kolme” ka kuptimin (e mirë). Dogançja përbëhet nga fjalë shqipe, por ka huazuar edhe shumë fjalë greke e sllave. Fjalët e kësaj gjuhe përdoren të lidhura me elemente të gjuhës shqipe si lidhëza, parafjalë etj. Nga greqishtja gjuha dogançe ka huazuar fjalët: potam-lumë, apono-lat, kato-poshtë, okso-jashtë, mesa-brenda, psalidhi-gërshëra, stoma-goja etj. Nga turqishtja ka huazuar fjalët: teftis-shpërthen, okno-kokëfortë, sybërdis-shporr, etj. Nga sllavishtja ka huazuar: gospo-zot, gospodar-zotëri, druzhavë-qeveri etj. Kallajxhinjtë malëshovitë qenë zanatçinj endacakë dhe si të tillë jetesa e tyre ishte shumë e vështirë. Për të siguruar punë ata udhëtonin shumë. Ata e quajtën veten mavrogunë. Për t’i përjetësuar në shekuj populli u ka thurrur vargje.

Mavrogunët vergje, vergje  
Ca me guna e ca me shergje  
Ku vini more të mjerë  
Që bridhni derë më derë.

Që në vogëli jam familjarizuar me gjuhën dogançe, sepse e flisnin gjyshja dhe gjyshi në shtëpi. Kur dikush vinte për vizitë gjyshi Koço i thoshte gjyshes: “na nxir pak thanuqe” thanuqe

në gjuhën dogançe i thonë rakisë. Ndonëse vetë di vetëm disa fjalë dogançe vendosa që ti botoj aq fjalë sa kam mbledhur në këtë libër me qëllim që kjo traditë tu përcillet brezave që do të vijjnë. Unë bëra aq sa munda dhe dikush tjetër duhet ta vazhdojë këtë punë.

### **SHPREHJE NGA GJUHA DOGANÇE**

- 1-Ja pëlçet nga vakra – është nga krahina jonë
- 2-Kokodhori ka fryjtur në pazo – burri ka ikur në pazar
- 3-Do fryj të xogos vardje – do iki të kërkoj punë
- 4-Fryjti tek mengresi allo – iku tek personi tjetër
- 5-Ja pllati mëngresi kucet – i pagoi ai paratë
- 6-Ku ia pëlçet me togza – ku e ke mendjen
- 7-Ku e rrucove panxhen – ku e preve dorën
- 8-Me mëngrecet do të vardisin – me këta do të punojmë
- 9-Hiqi torte se ja pëlçet këmbës – meri shumë se është i pasur
- 10-Drish, sheros dhe mërxe – ha, pi dhe rri
- 11-Ftoji duno të sherosë – jepi ujë të pijë
- 12-Do dredhim persho me marko – do hamë përshesh me kos
- 13-Do dredhim persho me mbleko – do hamë përshesh me qumësht
- 14-Do dredhim balo – do hamë mish
- 15-Çitisi bragjon në rrabe – bëri m..... në kokë
- 16-Rrabe e bëjshme – kokë e madhe
- 17-Kuspullo togza – mblidhi mëntë
- 18-Ma citisi horoqen – ma bëri qejfin
- 19-Ma ckerdhi horoqen – ma prishi qejfin
- 20-Mos qezero me kokacen – mos qesh me ustanë
- 21-Më vaptize me atë rokanë – më mërzite me atë fjalë
- 22-Ku ja pëlçet dhosko i kolm – ky është mësues i mirë
- 23-Nga do fryjmë avrio – nga do vemi nesër

- 24-Nuk e logos cimadhin – nuk e shoh djalin
- 25-Vardis si privo – puno si privat
- 26-Forfolina një mboqes – piqja një misër
- 27-Cota e citisi pemojken – pula e bëri vezën
- 28-Ajo prokje nuk ia pëlçet kokodhor – ajo grua nuk ka burrë
- 29-Ja pëlçet prokje e kolme – është grua e mirë
- 30-Ja pëlçet këmbës – është i pasur
- 31-Ja pëlçet i coteruar – është i çmendur
- 32-E rrucoi tokthin – e therri kecin
- 33-Ky ia pëlçet duno me mirizje – ky është ujë me erë
- 34-Ti mos na dyshkosin – të mos na ikin
- 35-Pse më lidhose – pse më gënjen
- 36-Nga ja pëlçet more fillo – nga je more mik
- 37-Mingrecit i cfilloi prokja – atij i lindi gruaja
- 38-Merxefi rrokonet dhe vardis – leri llafet dhe puno
- 39-Fillushka ia pëlçet edhe – motra është këtu
- 40-Sherosim nga një shkrume – pimë nga një kafe
- 41-Sherosim nga një thanuqe – pimë nga një raki
- 42-Ç'ia pëlçet kjo vordje – ç'është kjo punë
- 43-Ja pëlçasim bero – kemi bajram
- 44-Ja pëlçasin kukulet – kemi pashkët
- 45-Vardje me stonja – punë me zor
- 46-Strungati kol – numëroi mirë
- 47-Ofone ushtri – officer në ushtri
- 48-Me tyte në ziges – me pushkë në krah
- 49-Qiroje në telo – merre në telefon
- 50-Qerro binen – merre gjysmën
- 51-Dredhim xherren – hamë drekën
- 52-Anikse defton – hape fletoren
- 53-Citisi rokane – bëri fjalë
- 54-I mirisi stoma – i mban erë goja
- 55-I xhveshe torten – i hoqe fundin
- 56-Fryjnë në vardje – shkojmë në punë

57-Ja pëlcat kolm – jam mirë  
 58-Ftoi panxhen – jepi dorën  
 59-Ai nomat të aniks cacliqin – ai njeri të hap barkun  
 60-Kokodhori s'ia pëlçet edhe – burri nuk është këtu  
 61-Citisna një shapkor – bëna një byrek  
 62-Cimadhi të camos – djali të vjedh  
 63-U ndez tryeza – filloi lufta  
 64-E rruc dogancen – e di dogançen  
 65-Do fryj akso – di iki jashtë  
 67-Ngrecoi dhe logosi vordjen – erdhi dhe pa punën  
 68-Ngrequan myshtat – erdhën myshterinjtë  
 69-Vezhapse kol – dëgjoje mirë  
 70-Turri kucet mesa – futi paratë brënda  
 71-Ngreco kato – hajde poshtë  
 72-Citisi horoqen – bënq qejfin  
 73-Fry në mojdë se do të qapojnë - shko në shtëpi se do të kapin  
 74-Bëj pazon me cimadhin dhe kapsi beshot - bëj pazarin me këtë dhe merri paratë.  
 75-Ngreco për xhërr të dredhim e të sherosim-eja për darkë të hamë e të pimë.  
 76-gjonthi ja pëlçet e kolme si dhe manxha-buka është e mirë, si edhe gjella.  
 77-Kush vardis kol dredh e sheros kol-kush punon mirë, ha e pi mirë.  
 78-Citisi i kolm që të zegosin dhe jot ë lypin-bëhu i mirë që të mos të vrasin.  
 79-Mos qezëro se të legosin nomatët-mos qesh se të shohin njerëzit.  
 80-Zgjesa ja pëlçet e kolme-vajza është e mirë.  
 81-Mërze e mos rois së të vezhepsin nomatët-rrri mos fol se të dëgjojnë njerëzit.  
 82-Fillushi dushkat për vardie-vëllai iku për punë.

83-Lidhja e ka shkeljet të cimërta-gënjeshtra i ka këmbët e shkurtëra.  
 84-Fillushka rrethohet me një cimadh të kolm-morta marrohet me një djalë të mirë.  
 85-Vardie e bejshme dredh nomatin-puna e shumtë ha njeriun.  
 86-Majkusha ka pikasur shidhe-nëna ka vdekur e moshuar.  
 87-Zgjesa ime ja pëlçet dy cimëdhënj-vajza ime ka dy djem.  
 88-Fillushi majkushit vardis mbathjaxhi-vëllai i babait punon këpucar.  
 89-Zegosni gospon që tu zegosi ai-kërkoni Zotin që tu kërkojë dhe ai.  
 90-Më kol zegos se camos-më mirë kërk se sa të vjedhësh.  
 91-Guzhua i kolm ja pëlçet më e kolme se bozilit-guzhinieri i mirë duket kur bën gjellë të mirë.  
 92-Në zhërr ja pëlçasim kuspullim-në darkë këmi mbledhje  
**S**hën Nikolla (+280) ka lindur në Azinë e Vogël dhe ishte episkop i Mirës. Shën Nikolla ka hyrë në botën e fëmijëve evropianë si njeriu (Santa Claus) që sjell dhuratat e Vitit të Ri. Në Gjermani atë e quajnë Veinachtsman që do të thotë Njeriu i Krishtlindjeve. Në Francë quhet Pere Noel (Babai i Krishtlindjeve). Në Angli njihet me emrin Father Christmas (Babai i Krishtlindjeve), ndërsa në Hollandë e quajnë Santa Claus. Tradita thotë se njëherë Shën Nikolla ishte duke udhëtuar nga Mira për në Hollandë. Ai kishte veshur rrobën e kuqe të episkopit, duke ngarë një kalë të bardhë dhe i shoqëruar nga shërbëtori i tij Black Bart. Gjatë udhëtimit mbante një thes plot me dhurata të ndryshme. Sapo shihte fëmijë, ndalte kalin, fuste dorën në thes dhe u jepte dhurata. Në udhëtim e sipër duke u gdhirë mëngjesi, ata panë një kasolle, e cila nuk kishte dritare dhe dyert qenë të mbyllura. Shën Nikolla pyeti shoqëruesin e tij: -Si do t’ua shpërndajmë dhuratat fëmijëve? Barti propozoi që dhuratat t’i hidhnin nga oxhaku. Ata hipën në çatinë e kasolles dhe i hodhën dhuratat në oxhak. Mrekullisht dhuratat ranë në çorapet e fëmijëve, që kishin vënë për t’u tharë. Që nga ajo kohë në traditën e popujve lindi një zakon i ri. Në ditën e

Krishtlindjeve fëmijët blejnë çorape të mëdha dhe i varin ato në oxhak me shpresë që natën do të vijë Santa Claus dhe do t'ua hedhi dhuratat. Shën Nikolla ose Santa Claus është shenjt i dashur për fëmijët, gjithashtu ai është mbrojtës i detarëve, udhëtarëve dhe endacakëve.<sup>1</sup>

## **BREDHI I KRISHTLINDJEVE**

Zakonisht nëpër shtëpi fëmijët përgatisin Bredhin e Krishtlindjeve, historinë e të cilit po ua tregoj. Bredhi i Krishtlindjeve e ka origjinën që nga viti 722, atëherë kur Shën Bonifaci u dorëzua episkop dhe filloi punën misionare në rajonin e Hesëve. Sapo mbërriti atje, Bonifaci urdhëroi që të pritej një lis i madh që konsiderohej i shenjtë, kushtuar perëndisë pagane Donar (perëndia i rrufesë). Me lëndën e atij lisi ai ndërtoi një kishë. Ky ishte një hap vendimtar në kristianizimin e hesëve. Tradita thotë se pikërisht mbi trungun e lisit mbiu një bredh. (Bredhi është simboli i përjetësisë) Meqenëse ishte periudhë Krishtlindjesh njerëzit e zbukuruan bredhin dhe vendosën pranë tij të gjitha dhuratat. Që nga ajo kohë bredhi i zbukuroi hyri në traditën e popujve si simbol i Krishtlindjeve. Ky bredh mbahej i ngritur deri në të kremten e Ujit të Bekuar.

## **LEGJENDA E MOLLËS SË KRISHTLINDJES**

Na ishte njëherë një prodhues i vogël orësh në Gjermani që quhej Herman Jozef. Ai jetonte në një dhomë të vogël me stolin, shtratin, veglat dhe tryezën e tij të punës. Dhe kuptohet që edhe orët e tij, me qindra orë të bukura, më të mirat et ë cilave ai i nxirrte në vitrinë. Njerëzit që kalonin andej, ndalonin,

<sup>1</sup>-Kampingu dimëror i vajzave, Historia e Shën Nikollës, Krishtlindje 2001, faqe 35-37.

shikonin dhe thoshin: “Herman Jozefi ka bërë një orë të re, por akoma nuk është më e mira e tij”.

Prodhuesit të orëve i kishte dalë kurrizi dhe këmbët i kishte të shtrembëra, por në fytyrë kishte një shprehje të dashur dhe fëmijët e qytetit e donin shumë. Sa herë që atyre u prishej ndonjë lodër, ia sillnin Hermanit dhe ky i fundit ua riparonte. Këtë punë e kryente falas dhe i porosiste fëmijët që paratë ti ruanin për ditën e Krishtlindjeve.

Në këtë ditë të shënuar ekzistonte një traditë e lashtë, që njerëzit blinin dhuratat më të shtrenjta dhe i vendosnin përpara slulprturës së Shën Mërisë me Krishtin në krahë, e cila gjendej në katedralen e qytetit. Sipas legjendës së lashtë, kur një dhuratë përmbante shumë dashuri, Krishti foshnjë zbriste nga krahët e Marisë dhe e merrte atë. Sigurisht kjo ishte vetëm një legjendë dhe askush nuk mbante mend që të kishte ndodhur ndonjëherë. Poetët kishin shkruar vargje të shumta për dhuratën e dashur të foshnjës. Njerëzit kursenin para gjatë gjithë vitit për të blerë një dhuratë të pëlqyer. Kur në këmbët e statujës vendosej ndonjë dhuratë e mrekullueshme, në rradhët e besimtarëve të pranishëm në kishë dëgjoheshin pëshpëritje dhe prisnin me padurim të shikonin mrekullinë.

Hermanit i erdhi një ide e mrekullueshme që të bënte një orë më skenën e Lindjes së Krishtit, në të cilën të paraqiste nënën e Shenjtë duke u gjuhëzuar pranë grazhdit. Në skenë përfshiheshin dijetarët, barinjët dhe engjëjt. Kur binte ora, të gjithë personazhet i gjuhëzoheshin foshnjës hyjnore dhe kordat e argjenda luanin melodinë “Madhështimi”. Hermani këtë orë e kishte bërë me shumë dashuri. Ai shpesh shkonte për të fjetur pa ngrënë darkë. Pasi e përfundoi, orën e vendosi në vitrinë dhe të gjithë njerëzit pyesnin: “Kjo është vallë dhurata që Hermani do të dhurojë për Krishtlindje?”

Në vigjilje të Krishtlindjeve, Hermani pasi e kishte siguruar dhuratën, i ofroi lëmoshë një lypësi të verbër dhe për

vete mbajti vetëm një qindarkë. Me monedhën bleu një mollë, që ta hante në ditën e Krishtlindjeve. Pasi u pastrua, veshi rrobat më të mira që kishte dhe u nis për në kishë. Udhës takoi Tradin e vogël, i cili qante me ngashërim sepse kishte babanë sëmurë. Tradi i tha se të gjitha paratë që kishte grumbulluar për të blerë lodra, ëmbëlsira dhe pemën i kishte shpenzuar për të paguar mjekun. Hermani i premtoi që do të shiste një nga orët e tij për ta ndihmuar me të holla.

Ai shkoi tek njeriu më i pasur i qytetit dhe ju lut që t'i lente njerën prej orëve që kishte ekspozuar në vitrinë. Plaku i pasur i kërkoi orën që kishte nxjerrë në vitrinë ditën e fundit. Hermani u shtang, por nuk kishte si të vepronte ndryshe. Pasi e shiti dhuratën e shtrenjtë, paratë ia dha Tradit të vogël, që t'i përdorte për festën e Krishtlindjeve. U përgatit për të shkuar në kishë, por dhuratën e kishte shitur. Në atë moment iu kujtua molla e vetme që kishte dhe vendosi që t'ia shpinte Krishtit fëmijë.

Kisha ishte e mbushur plot me njerëz, të cilët ofronin dhuratat më të bukura. Kur erdhi rradha e prodhuesit të orëve, të gjithë u befasuan. Pëshpërimat sa vinin dhe shtoheshin: - Turp, ai duhej të binte orën e tij. Po, po sa turp. Hermani dëgjonte pëshpëritjet dhe uli kokën. Rruga po i dukej e pafund, ndonëse edhe shtatë shkallë e ndanin për të mbërritur tek altari. A do të gjente forca për tu ngjitur deri atje? Filloi të numëronte shkallët, një, dy tre, katër, pesë, gjashtë... I kishte mbeur vetëm një shkallë, kur papritmas përshpëritjet ndaluan dhe u dëgjua një thirrje. Mrekulli. Njerëzit në katedrale u gjunjëzuan. Peshkopi ngriti duart lart në lutje. Hermani kishte mbetur i shtangur tek shkalla e fundit dhe pa Krishtin duke u shkëputur nga krahët e Marisë duke ardhur drejt tij për të marrë dhuratën.

## VASILOPITA OSE MESHA E SHËN VASILIT

Më një janar kremton Shën Vasili, i cili është shenjt i dashur për fëmijët, sepse ju bie dhurata të shumta. Më datën 31 dhjetor njerëzit blejnë një vasilopitë, e cila ka brenda një monedhë. Sipas zakonisht, në mesnatë atëherë kur viti i vjetër ia len vendin vitit të ri, kryetari i shtëpisë ndan vasilopitën (meshën e Shën Vasilit) dhe shpërndan pjesët tek anëtarët e familjes. Atij që i bie monedha do të jetë njeriu më me fat i vitit. Tradita e përgatitjes së vasilopitës e ka origjinën në kohën e lashtë bizantine. Thonë se perandoria bizantine ishte në rrezik të pushtohet dhe arka e shtetit ishte e zbrazët. Dikush dha mendimin që të grumbulloshesin thesarët e popullit, pra çdo gjë të shtrenjtë që kishin. Njerëzit filluan të sillnin, vëthë floriri, unaza me gurë të çmuar si dhe sende me vlerë që kishin. Pasi u grumbullua i gjithë thesari u bë gati për t'u shitur dhe me paratë e fituara do të përgatitej ushtria dhe flota. Në atë kohë ndodhi mrekullia. Një furtunë e madhe i mbyti anijet armike në det dhe ata që mbetën u larguan me turp. Kështu thesari që grumbulluan njerëzit duhej shpërndarë përsëri, por nuk koha nuk u kishte mjaftuar që të mbanin shënim se çfarë kishte ofruar njeri apo tjetri. Në këtë kohë Shën Vasili dha mendimin që të përgatiteshin meshë dhe brenda tyre të hidheshin sendet me vlerë. Këto pasi u prenë në copa, iu shpërndanë besimtarëve nëpër kisha. Përsëri ndodhi mrekullia. Secili mori atë që kishte ofruar. Për ta përjetësuar këtë ngjarje ndër shekuj, që nga ajo kohë filloi tradita e përgatitjes së meshës së Shën Vasilit ose siç quhet ndryshe e vasilopitës.

### **VIRGJËRESHA SOT PO VJEN**

Virgjëresha sot po vjen,  
Në Betlehem për të lindur,  
Fjalën e përjetëshme,  
Brenda në shpellë së fshehti,  
Vallëzo, e tërë bota duke dëgjuar  
Lavdëro, bashkë me engjejt e me barinjtë,  
Perëndinë e amëshuar,  
Që desh të shfaqet, si djal' i ri përmbi dhe.

### **JA KRISHTI LIND LAVDËROJENI**

Ja Krishti lind lavdërojeni,  
Ja Krisht' i qiellit vjen dilni priteni,  
Ja Krishti mbi dhenë ngrehuni,  
Zotin pra e këndonin lart e mbi dhe,  
Dhe me ngazëllime,  
Përhimnojeni me mall,  
Popuj dhe me lavdi.

Mister të çuditshëm,  
Shikoj dhe s' e marr dot vesh,  
Se si në qiell një shpellë ndrin,  
Fron kerubik u shfaq Virgjëresha,  
Dhe grazhdi i vogël,  
E nxuri atë që bota nuk e nxë,  
Krishtin Perëndinë e madhështojmë,  
Pra me këngë sot.

### **VIRGJËRESHA LINDI SOT**

Virgjëresha lindi sot  
Të përmiqënëshmen Fjalë,  
Edhe dheu i blaton  
Të paafruarit shpellën,  
Engjëjtë me barinjtë po lavdërojnë,  
Magët pra, bashkë me yllin po udhëtojnë  
Se për ne ka lindur Krishti,  
Si djalë foshnjë i parëjetëshmi Zot.

### **LINDJA JOTE**

Lindja jote o Krisht Perëndia e jonë,  
I dhuroi botës dritën e diturisë,  
Se me të ata që adhuronin yjet,  
Prej yllit mësoheshin,  
Që të falen Ty, diellit të drejtësisë  
Dhe të të njohin si lindjen që lartazi  
O Zot, lavdi më Ty.

### **QYTET I VOGËL BETLEHEM**

Qytet i vogël, Betlehem.  
Sa shumë i heshtur je!  
Yjet të qetë ndriçojnë nga qiejt  
Mbi ty gjersa ti fle.  
Në rrug' t e tua të err' ta  
Një dritë e re u gdhi.  
Se shpresa e gjithë njerëzve  
Ka lindur sot tek ti.

O yje të mengjezit.  
T'këndojmë me ju dhe ne.  
Lavdi në qiell Atij që sjell  
Pajtim gjithë njerëzve.  
U lind nga një virgjëreshë  
K'të natë Zoti vet'  
Me ç'farë habi këtë çudi  
E v'renin engjëjt krejt.

Ashtu si erdhi qetë Ai.  
Atë natë në Betlehem,  
Dhe kjo dhuratë që zbret nga lart,  
Tek zemrat tona vjen.  
Askush nuk e dëgjon dot  
Por në k'të bot plot faj  
Fajtorët i pranon tani  
Që kthehen prap tek Ai.

O Djal' i Shenjtë, o Djal' Hyjnor,  
Zbrit poshtë në vatrën tonë.  
Çdo faj dëbo, çdo gjë ndrysho.  
Që t'rrosh tek ne gjithmonë.  
Me g'zim at'lajm dëgjuam,  
Që engjëjt na kanë sjellë  
Na u zbulu, tek ne bano,  
O Zot Emanuel!

## ENGJËJT DUKE FLUTURUAR

Engjëjt duke fluturuar, natën lart përmbi kët' botë,  
Sonte shpallin shumë' t'gëzuar, lindjen e Jisuit Zot.

Ejani adhurojeni Mbretin e porsalindur sot.  
Ejani adhurojeni Mbretin e porsalindur sot.

O dëgjoni ju barinj, të thjesht' kët'lajm prej engjëjve,  
Rron ndër ne sot Perëndia, si një foshnjë plot hare.

Ejani adhurojeni Mbretin e porsalindur sot.  
Ejani adhurojeni Mbretin e porsalindur sot.

Sonte engjëjt prej së larti, v'rejn me frik edhe me shpresë,  
Zoti papandehurazi shpejt në tempull do të zbresë.

Ejani adhurojeni Mbretin e porsalindur sot.  
Ejani adhurojeni Mbretin e porsalindur sot.

## NATË E SHENJTË

Natë e shenjtë! Natë e qetë!  
Janë në gjumë njer'zit krejt.  
Vetëm Josefi dhe Maria  
Janë të zgjuar me të shenjtin fëmijë.  
Fli me paqen qiellor!  
Fli me paqen qiellor!

Natë e shenjtë! Natë e qetë!  
Ç' dashuri! Zoti vetë.  
Si një foshnje na u zbulua  
Plot hare për të na shpëtuar.  
Ja Jisui u lind.  
Ja Jisui u lind.

Natë e shenjtë! Natë e qetë!  
Ca barinj me të shpejt,  
Lajmet e engjëjve i dëgjuan,  
Edhe në Betlehem vrapuan.  
Shpëtimtari u lind!  
Shpëtimtari u lind!

## NË LASHTËSI NË BETLEHEM

Në lashtësi në Betlehem,  
siç në Bibël është shkruar,  
Djali i Marisë tek  
Krishtlindjet na u arua.

Ja këndoj' gjithë engjëjt sot,  
u lind një Mbret i ri.  
ka shpresë për shkak t' Krishtlindjeve  
që sot për çdo njeri.

Bien borit engjëjt këndojnë,  
dëgjo se ç'ka rrëfej'  
Jisui lindi q' njerëzit  
një jet të re të ken.

Ndodhi që në një vend të thjesht,  
në një stallë të shkretuar,  
lindi atë nat' Maria,  
Fëmijn' e saj të bekuar.



## HISTORI DHE KËNGË PASHKE

### VEZËT E KUQE

Të Enjten e Madhe në darkë, zonjat e shtëpisë lyenin vezët e kuqe të Pashkës. Tradita e ngjyerjes së vezëve me bojë të kuqe për Pashkë e ka zanafillën që nga vitet apostolike. Menjëherë pas ngjalljes së Krishtit, njera nga gratë miropuruese Maria Magdalena vajti tek Pilati që ta njoftonte se Krishti u ngjall. Ajo i shpuri si dhuratë një shportë me vezë. Pilati nuk e besoi që Krishti ishte ngjallur dhe iu përgjigj duke thënë: “Sa mund të bëhen të kuqe këto vezë, aq mundet që Krishti të jetë ngjallur me të vërtetë”. Si për çudinë e Pilatit, pas pak çastesh vezët qenë bërë të kuqe. Pikërisht që nga ajo kohë ngeli tradita e lyerjes së vezëve me bojë të kuqe për Pashkë. Në ditën e ngjalljes së Krishtit të krishterët i çukisin vezët duke thënë: “Krishti u Ngjall”, “Me të vërtetë u Ngjall”. Zgjedhja e vezës si simbol i Pashkës është edhe për një arrësyje tjetër sepse ajo është simboli i jetës. Ashtu si zogu qëndron brenda lëvozhgës dhe kur vjen momenti e shpërthen atë, kështu edhe Krishti qëndroi tre ditë në varr dhe më pas i shkatërroi vargonjtë e vdekjes duke u ngjallur, për të vërtetuar se është Perëndi i vërtetë. Vezët lyhen me bojë të kuqe me qëllim që të na kujtojnë gjakun e Krishtit, i cili u sakrifikua për shpëtimin e njerëzimit.

### TRADITA E PASHKËS NË KOMUNËN E QANËS

Një herë, kështu na e ka trëguar nana, në Qanë për Pashkë bëjnë shumë gjëra të bukura: ëmbëlsira, bukën e bardhë, pastrojnë shumë mirë shpinë dhe veshëjin mbrojtat e reja e dilëjin në rrugën e re të shkojnë motin me shokë e me gjëri e të bëjnë

urime njeri me tjetrin duke u puthur. Fushat edhe si nani mbjohëshin me bar të gjelbër, molla, riqëja, dardha dhe gjërshia lulëzojin. Sa e bukurë ishë jeta kur Krishti ngjallej! Sa kumborët tingëllojin haren e Pashkës, gjithë ganjunt me macë me lule shprijëshin për rrugat e katundit, trokisëjin në diert e miqve duke thënë:

Lule, lule sa ka kjo lule  
Aq tumen me kukule  
Aq grur dhe aq mel  
Sa dishëroni në këtë shpi.

Zonjat e shpis mirrëjin lulen dhe e vëjin në ëndin e derës, dhe i jipëjinë ganjurëve kuleçez, vezë edhe të holla. Gjithë diertë ishinë një pamie shumë e bukurë. Qëndrojnë pa lulëzuar veç diert e atyre ç’kushin lipin. Edhe sot ndonjë dial vete me lule prënë katund të dielën e Pashkës, po shumë shpi jan të mbullitura, shumë gjithoni jan të mbrazta, përse varfëria na ka shprishur miq e gjëri mbi këtë botë për një cik bukë: kështu edhe Pashka arbëreshe ka bjerë ngjyrat e saja!<sup>2</sup>

### PO VJEN PASHKA

Po vjen Pashka, po vjen Pashka  
lajmëron ajrin me gëzim,  
Po vjen Pashka, Po vjen Pashka  
pas i shkon dhe shpirti im.  
Erdhi Pashka, u tha loti,  
erdhi Pashka, u ngjall Zoti.

<sup>2</sup>-Këtë rrëfenjë ia kanë trëguar më të rriturit nxënëses së klasës së katërt të shkollës së Qanës, Riccioppo Anna. Kjo e ka botuar në librin Sperimentazione didattica in un ambiente bilingue arbëresh, Università degli studi Calabria, Calabria 1980, pagina 89-90.

Po vjen Pashka, po vjen Pashka  
lulet çelin, gjethet dalin,  
Po vjen Pashka, Po vjen Pashka  
shpirtin tim me vete marrin.  
Erdhi Pashka, u tha loti,  
erdhi Pashka, u ngjall Zoti.

Po vjen Pashka, po vjen Pashka  
qielli dheu ngazëllen,  
Po vjen Pashka, Po vjen Pashka  
shpirti im me ta dëfren.  
Erdhi Pashka, u tha loti,  
erdhi Pashka, u ngjall Zoti.

Po vjen Pashka, po vjen Pashka  
jehojn' fjalët si këmban',  
Po vjen Pashka, Po vjen Pashka  
nga gëzimi shpirti qan.  
Erdhi Pashka, u tha loti,  
erdhi Pashka, u ngjall Zoti.

Po vjen Pashka, po vjen Pashka  
dimri i egët s'ka më kthim,  
Po vjen Pashka, Po vjen Pashka  
gjith' natyra thotë: "Amin".  
Erdhi Pashka, u tha loti,  
erdhi Pashka, u ngjall Zoti.

## U NGJALL KRISHTI

Mos qani o njerëz, ju gra mos vajtoni,  
Krishti është mes jush prandaj këndoni.  
Ai është drita edhe përdëllimi  
hapni zemrat tuaja, frikë prej tij mos kini.

Këndoni, këndoni, këndo me zë të lartë,  
u ngjall Krishti drita jonë e zjarrtë,  
këndni ju kombe, këndoni me gëzim,  
Ai u kthye nga rruga pa kthim.

Hosana thërrisni fort,  
ju po shihni atë që lat me lot,  
shikojeni Zotin në qiell po rri,  
dhe thërrisni lavdi o Perëndi.

## DJEMTË E GALILESË

Djemtë e Galilesë, o Krisht sa të deshën,  
edhe ty të shoqëronin, anëve të detit. (2x)  
Për ty o Mbret i botës, për fjalën tënde të vërtetë,  
braktisën varkat edhe rrjetat anëve të detit. (2x)  
Fytyra jote qiellndritur, edhe fjalët Hyjnore,  
derdhnin dritë dhe pavdekësinë, zemrave të dlira. (2x)  
Për ty o Mbret i botës, për fjalën tënde të vërtetë,  
braktisën varkat edhe rrjetat anëve të detit. (2x)

## KISHËZA

Atje lart në një mal, ndodhet Kish' e mjeruar,  
kamban' e saj s'po gjemon, se nuk ka prift as edhe psalt. (2x)  
Një kandil i ndrit dobët, dhe një kryq prej guri,  
ka si stoli të vetme, kjo kishëza e varfër. (2x)  
Por kalimtari si kalon, drejt qëndron dhe i falet,  
edhe me shumë shprestari, kryqin e saj të bardhë puth. (2x)  
Atje lart në kryqin e saj, ikon' mistike është atje,  
me gjak e shkrove o Perëndi, të adhuron gjithë populli. (2x)

## ZOGU

Në një degë të dendur lisi,  
rri një zog dhe cicëron,  
Nga kjo këngë kaq e bukur,  
një fëmijë po afron. (2x)  
O zog kënga jote, më pëlqeu shumë,  
bukur shumë e ke kënduar,  
Një këndim kaq mjeshtëror të lartë,  
kush vallë muzikën tya ta ka mësuar. (2x)  
O djalë i vogël pa dëgjomë,  
këtë këngë ma ka mësuar,  
Me një kujdes atëror të tij,  
Ai që botën ka krijuar. (2x)

## VRESHTI

Një luftë është gjithë jeta jote,  
bëhu punëtor i mirë,  
Që yë çrrënjosësh edhe të mbjellësh,  
këtë vresht të shpirtit tënd.

Vreshti, vreshti, vreshti i vërtetë,  
mësuam ç' do të thotë.  
Në prehër të ngrohtë të Kishës sonë,  
me të vërtetë jetojmë.

Qëndro ti pranë më të mëdhenjve,  
ti punëtor i mirë.  
Se nga përvoja e Kishës sonë,  
shumë fryte do të shijosh.

Fryte të bukura arrin të marë,  
shpirti me Perëndinë.  
Hardhi të cilat pranoi të ushqejë,  
verë e vreshtarit të mirë.

## ZONJË VIRGJËRESHË E KULLUAR

O Zonjë Virgjëreshë e kulluar  
Hyjlindëse e Panjollëshme.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.  
O Virgjëreshë nënë mbretëreshë  
dhe shumë e lavdishme.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.  
O më e larta se qiejtë,  
o më e ndriçme se rrezet.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.  
O gëzim i valleve virgjërore,  
o më e larta se Engjëjt.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.  
O më e ndriçme se qiejtë,  
o më e pastër se drita.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.  
O më e shenjta se të gjitha  
ushtritë qiellore.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.

Mari gjithmonë e virgjër,  
o zonjë e gjithë botës.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.  
O nuse e gjithëshenjtë  
dhe gjithë e kulluar.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.  
Mari je nuse mbretëreshë,  
shkak i gëzimit tonë.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.  
O vajz' e hijëshme mbretëreshë,  
o Nënë e gjithëshenjtë.

Gëzohu o nuse e panusëruar.  
O më e nderuar se keruvimet,  
o më e lavdëruar.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.  
Se Serafimet e pastër,  
dhe më e larta se fronet.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.

Gëzohu kënga e Keruvimeve,  
gëzohu himn' i Engjëjve.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.  
Gëzohu kënga e Serafimeve,  
gëzim i Kryeëngjëjve.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.  
Gëzohu paqe dhe gëzim,  
limani i shpëtimit.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.  
Nusërore e shenjtë e Fjalës,  
lule e mosprishjes.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.  
Gëzohu Parajs' e dëfrimit,  
e jetës së përjetëshme.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.  
Gëzohu drur' i jëtës,  
burim i pavdeksisë.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.

Të lutemi o Zonjë,  
tani të lavdërojmë.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.  
Të falemi mbretëreshë,  
mëshirë të kërkojmë.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.

O vajzë e hijëshme dhe e pastër,  
zonjë e gjithëshenjtë.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.  
Ty të lutemi nxehtësisht,  
o tempull i shenjtëruar.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.  
Përkrahmë dhe shpëtomë,  
nga veprat kundërshtare.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.  
Dhe trashëgimtar tregomë,  
të jetës së përsos ur.  
Gëzohu o nuse e panusëruar.

### LAVDËRONI ZOTIN

Lavdëroni Zotin se është i mirë, Aliluja.  
Se përdëllimi i atij është për gjithë jetën, Aliluja.  
Lavdëroni Perëndinë e perëndive, Aliluja.  
Se përdëllimi i atij është për gjithë jetën, Aliluja.  
Lavdëroni Zotin e zotërve, Aliluja.  
Se përdëllimi i atij është për gjithë jetën, Aliluja.  
Të vetmin që bëri mrekulli të mëdha, Aliluja.  
Se përdëllimi i atij është për gjithë jetën, Aliluja.  
Atë që me urtësi bëri qiejt, Aliluja.  
Se përdëllimi i atij është për gjithë jetën, Aliluja.  
Atë që bëri ndriçuesit e mëdhen, Aliluja.  
Se përdëllimi i atij është për gjithë jetën, Aliluja.  
Diellim për të zotëruar ditën, Aliluja.  
Se përdëllimi i atij është për gjithë jetën, Aliluja.  
Hënën dhe yjet për të zotëruar natën, Aliluja.  
Se përdëllimi i atij është për gjithë jetën, Aliluja.  
Atë që goditi Egjiptin në të parëlindurit e tyre, Aliluja.

Se përdëllimi i atij është për gjithë jetën, Aliluja.  
Dhe që nxorri Izraelin nga mesi i tyre, Aliluja.  
Se përdëllimi i atij është për gjithë jetën, Aliluja.  
Me dorë të fuqishme e me krah të shtrirë, Aliluja.  
Se përdëllimi i atij është për gjithë jetën, Aliluja.  
Atë që ndau Detin e Kuq më dysh, Aliluja.  
Se përdëllimi i atij është për gjithë jetën, Aliluja.  
Dhe kaloi Izraelin përmes tij, Aliluja.  
Se përdëllimi i atij është për gjithë jetën, Aliluja.  
Dhe mbyti faraonin dhe ushtrinë e tij në detin e Kuq, Aliluja.  
Se përdëllimi i atij është për gjithë jetën, Aliluja.  
Lavdëroni Perëndinë e Qiellit, Aliluja.  
Se përdëllimi i atij është për gjithë jetën, Aliluja.

## KREU I SHTATË

### MBLEDHËS TË FOLKLORIT

**FRANG BARDHI**  
(1606-1643)

**F**rang Bardhi ka lindur në Kallmet të Zadrimës në vitin 1606. I ungji, Gjergji ishte ipeshkëv i Zadrimës. Duke parë shprestarinë dhe përkushtimin e Frang Bardhit ai e morri me vete në Kishën e Blinishit. Frangu mësimet e para fetare i mori nën kujdestarinë e të ungjit. Më 1628 F. Bardhi studioi në Kolegjin Ilir të Loretos. Vite më vonë, më 1633 vajti në Romë për të studiuar në Seminarin Urban të Propagandës Fide.<sup>1</sup> Më 1635, Bardhi u dorëzua në gradën priftërore. Po atë vit botoi veprën “Fjalor latinisht-shqip”. Me vdekjen e kryeipeshkëvit të Tivarit, Pjetër Mazrrekut, Selia e Shenjtë caktoi Gjergjin. Më 17 dhjetor 1643, ndonëse nuk kishte përfunuar ende studimet e larta, Gjergji e emëroi nipin ipeshkëv të (Sapës) Zadrimës. Ceremonia e shungurimit të Bardhit u zhvillua në Romë, më 30 mars 1636. Në atë kohë F. Bardhi ishte në moshën 30-vjeçare. Gjatë qëndrimit në Venedik më 1636, Bardhi ka botuar në gjuhën latine veprën “Apologjia e

<sup>1</sup>-Seminari Urban i Propagandës Fide është themeluar më 1626, prej papës Urbani VIII.

Skënderbeut”. Gjithashtu F. Bardhi ka përkthyer në gjuhën shqipe “Dëshminë e fesë” si dhe “Rendin e Sinodit”, meqë priftërinjtë që ishin në varësinë e tij nuk e kuptonin latinishten. Bardhi u nda nga jeta më 1643, në moshën 37-vjeçare. Libri i Bardhit “Dictionarium latino-epiroticum” është fjalori i parë në gjuhën shqipe dhe përmban rreth pesë mijë fjalë. Ky libër ka pasur këto botime: Më 1932 prej Mario Rok, në Paris, më 1982 nga Engjëll Sejday në Prishtinë, më 2002 u ribotua në Shkodër “Frang bardhi dhe leksiku” prej Kolë Ashtës.<sup>2</sup> Në kreun e shtatë të “Dictionarium latino-epiroticum” gjenden edhe disa proverba, të cilat kanë rëndësi të vecantë për folkloristikën shqiptare. Këto proverba janë dëshmi e teksteve të hershme. Ndërmjet proverbave ka aforizma fetare, por edhe fjalë të urta të përkthyer nga italishtja dhe turqishtja.

**JERONIM DE RADA**  
(1814-1903)

Jeronim de Rada ka lindur më 19 nëntor 1814, në një katund të vogël të Kalabrisë të quajtur Macchia Albanese. Pasi kreu kolegjin e San Benedeto Ullanos, studioi për drejtësi në Universitetin e Napolit. Në vitin 1836, kur ishte 22 vjeç botoi “Milosaon”, librin e tij të parë. Milosao është një përrallë historike me vjersha në gjuhën shqipe. Jeronim de Rada e arriti kulmin e krijimtarisë së tij në vitin 1866 kur botoi në Firence “Këngët e Milosaos”. Ky libër përmban rapsoditë më të bukura shqiptare, të cilat autori i kishte mbledhur në kolonitë shqiptare të Kalabrisë dhe të Napolit. Këto këngë i patën sjellë me vete të shpërngulurit (arbëreshët) dhe u transmetuan gojë më gojë nga brezi në brez për katër shekuj. Me anë të këtyre vargjeve autori tregon se si i erdhi frymëzimi për të shkruar “Këngët e

<sup>2</sup>-Tonin Çobani, Frang Bardhi, Temp, 14 maj 2006, faqe 22-23.

Milosaos”. Sipas Dr. Moikom Zeqo kemi disa variante të Milosaos. Varianti pëfuqimtar përmban 40 këngë, të cilat datojnë prej 27 korrikut 1435 deri më 7 nëntor 1443. Ndërmjet “Këngëve të Milosaos”, Jeronim de Rada, në librër ka përfshirë edhe disa vjersha, të cilat quhen “Graxeta”. Këto këngë këndohen prej grave. Në këngën e fundit përmendet që Milosao ka vdekur më 7 nëntor 1443.<sup>3</sup>

Sapo kisha kryer kolegjin e Shën Adrianit në korrik të 1833, më erdhi një letër nga Rafael Valentini (i cili më vonë, shumë plak u bë dhe kryetari i pushtetit ekzekutiv të kryendritësve të Kalabrisë, më 1848). Në atë letër ai më kërkonte këngët popullore të kolonive tona. Atëherë unë shkova në Shën Kozmo, tek gjyshja ime, nëna e nënës, dhe atje, një plakë e ndershme, Tortoshëlja, më tha të parat, dhe midis syresh stë të Deli Skurës, të Milo Shinit, të Rada Vanit. Pastaj u ngjita në Shën Mitër te krushka Oricia, nga shtëpia e Strigarëve, e moçme mbi nëntëdhjetë vjeçe, dhe prandaj s’mbante shumë mend. Ajo më mësoi këngën: *Ra turku po ku ra!* e të tjera përgjysë. Ndërkaq veja të pyesja gratë e katundit tim dhe prej tyre mblodha nja njëzet. Nga kuvendimi me vajzat dhe nga mënyra e thjeshtë e të thënurit të atyre këngëve, lindi historia dhe paraqitja siç është sot e sajimit të Milosaos. Këngët e mbledhura i dërgova në Kozencë.

Më 1845 më gjeti në Napoli Kamarda dhe më tregoi një dorëshkrim me nja 15 këngë, që e kishte gjetur në kolegjin shqiptar të Palermos; këto ai pak i kuptonte, se ishin të dialektit sicilian; por unë sapo i lexova, zbulova menjëherë se ishte gjuha e vendeve tona. Do të thoshja se do të ishin të gjitha të zgjedhura e të lidhura në More, midis syresh po përmendim: “Dual e bukura në derë”, “Te qyteti i Napolit”, “Rrezes së përmallshme” etj. I kopjova e i bashkova me të tjerat. Vitin tjetër njoha Herman

<sup>3</sup>—Moikom Zeqo, “Kombkrijuesi dhe emërshenji De Rada”, “Ballkan”, 20 shtator 2006, faqe 16.

Kestner nga Hanovra që mblidhte këngë popullore të vendeve të ndryshme dhe donte dhe nga të miat. Shpirti guximtar dhe freskia e re e tyre iu duk atij se qenë më të mira nga të gjitha ato që ai njihte. Dhe më nxiti që t’i nxirrja në dritë që t’i njihnin dhe të tjerët. Pesë vjet më parë Luigi Petrasi nga Çerxeto (Qana) më kish dërguar tri këngë me vërtet të zgjedhura. Dhe një vjet më vonë erdhi në napoli Anxhelo Bazile nga Plataçi dhe më solli të tjera: atë të Pjetër Shortit, ato të dasmës së plota dhe të besës së madhe të Kostandinit, të cilat nuk i kisha. i rregullova dhe i përktheva italisht. Pastaj më ndoshën hallë të njëpasnjëshme dhe më penguan ti’nxirrja në dritë. Kështu, kur unë e lashë napolin me zemër të copëtuar, i prisja ose i hodha poshtë bashkë me të tjerat, pa vërejtur edhe këtë dorëshkrim, i cili kështu u zhduk.

Kur u ktheva në vendlindje, siç më kishin porositur, atëherë më ra ndër mend, kërkova copat e letrave nga kisha nxjerrë materialin e atij libri, por një pjesë e mirë kishin humbur dhe në mes atyre kënga “këndova e zgjova zotninë tim”. Kopjen e kësaj shpresoja ta kishte Kestneri, të cilit ia kisha dhënë. Më duhesh atëherë të shkoja në Shën Sofi dhe prej një plakë me mbiemër Xhibia dëgjova 5 a 6 të tjera dhe nuk e di në se një popull tjetër të ketë të tilla si: “Mbre i biri i Fugës”, “Ngritën një shtatore”, “Të gjitha vala i nxuar mb’an”, “Bie shi e borë” etj. Pastaj një grua nga Perçilota më mësoi në mënyrë të përpiktë këngën aq të bukur “Kur linde, linde ti, vashë”. Më së fundi kisha edhe disa që i kishte mbledhur frati Anton Snatori nga kolonitë përtej Kratit; por më duhej që t’u hiqja pjesët e shëmtuara, duke u ndihmuar nga shembulla të tjera që kisha edhe prej disa pjesëve që më kujtoheshin se u këndonte te djepi zonja mëmë vëllezërve të mi. Kështu dhe nga plaka mëndeshë, që ne duke qenë të varfër na rriti për mëshirë, më kujtohej kënga: “Ligjëroi plaka me malin”. Por duhet të jenë edhe të tjera në vendet tona që ende s’janë harruar, prandaj unë lus të

gjithë ndihmonjësit e kësaj të përkohshme që t'i mbledhim kudo që të kenë mbetur të pa vëna re; kështu që puna ime të plotësohet nga duart e tyre; sepse ky është një trashëgim i shkëlqyer që na përket të gjithëve ne. Në vitin 1866, mbasi ato që kishim i rregulluam së bashku me Nikolla Jenon prej Shën Dhimitri, u ndihmuam nga Nikollë Tomazeu që t'i shtypim në Firence.

### **THIMI MITKO (1820-1890)**

Thimi Mitko ka lindur në Korçë më 1820. Pasi emigroi në disa vende u vendos në Vienë ku ushtroi zanatin e rrobaqepësit. Ndonëse autodidakt Mitkoja ka lënë si trashëgimi të pasur kulturore dy vepra, “Bletën Shqiptare” dhe “Dorëshkrimi i Pragës”. Nga kontaktet që kishte me njerëz të ditur, Thimi Mitkos i lindi dëshira që të grumbullonte këngë folklorike, të cilat i botoi në Aleksandi të Egjiptit më 1878. “Bleta Shqiptare” fillon me disa fjalë të moçme, të cilat mbledhësi i ka renditur sipas rendit alfabetik. Në vijim përmban gjë e gjëza dhe urime të ndryshme “Të përshëndetura”. Thimi Mitko ka selektuar me kujdes emra të krishterë dhe muhamedanë, të cilët përbëjnë një burim të pashtershëm të onomastikës. Këngët i ka renditur në këtë mënyrë: “Këngë të vjetra”, “Këngë që këndohen në ditë të caktuara”, “Kënga shqype dasëmorë”, “Kënga shqype jaranishte”, “Këngë trimërie” dhe në fund “Përralla shqype”. Vepra e Thimi Mitkos është e pasur me vlera të veçanta folklorike.<sup>4</sup>

Librin “Dorëshkrimi i Pragës”, Thimi Mitko e shkroi pas vitit 1878. Mitkoja i pastron materialet folklorike nga fjalët e huaja. Kështu për shembull fjalët: hamam, furxhi, kadi,

<sup>4</sup>—Gjergj Zheji, Folklori Shqiptar, Libri Universitar, Tiranë 1998, faqe 18-20.

penxhere etj, janë zëvendësuar me: lanjëtar, bukëtar, gjyqtar, dritësore. Gjithashtu përdor fjalë toskërishte si për shembull: shergert, orok, shestë etj. Më 22 qershor të vitit 1878, Thimi Mitko i dërgon një letër mikut të tij Thimi Kerit, me anën e së cilës e njoftonte se kishte grumbulluar dhe sistemuar materialin për pjesën e dytë të Bletës. Në vitin 1883, ia dërgoi librin albanologut gjerman Gustav Majer, me qëllim që t'i gjente ndonjë botues. Majeri i botoi këto tekste pjesë-pjesë snë vëllimet e tij Kurzgefasste albanesische Grammatik (1888) dhe Albanesische Studien V (1897). Dorëshkrimi i Pragës përmban 169 këngë, 22 fabula, anekdoda e përralla si dhe 133 proverba popullore. Pas shumë peripecive, Thimi Mitko arriti që të gjente një botues nga Viena, i cili quhej Veckenstedt. Ky i fundit ia dha tekstin për redaktim filologut çek Jarnik, por vdekja e papritur e Mitkos ndërpreu punën e botimit të librit. Kështu dorëshkrimi mbeti në Pragë në bibliotekën personale të Jarnikut. Për këtë arrësyje, ky dorëshkrim u pagëzua me emrin “Dorëshkrimi i Pragës”.<sup>5</sup> Thimi Mitko ka pasur gjithnjë interes për mbledhjen e këngëve me përmbajtje fetare, të cila ishin pjesë përbërëse të kulturës së kombit shqiptar. Në librat e tij gjejmë mjaft të tilla.<sup>6</sup>

### **DHIMITËR KAMARDA (1821-1882)**

Dhimitër Kamarda ka lindur në Piana dei Albanesi më 23 tetor të vitit 1821, në një familje me tradita fetare. Nëna e tij quhej Katerina Gervasi dhe i ati ishte Atë Joani. Më 1832 studioi në Kolegjin e Shën Athanasit në Romë. Pas përfundimit të

<sup>5</sup>—Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, Vol II, Tiranë 1961, faqe 189-191.

<sup>6</sup>—Anton Papeleka, Qasja ndaj fesë në përmbledhjen folklorike Bleta shqiptare, Metropol, 21 gusht 2008, faqe 22.



studimeve u dorëzuar prift dhe shërbeu në Piana. Dhimitër Kamarda mbledhi shumë këngë të vjetra të kolonive të Kalabrisë dhe Sicilisë si dhe nga arvanitasit e Greqisë. Kamarda përzgjedhi me kujdes këngët folklorike dhe i botoi në “Shtojcën e gramatologjisë”. Këtë libër e botoi në Prato, më vitin 1866. Gjithashtu në librin “Shtojca e gramatologjisë”, Dhimitër Kamarda ka botuar disa këngë me motive liturgjike: “Një ditë vet’u lojasia” dhe “Ai fill ujë”. Më 1875 Kamarda botoi në Livorno broshurën “Tre canzoni popolari albanesi dell’ Epiro”, në të cilën komenton këngët: “O Janinë pse mban zi”, “Një ferman nxori Sulltani” dhe “Bie borë edhe shi”. Në harkun kohor 1860-1875, Dhimitër Kamarda ka botuar disa vepra letrare prej të cilave më të spikaturat janë: “Fyletia e arbenore” botuar në Livorno më 1867, “A Dora d’Istra gli albanese”, botuar më 1870, etj. Dhimitër Kamarda vdiq më 13 mars 1882. Me punën e tij, Kamarda renditet ndër shkrimtarët e Rilindjes Kombëtare.<sup>7</sup>

### **GAVRIL DARA (I RIU) (1826-1885)**

Gavril Dara i Riu ka lindur në Palac Adriano të Sicilisë, më 8 janar 1826. Studimet i kreu në Seminarin arbëresh të Palermos. Vite më vonë mbrojti doktoraturën në drejtësi. Më 1858 botoi fletoren letrare “Palingenesi” (përtëritja e jetës) dhe vite më vonë (1871-1874) drejtoi gazetën “La Riforma”, e cila botohej në Romë. Më 1864 shkroi një poemë prej 1300 vargjesh, e cila titullohej “Ana Maria”. Pasioni i tij ishte poezia dhe folklori. Kështu ai ka lënë në dorëshkrim veprën “Kënga e sprapsme e Balës”, të cilën e ka shkruar në vitin 1906. Gavril Dara është marrë me gjuhësi, filozofi dhe arkeologji. Ai ka vdekur në Girgeti, më 15 nëntor të vitit 1895.

<sup>7</sup>—Dhori Qirijazi, Dhimitër Kamarda, Toena, Tiranë 1997.

### **SPIRO DINE (1844-1922)**

Spiro Dine ka lindur në Vithkuq të Korçës, më 1844. Që në moshë të re morri udhën e kurbetit dhe u vendos në Misir. Aty iu kushtua mbledhjes së folklorit të pasur shqiptar. Të gjitha këngët e baladat i botoi në librin “Valët e detit”, të cilin e botoi në Sofje më 1908. Në këtë vëllim përfshihen vjershat që ka krijuar vetë, si dhe të miqve të tij si: Koto Hoxhi, Thimi Krej, Loni Logori, Kristo Floqi, Jani Vruho etj. Pjesën tjetër të librit e zënë këngët e grumbulluara folklorike, të cilat janë këngë historike, lirike, satirike, dasme, rituale, fjalë të urta popullore, gjë e gjëza etj. Libri i Spiro Dines “Valët e detit” është nga botimet më të rëndësishme folklorike. Libri “Valët e detit” ka 856 faqe, nga të cilat 412 përfshijnë krijimtarinë e autorit dhe rreth 540 faqe janë materiale folklori. Spiro Dine e shkroi librin me alfabetin e Stambollit. Vjershat e tij janë të ndërtuara nga leksiku popullor me një numër të kufizuar fjalësh. Gjithsesi materiali i mbledhur nga Spiro Dine parqet interes studimor.<sup>8</sup>

### **SHTJEFËN GJEÇOVI (1874-1929)**

Shtjefën Gjeçovi ka lindur në Janjevë të Kosovës më 12 korrik të vitit 1874. Pasi kreu kolegjin françeskan në Troshan, në vitin 1888 u nis për të ndjekur studimet në Kroaci. Pas përfundimit të studimeve në vitin 1896 u dorëzua prift dhe shërbeu në Pejë, Gomsiqe, Theth, Rubik etj. Atë Shtjefën Gjeçovi përfaqësonte intelektualin erudit, i cili grumbulloi qindra

<sup>8</sup>—Valter Memisha, Paradigma e gjuhës shqipe të Valët e detit të Spiro Dines, Standard, 09.12.2008, faqe 18-19.

gojëdhëna, përgatiti monografi shkencore, historike, pedagogjike etj. Ai kodifikoi të drejtën zakonore shqiptare, shkroi artikuj, hartoi tekste mësimore, përktheu nga letërsia botërore, përgatiti vëllime me dokumente për historinë e popullit tonë, përktheu vepra me karakter fetar në gjuhën shqipe etj. Atë Shtjefni ka botuar këta libra: “Jeta e shë Luçis, pajtores s’arkidieqezit të Durrsit” (1904), “Mark Kuli Kryeqitas” (1905), “Agimi i qytetnis”, (1910), “Shna Ndou i Padues” (1912), “Atil Reguli” (përkthim i lirë i dramit me tri pamje të Pjetër Metastasisit) (1912), “Vajza e Orleans-it ase Joana d’Ark”, (1915), “Atil Reguli” (1912), “Moisi Golemi” dhe “Kanuni i Lekë Dukagjinit” (1933).<sup>9</sup>

Me librin “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, Atë Shtjefën Gjeçovi u bë i famshëm. Rregullat e kanunet ai i mblodhi nga goja e popullit dhe fillimisht i botoi në revistën “Hyll të Dritës”. Kanuni i Lekë Dukagjinit në pjesën e parë përmban: Kishën, Hirja e Kishës, vorret, Pronet e pasunija e Kishës, Famullitari, Rrogëtari e Puntorija e Kishës etj. Faik Konica, i cili e ka takuar Atë Gjeçovin në vitin 1913 shkruan: “Asikohe atë Gjeçovi ishte prift në katundin e Gomsiqes. Këtu e shkonte jetën, në mes të lutjeve dhe mësimëve, një nga njerëzit më të lartë që ka pasur Shqipëria. Famullia shkollë dhe vend këshillash të mira, u jepte fëmijëve themelet e stërvitjes, u përndante fjalët e urëta dhe ngushëllimet njerëzve në nevojë. Kohën që i tepronte, atë Gjeçovi ia kushtonte studimit. Merrej me institutet e vjetra të Shqipërisë, nga të cilat një që arrin gjer në ditët tona është Kanuni i Lekë Dukagjinit. Askush nuk mund t’i afrohej atë Gjeçovit në diturinë e këtij kanuni. Na tregoi një dorëshkrim nja dy mijë faqesh, studim i palodhur e i hollë ku kish mblodhur, radhitur dhe renditur të gjitha sa kanë mbetur nga mendimet juridike të Shqipërisë në Kohën e mesme, mendime të cilat

<sup>9</sup>-Noc Kasmi, Personaliteti që synoi naltësimin e atdheut, 55, 13 tetor 2005, faqe 21.

ngjan t’i kenë rrënjët shumë përtej Kohës së Mesme”.<sup>10</sup> Në Arkivin Qendror të Shtetit ruhet “Vjetërsoeja”, të cilën Atë Shtjefën Gjeçovi e shkroi në vitin 1914. Atë Shtjefni u kujdes për tarashigiminë kulturore të popullit shqiptar. Ai ka shpëtuar nga grabitja kabanën e kishës së Shën Andreas në Kështjellën e Krujës. Falë informacioneve të Atë Gjeçovit sot ruhet kambana e Gjergj Arianitit etj. Atë Gjeçovin e vranë serbët më 14 tetor të vitit 1929 në katundin Zym të Prizrenit ku shërbente si famulltar.<sup>11</sup>

### VINCENC PRENNUSHI (1885-1949)

Imzot Vincenc Prennushi ishte prelati më i lartë i françeskanëve në Shqipëri. Ai gjithashtu ka qenë poet, prozator, dramaturg, publicist, përkthyes, folklorist dhe predikator i shquar. Duke shkruar fshat më fshat të veriut, ka mblodhur shumë këngë nga epika historike, këngë dasmash, dashurie etj. Materialin e botoi në librin “Kangë Popullore Gëgnishte”. Ky libër u botua në Sarajevë më 1911, me kujdesin e historianit austriak Karl Patsch. Vincenc Prennushi ka botuar këta libra: vëllimin me poezi “Gjeth e lule” (1924), dramën “Prej robnie në liri” (1914), bibliografinë “Sh’ Françesku i Asizit” (1927), “Fjala e Zotit” (1928), etj. Gjithashtu është marrë edhe me përkthime të klasikëve të letërsisë. Ka përkthyer Danten (kënga e XI e Parajsës), Fenelon (Telemaku n’udhtim) etj. Duke parë kontributin e tij të çmuar në fushën e letrave, Imzot Vincenci konsiderohet si shkrimtari i fundit i Rilindjes Kombëtare.

Në moshën 62-vjeçare, në nëntor 1947 u dënua me 20 vjet burg nën akuzën qesharake: “armik i popullit,

<sup>10</sup>-Faik Konica, “Vepra”, “Naim Frashëri”, Tiranë 1993, faqe 80-81.

<sup>11</sup>-Jaho Brahaj, Gjeçovi, si e shpëtoi kabanën e Skënderbeut, Gazeta Shqiptare, 20 korrik 2001, faqe 12-13.

bashkëpunëtor me okupatorët, klerik reaksionar, agjent i Vatikanit”. Gjatë viteve të dënimit në Burgun e Durrësit ai mbante afër të rinjtë duke u dhënë zemër për të duruar dhe shpresuar. Të burgosurit i dëgjonin këshillat e tij, vlerësonin mirësjelljen dhe fjalët e ëmbla që u thoshte. Prelati më i lartë i françeskanëve Imzot Vincenc Prennushi vuante dënimin në një qeli me Myftiun e Durrësit, Mustafa Varroshin. Pas shumë vuajtjeve dhe torturave çnjerëzore Imzot Prendushi, më 19 mars 1949 vdiq në spitalin e Burgut të Durrësit. Trupin e pajetë të Imzot Prennushit e varrosën në Kishën e Shën Luçisë ku iu bënë homazhe nga besimtarët e shumë durrsakë, të cilët përcollën për në banesën e fundit njeriun e tyre të dashur që u ishte gjendur në ditë të mira e të vështira. Në vitin 1967 eshtrat e tij u rivarrosën në varrezat e qytetit, ndërsa në vitet e demokracisë ato u kthyen përsëri në Kishën e Shën Luçisë.<sup>12</sup>

### **BENARDIN PALAJ (1894-1949)**

Benardin Palaj ka lindur në Shkodër më 1894. Arsimin fillor e kreu në Collegium Illyricum. Në vijim studioi në Salzburg dhe Insburg të Austrisë. Gjatë kohës që shërbeu si meshtar, duke shkuar nëpër fshatra të ndryshëm të malësisë, ka grumbulluar shumë këngë popullore. Benardin Palaj ishte poet dhe folklorist i shquar. Ai ka botuar vëllimet me poezi “Varrëve të Flamurit” (1937), “Ndërmjet Shëngjergjave” (1937) etj. Botimi i “Visareve të Kombit” II e bëri Atë Benardinin të pavdekshëm. Ky libër është nga veprat më të shquara të folkloristikës shqiptare. Në “Hymje” autorët na njohin me punën që është bërë nga mbledhësit e këngëve të kreshnikëve. Të

---

<sup>12</sup>-Pjetër Pepa, Si e mbytnë prelatin më të lartë Imzot Vincenc Prennushin, 55, 30 janar 2006, faqe 10.

gjitha këngët e mbledhura shoqërohen me një hyrje, e cila paraqet me pak fjalë përmbajtjen e këngës. Në fund të çdo kënge është shkruar emri i mbledhësit dhe vendi ku është kënduar kënga. Nga rapsodët më të shquar mund të përmendim: Mirash Gjoni, Mëhill Preka dhe Ded Zefi nga Curraj i Epërm, Sokol Martini nga Mënturi, etj. Më 1947 e arrestojnë dhe e ekzekutojnë në Rubik.<sup>13</sup>

### **DONAT KURTI (1903-1983)**

Atë Donat Kurti ka lindur në Shkodër më 1903. Përveç veprimtarisë si meshtar, Kurti ishte filolog dhe mbledhës i folklorit. Për shumë vite me radhë ai mblodhi nga goja e popullit shumë përralla, të cilat i botoi në librin “Prralla kombëtare”. Në vijim u mor me ciklin e kreshnikëve duke botuar së bashku me Atë Benardin Palaj librin “Visaret e Kombit”. Ky libër u botua më 1937 në Tiranë në shtypshkronjën “Nikaj” dhe përmban këngë kreshnikësh e legjenda. Në vitin 1947 Atë Donat Kurtin e arrestojnë dhe u dënua me 25 vjet burgim, nga të cilat kreu 17 vjet. U lirua nga burgu në moshë të thyer dhe vdiq në vetmi më 1983. Libri “Visaret e Kombit” II fillon me një parathënie shumë interesante, me anën e së cilës autorët rrëfejnë para lexuesve që ata qenë në dijeni të teorive folklorike.

---

<sup>13</sup>-Gjergj Zheji, Folklori Shqiptar, Tiranë 1998, faqe 23-24.

## MBLEDHËS TË HUAJ

1-Johan Georg Von Hahn (1811-1869) ka lindur më 1811 në Frankfurt. Pasi studioi për drejtësi, në vitin 1847 u emërua konsull i Austrisë në Janinë. Gjatë viteve që qëndroi si konsull ka grumbulluar një material të pasur me elementë folklorikë, të cilin e botoi në librin Albanesischen Studien, në vitin 1854.

2-Rajnholdi ka shërbyer si mjek në ishujt Poros, Hidra dhe Specia ku u muar me studimin dhe mbledhjen e këngëve folklorike të këtyre kolonive. Materialin e grumbulluar e botoi në librin Net Pelasgijke, në vitin 1855. Këngët e mbledhura nga Rajnholdi janë kryesisht këngë dashurie, të kënduara nga detarët që punonin larg familjeve.

3-Dozoni ka qenë konsull i Francës në Janinë. Gjatë qëndrimit të tij në konsullatë ka mbledhur një material të pasur folklorik dhe etnografik, të cilin e botoi në librin Manuel de la Langue Chkipe ou Albanaise, në vitin 1879. Në këtë vëllim janë rreth 24 përralla, 25 bejte, 37 këngë dashurie, 59 proverba etj.

4-Jan Urban Jarnik ka qenë filolog nga Cekia, i cili në vitin 1881 ka botuar librin Zur Albanischen Sprachenkunde. Në këtë libër gjenden dy përralla dhe 35 proverva. Ndërsa në vitin 1883 ka botuar librin Prispjevky ku Poznati nareci Albanskych, ku ndërmjet të tjerave gjenden 35 përralla me karakter humoristik.

5-Holger Pedersen ka qenë filolog danez dhe në vitin 1895 ka botuar librin Albanesische Texte mit glossar. Ky libër ka një material të pasur folklorik të mbledhur në vitin 1893 në Korfuz dhe në Shqipëri. Koleksioni i Pedersenit përbëhet prej 35 përrallash dhe rreth 230 këngësh. Përrallat i ka mbledhur në Mursi të Konispolit, ndërsa këngët i ka mbledhur nga njerëz të ndryshëm që ka hasur gjatë udhës.

6-Gustav Majer ka lindur në Gross Strehlitz më 25 nëntor të vitit 1850. Në librin e tij Albanesische Studien, Majeri ka botuar shumë folklor nga arbëreshët. Pjesën më të madhe të materialit folklorik e ka trashëguar prej albanologut Teodor Reinhold. Me përjashtim të 55 këngëve, e gjithë lënda tjetër është marrë nga Thimi Mitko.<sup>14</sup>

---

<sup>14</sup>-Mbledhës të hershëm të Folklorit Shqiptar, Vo. I, Instituti i Folklorit, Tiranë 1961.

## BIBLIOGRAFIA

- 1-Alfred Uci, Estetika e Folklorit, Akademia e Shkancave, Tiranë 2007.
- 2-Anton Pappleka, Poetë shqiptarë, Mësonjtorja, Tiranë 1999.
- 3-Anton Pappleka, Balada shqiptare, Toena, Tiranë 2005.
- 4-Andon Zako Çajupi, Baba Tomori, Dituria, Tiranë 1997.
- 5-Arif Korro & Petraq Jorgo, Krahina Malëshovë-Mbrezhdan në shekuj, botimet ABC, Gjirokastër 2001.
- 6-Benardin Palaj, Donat Kurti, Visaret e Kombit, Vol. II, Botimet Françeskane, Shkodër 2005.
- 7-C. Candreva-C. Stamile, Sperimentazione didattica in un ambiente bilingue arbëresh, Università' degli studi Calabria, Calabria 1980.
- 8-Grande e Santa Settimana e Santa Domenica, Eparchia di Lungro 1989.
- 9-Girolamo de Rada, Rapsodie d'un' poema albanese, Firenze 1866.
- 10-Giuseppe Crispi, Memorie storiche di talune costumanze apartenti alle colonie greco-albanesi di Sicilia, Palermo 1853.
- 11-Gjergj Zheji, Folklori Shqiptar, Libri Universitar, Tiranë 1998.
- 12-Gjusepe Schiro, Canti tradizionali, Napoli 1923.
- 13-Gustav Meyer, Albanesische Studien VI, Vien 1897.
- 14-Demetrio Camarda, Appendice ai saggio di Grammatologia comparata sulla lingua albanese, Prato 1866.
- 15-Dhimitër Shuteriqi, Shkrimet shqipe, Akademia e Shkencave, Tiranë 1976.
- 16-Dhimitër Beduli, Gjuha Shqipe në Kishë, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1997.
- 17-Dhori Qirijazi, Dhimitër Kamadra, Toena, Tiranë 1997.
- 18-Imzot Theofan Noli, Hymnore për kor të përzier, e botoj Peshkopata e Amerikës, Boston Mass 1936.
- 19-Imzot Theofan Noli, Kremtore e Kishës Orthodhokse, e botoj Peshkopata e Amerikës, Boston Mass 1947.
- 20-Imzot Theofan Noli, Java e Madhe e Shenjtë, Kosherja Orthodhokse, Selanik 1997.
- 21-Jani Nushi, Folklor nga krahina e Myzeqesë, Kombinati poligrafik, Tiranë 1982.
